


Vorbulla e rrenave



Funded by
the European Union

BT RN
BALKAN
INVESTIGATIVE
REPORTING
NETWORK | KOSOVO

PUBLIKOI: BIRN KOSOVA

AUTORË:

Kreshnik Gashi, Visar Prebreza, Dren Gërguri, Albulena Sadiku

REDAKTORE:

Jeta Xharra

EKIPI MONITORUES:

Valon Fana, Emirjeta Vllahiu, Gentiana Ahmeti, Ardita Zeqiri,
Mediana Halili, Vlera Shabani, Diedon Nixha

EKSPERIMENTI SOCIAL:

Arjana Berisha, Laurant Berisha, Bubulina Peni, Era Hasani,
Vlera Shabani

HULUMTIMI I OPINIONIT:

UBO Consulting

KONTRIBUES:

Diedon Nixha

EKSPERT I RRJETEVE SOCIALE:

Granit Mavriqi

REDAKTOR I VERSIONIT NË GJUHËN ANGLEZE:

Lawrence Marzouk

MENAXHERE E PROJEKTIT:

Albulena Sadiku

PËRKTHYES DHE LEKTORË NË VERSIONIN NË GJUHËN SHQIPE:

Përparim Isufi dhe Albulena Sadiku

HEQJE E PËRGJEGJËSISË:

Ky raport është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmajtja e tij është përgjegjësi vetëm e BIRN Kosovës dhe jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Tabela e Përmbajtjes

| | | |
|------------|--|------------|
| | PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE | 5 |
| | Rekomandimet | 10 |
| | Metodologjia | 18 |
| I | I. Gjetjet rreth ndikimit nga jashtë dhe propagandës kundër integritit | 20 |
| | 1.1 Narrativat luftënxitëse të dezinformimit nga Kremli | 22 |
| | 1.2 Narrativa dezinformuese se NATO dhe perëndimi po i mbështesin shqiptarët | 39 |
| | 1.3 Narrativat se NATO dhe perëndimi po mbështesin serbët | 32 |
| | 1.4 Narrativa dezinformuese për kriminalizimin e NATO-s | 35 |
| | 1.5 Narrativat dezinformuese se perëndimi dhe NATO po përgatisin shqiptarët për luftë kundër serbëve | 37 |
| | 1.6 Narrativat dhe dezinformimi rreth dialogut Kosovë-Serbi dhe narrativat kundër diplomatëve të BE-së dhe ShBA-ve | 41 |
| | 1.7 Narrativat rreth dezinformimit për EULEX-in dhe për Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës | 47 |
| | Ndikimi kinez në media dhe në publik | 53 |
| | 1.8 Narrativat promovuese të ekonomisë dhe produkteve kineze | 53 |
| | 1.9 Narrativat e Kinës kundër ShBA-ve | 55 |
| | 1.10 Narrativat mbi shëndetin publik e që mbështeten nga Kina | 57 |
| II | Narrativat dhe dezinformatat që dëmtojnë sigurinë, ulin besimin ndaj Perëndimit dhe i përkeqësojnë marrëdhëniet ndër-etnike | 60 |
| | 2.1 Dezinformatat rreth marrëdhënieve dhe incidenteve ndëretnike | 61 |
| | 2.2 Narrativat e bazuara në etni dhe dezinformatat rreth profileve publike | 66 |
| III | Narrativat dezinformuese rreth shëndetit dhe ekonomisë | 74 |
| | 3.1 Shitja e produkteve përmes mashtrimeve që përdorin artikuj të rremë | 75 |
| | 3.2 Dezinformatat rreth COVID - 19 | 78 |
| | 3.3 Dezinformimi rreth çmimeve të energjisë | 81 |
| IV | Kapaciteti i Kosovës për t'u përballur me dezinformimin | 83 |
| | 4.1 Popullsia në Kosovë përgjithësisht mbetet e pambrojtur nga dezinformimi | 85 |
| | 4.2 Kapacitetet e kufizuara të institucioneve në adresimin e dezinformimit | 92 |
| | 4.3 Mediat dhe institucionet arsimore përballen me kufizime serioze në mbrojtjen e shoqërisë nga dezinformatat | 94 |
| | ANEKSI I: PËRMBLEDHJE E FOKUS GRUPEVE | 96 |
| | ANEKSI II: METODOLOGJIA E DETAJUAR E KËTIJ STUDIMI | 101 |

Përmbledhja Ekzekutive

Mediat, institucionet, dhe shoqëria civile po përballen me sfida serioze në adresimin efikas të dezinformimit. Në Kosovë nuk ka një vizion të qartë dhe qasje strategjike për luftimin e këtij fenomeni. Rrjedhimisht, dezinformimi ka ndikim të konsiderueshëm në opinionin publik në Kosovë.

Në mungesë të financimit të qëndrueshëm, burimeve të kufizuara njerëzore, politikave të paqarta redaktuese dhe ndikimeve nga jashtë, media është bërë krijues dhe përforcues i dezinformimit në disa raste. Të gjeturat e këtij studimi tregojnë se rrjetet sociale dhe platformat e internetit të specializuara në lajme të rreme janë shpërndarësit kryesorë të dezinformimit, sado që, në disa raste, edhe mediat tradicionale e profesionale kanë faj.

Institucionet e Kosovës nuk kanë qenë në gjendje të themelojnë mekanizma që monitorojnë shpërndarjen e dezinformimit, ndërsa institucionet gjyqësore nuk janë marrë me raste të tilla. Sfida kryesore është mungesa e programeve të edukimit për median dhe mungesa e kapacitetit të sistemit arsimor për ta ofruar këtë. Rrjedhimisht, shoqëria kosovare mbetet e pambrojtur nga dezinformimi edhe pse të dhënat tregojnë se dezinformimi ka ndikim serioz në opinionin publik.

Ky raport synon të krijojë një hartë të dezinformimit në Kosovë. Nganjëherë, këto dezinformata janë të ndikuara nga jashtë, por në shumicën e rasteve ato nisin nga brenda. Si një shoqëri me 1.7 milion banorë, Kosova i dëgjon këto raportime të rreme të përsëriten herë pas here, të thurura në atë formë në diskursin publik që në fund marrin formën e narrativit. Ky raport hartëzon jo vetëm dezinformimin por edhe narrativat që krijohen si pasojë e tyre: pra kjo është përralla e gënjeshtreve tona që sillen në një vorbull.

BIRN mbledhi të dhëna rreth dezinformimit nga tetori 2022 deri në prill 2023.

Qëllimi i këtij studimi është të zbulohet ndikimi i dezinformimit që vjen nga Kremli, Kina dhe burimet tjera. Studimi gjithashtu synon të identifikojë narrativat e dezinformimit që janë krijuar brenda Kosovës dhe ndikimin e çrregullimeve informuese që përfshijnë dezinformimin, keqinformimin dhe çinformim (për një definicion të detajuar të secilës prej tyre, ju lutem shihni tabelën në faqe 102).

Përderisa po ndodh invazioni rus në Ukrainë, edhe Kosova po vuan nga fushatat dezinformuese ruse që kapluan tërë Ballkanin Perëndimor. Në Kosovë, ky dezinformim synonte kryesisht t'i pengonte proceset integruese të vendit në NATO dhe BE, dhe në këtë mënyrë kishte qëllim të ndikonte në marrëdhëniet e Kosovës me botën e jashtme. Nga ana

tjetër, së brendshmi, kjo fushatë synonte tendosjen e marrëdhënieve tashmë të tensionuara ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës.

Dezinformimi i ardhur nga Kremli u publikua në mediat e Kosovës të cilat, pa verifikuar dhe balancuar burimet, ripublikuan informacionet e prodhuara nga Kremli. Studimi identifikon shembuj nga mediat në gjuhët shqipe e serb, të cilat, pa ndonjë shqyrtim apo balancim editorial, publikuan komunikata të Kremlinit në lidhje me ngjarjet në Ballkan. Kjo çoi deri te shpërndarja e narrativave që keqinterpretojnë situatën aktuale në Kosovë. Për më tepër, informacioni me origjinë nga burimet mediale të kontrolluara nga Kremli është përkthyer në gjuhët lokale dhe publikuar pa e treguar burimin në mënyrë eksplicite. Studimi gërmon më thellë këtë çështje në kapitullin 'Narrativat dezinformuese luftënxitëse të Kremlinit', i cili zbardh strategjitë e përdorura nga Rusia për ta lëkundur opinionin publik dhe dinamikat politike në favor të vetin.

Narrativat që burojnë nga mediat e kontrolluara nga qeveria kineze gjithashtu kanë gjetur udhë në mediat dhe rrjetet sociale të Kosovës. Këto pretendime shpesh shpërndahen pa u sqaruar si duhet se burimi i informatës po mirret prej mediave të cilat në mënyrë eksplicite e publikojnë që janë 'Media të Kontrolluara nga Shteti i Kinës'. Një numër i konsiderueshëm i artikujve të prodhuar nga shteti kinez që kanë të bëjnë me ekonominë kineze ripublikohen në veçanti nga mediat lokale në Kosovë. Kjo përfshin shpërndarjen e lajmeve që burojnë nga platformat e qeverisë kineze të përkthyer në gjuhën shqipe. Kapitulli 'Ndikimi kinez në media dhe publik' hedh dritë në përmasën e ndikimit të mediave kineze, nga narrativat promovuese të ekonomisë së tyre deri te qëndrimi rreth shëndetit publik.

Këto të gjetura theksojnë ndikimin nga jashtë në dezinformim brenda Kosovës. Ndërsa, sa i përket krijimit të dezinformimit përbrenda Kosovës, studimi dëshmon që mediat dhe politikanët janë të përfshirë në prodhimin e propagandës e cila nxit tensione ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, si dhe shpërndan narrativa kundër integritetit në NATO dhe BE.

Narrativat kundër NATO-s janë hasur kryesisht në mediat në gjuhën serbe dhe në mesin e politikanëve serbë të Kosovës. Megjithatë, vlen të theksohet se ka pasur raste, sado që në masë më të vogël, që disa narrativa kundër NATO-s janë shfaqur edhe në mesin e politikanëve shqiptarë në Kosovë. Studimi i spjeron këto narrativa detajshëm në kapitullin 'Narrativa dezinformuese që NATO dhe perëndimi mbështesin vetëm shqiptarët e Kosovës'.

Studimi i BIRN-it gjithashtu analizon narrativat dezinformuese kundër Bashkimit Evropian, misionit të BE-së për sundim të ligjit në Kosovë, EULEX, dhe Dhomave të Specializuara dhe Zyres së Prokurorit të Specializuar të Kosovës me seli në Hagë.

Hulumtimi tregon se dialogu i fascilituar nga BE ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ishte shoqëruar me dezinformim rreth fascilitatorëve të emëruar nga BE dhe ShBA.

Frustrimi me mungesën e progresit në dialog shpesh është interpretuar në media si faj i fascilitatorëve të cilët nuk janë në gjendje të imponojnë implementimin e marrëveshjeve të nënshkruara. Në këtë mënyrë, edhe pse mbi 91 % e qytetarëve të Kosovës janë shprehur në favor të integritimit në BE, janë shfaqur sentimente lokale kundër BE-së rreth dështimit të dialogut Kosovë- Serbi.

Kjo më pas është përforcuar nga narrativat dezinformuese ruse. Në mënyrë të ngjashme, politikanët në Kosovë dhe Serbi janë përballur me fushata të bazuara në informacion të rremë, që kryesisht synon portretizimin e tyre si ‘tradhtarë’ të çështjeve kombëtare. Raporti gërmon më tej në narrativat kundër Bashkimit Evropian në kapitullin ‘Narrativat dhe dezinformimi rreth dialogut Kosovë- Serbi dhe narrativat kundër diplomatëve të BE-së dhe ShBA-ve’.

Gjetjet e hulumtimit hedhin dritë edhe mbi shpërndarjen e dezinformimit që lidhet me ekonominë e Kosovës. Një aspekt i dukshëm i këtij dezinformimi përfshin promovimin e djegies së qymyrit si zgjidhje e qëndrueshme për energji, pavarësisht ndikimit të tij në mjedis. Artikujt që raportojnë se shtetet anëtare të BE-së po i rikthehen qymyrit u dëshmuar të ekzagjeruara pasi që shumë termocentrale të qymyrit ishin në pritje e në nuk u rihapën. Në kapitullin ‘Narrativat dezinformuese lidhur me shëndetin dhe ekonominë’, raporti zbulon narrativat dezinformuese në ekonomi, që nga mashtrimet në përdorimin e artikujve të rremë e deri te keqinformimi rreth çmimeve të energjisë.

Aktorë të ndryshëm brenda Kosovës kontribuojnë në prodhimin e dezinformatave. Kjo përfshin politikanë, media të regjistruara e të paregjistruara, si dhe faqe në rrjete sociale. Disa media janë shndërruar në shpërndarës të dezinformatave thjesht sepse nuk aplikojnë standarde të gazetarisë profesionale dhe nuk bëjnë kontrollim bazik të fakteve.

Analiza e të dhënave të rrjeteve sociale ka zbuluar se platforma të caktuara të përfshira në prodhimin e dezinformimit kanë krijuar rrjete të specializuara të shpërndarjes online. Këto burime të dezinformimit përdorin faqe të ndryshme në rrjete sociale, shpesh duke menaxhuar madje deri në 11 faqe, për të shpërndarë në mënyrë sistematike informacion të rremë. Ky aktivitet transformon këto platforma në fabrika të lajmeve të rreme, duke prodhuar dhe propaganduar vazhdimisht përmbajtje të rreme. Ky hulumtim ka identifikuar raste specifike ku artikujt që përmbajnë informacion të rremë janë ripostuar shumë herë në Kosovë, e në disa raste janë bërë madje 173 shpërndarje brenda një periudhe 18 muajshe.

Përveç analizës së artikujve të rremë, hulumtimi ka bërë një sondazh për të vlerësuar opinionin publik dhe përceptimin rreth dezinformimit. Sondazhi përfshiu një mostër prej 1,056 qytetarëve. Gjetjet e këtij sondazhi tregojnë pasojat e dezinformimit të qytetarëve të Kosovës, duke zbuluar se një përqindje e mirë e popullsisë e ka vështirë për të bërë dallimin mes informacionit të saktë dhe të rremë duke i munguar kështu njohuria e nevojshme për ta identifikuar dezinformatën. Rrjedhimisht, raporti nënvizon rëndësinë e edukimit për media

dhe kultivimit të aftësive të mendimit kritik si mjete esenciale në luftën ndaj dezinformimit. Shumica e këtyre qytetarëve janë përdorues të platformave të rrjeteve sociale, sidomos Facebook-ut, i cili shërben si kanal primar për shpërndarjen e dezinformatave. Të dhënat e grumbulluara theksojnë më tej se prodhuesit e përmbajtjeve të tilla përdorin teknika të ndryshme, përfshirë manipulimin e videove, fotografive dhe përmbajtjes së shkruar.

Situata është po aq sfiduese për institucionet publike dhe vendim-marrësit që merren me dezinformimin. Me qëllim që të vlerësohet njohuria dhe aftësitë e zyrtarëve publikë rreth dezinformimit, BIRN ka zhvilluar një eksperiment social i cili përfshiu 50 pjesëmarrës nga profesione të ndryshme si mësues, mjekë, gjykatës dhe prokurorë. Gjatë eksperimentit, gazetarët e BIRN u prezantuan pjesëmarrësve artikuj të kompletuar me logo dhe dizajne të vërteta. Artikujt përmbanin informacione të pavërteta të cilat ishin lehtë të identifikueshme për profesionin respektiv të respondentëve dhe shumica e pjesëmarrësve i ranguan artikujt si të vërtetë dhe shprehën vullnetin për t'i shpërndarë, pa e verifikuar informacionin. Janë rreth 200 zyrtarë që punojnë në zyret e informimit publik në institucionet e Kosovës. Bazuar në fokus-grupet e bëra me përfaqësues të këtyre departamenteve, është arritur në përfundim se këtyre zyrtarëve u mungon njohuria adekuate në dezinformim, përfshirë edhe atë se si të identifikohet dhe si të adresohet dezinformata.

Edhe pse Kosova ka një treg medial dinamik, të lirë, të pavarur dhe relativisht demokratik, një pjesë e mediave profesionale bien viktimë e dezinformimit vazhdimisht.

Kjo dukuri nuk është për shkak të presionit politik apo biznesor, por thjesht rrjedh nga mungesa e politikave editoriale të aplikueshme për ta identifikuar dhe adresuar shpërndarjen e dezinformimit që vjen nga Rusia dhe Kina. Mungesa e redaktorëve të trajnuar brenda sektorit të mediave e përkeqëson problemin pasi që këta profesionistë luajnë rol thelbësor në verifikimin e informatave dhe për t'u siguruar se po ruhen standardet editoriale. Për më tepër, sfida kryesore për gazetarët e rinj është se ata hyjnë në tregun medial pasi kanë kaluar gati 2 dekanë një sistem arsimor i cili nuk i trajnon ata për të menduar në mënyrë kritike.

Njëkohësisht, komunitetet jo-shumicë, të cilat kanë më shumë nevojë për financim të pavarur për mediat e tyre për shkak të të hyrave të kufizuara komerciale, kanë mungesë financimi për të prodhuar informacion që i reziston propagandës shtetërore.

Nga aspekti ligjor, Ligji për Shpifje i Kosovës është një mjet për të adresuar dezinformimin por këto raste marrin pesë deri dhjetë vjet derisa të zgjidhen në gjykatë. Në nivelin e politikave ekzistuese publike shtetërore, Kosova nuk ka një strategji unike, politike apo mekanizma tjerë për ta trajtuar dezinformimin dhe propagandën. Këto kufizime institucionale janë të theksuara në kapitullin 'Kapacitetet e Kosovës për t'u marrë me dezinformimin' i cili analizon reagimin e Kosovës ndaj sfidave që paraqet dezinformimi.

Për ta adresuar çështjen e përhapur të dezinformimit në Kosovë, raporti prezanton një sërë rekomandimesh për palët përgjegjëse, përfshirë bërësit e politikave, organizatat mediale dhe shoqërinë civile. Këto rekomandime theksojnë domosdoshmërinë për të ngritur bashkëpunim mes këtyre palëve, zhvillimin dhe zbatimin e programeve të edukimit për median dhe themelimin e mekanizmave të fortë të kontrollit të fakteve brenda organizatave mediale.

Në fund, raporti ofron njohuri të paçmueshme rreth dinamikave të dezinformimit në Kosovë dhe pasojat që ato kanë për qytetarët. Raporti u ofron palëve përgjegjëse një udhërrëfyes strategjik për ta adresuar problemin, nxitjen e një kulture të edukimit për median dhe të ushqyerit e aftësive për mendim kritik.

Rekomandimet

PËR QEVERINË E KOSOVËS:

- Qeveria e Kosovës duhet të ndërtojë kapacitetet e domosdoshme për t'i identifikuar burimet e dezinformimit dhe për t'i adresuar ato si duhet;
- Në bazë të konkluzioneve të nxjerra nga fokus grupet me zyrtarë të marrëdhënieve me publikun, zyrtarët kanë për detyrë të mbikqyrin vetëm se çfarë dezinformatash po shpërndahen për “shëfin” e tyre (qoftë ai ministër apo shef departamenti). Kjo duhet të ndryshojë. Zyrtarët për marrëdhënie me publikun duhet të merren me dezinformatat që e dëmtojnë vendin, jo vetëm individin që e drejton institucionin;
- Një platformë e bazuar në Inteligjencë Artificiale duhet të vendoset në të gjitha institucionet publike për të asistuar në monitorimin dhe identifikimin e të gjitha llojeve të dezinformimit;
- Përfaqësuesve politikë duhet t'u mësohet se si ta identifikojnë dezinformatën nga jashtë dhe si ta adresojnë atë;
- Institucionet publike duhet të organizojnë programe të specializuara të edukimit për mediat për zyrtarët publikë të cilët nuk kanë mjaftueshëm njohuri se si t'i identifikojnë lajmet e rreme dhe dezinformimin;
- Kosova duhet ta miratojë Strategjinë për Edukim për Media dhe ta vendosë se si do ta zbatojë atë përmes programeve të edukimit për media nëpër shkolla dhe universitete në mbarë Kosovën;
- Institucionet e Kosovës duhet të krijojnë fonde dhe iniciativa të pavarura që synojnë luftimin e dezinformimit, edukimin për media dhe programet e edukimit për media sidomos ndër komunitetet jo-shumicë;
- Në komunitete që janë të përçarë në mënyrën se si konsumojnë kulturë, ekonomi dhe arsimit, qeveria e Kosovës duhet që të synojë seriozisht reduktimin e informacionit që dëmton marrëdhëniet ndëretnike;
- Krejt në fund, qeveria e Kosovës duhet të sigurojë që të mos e njollojë një rajon të tërë të vendit si të prirur për krim të organizuar ose kontrabandë pasi që kjo është dëshmuar se e stigmatizon tërë komunitetin e atij rajoni;
- Nevojiten programe për t'i afruar të rinjtë e të dyja komuniteteve që tashmë janë edukuar jo vetëm në sisteme arsimore të dy shteteve të ndryshme por edhe me kurikula që krijojnë përçarje të thella.

PËR INSTITUCIONET JURIDIKE

- Gjykatësit dhe prokurorët duhet të ndjekin programe të specializuara trajnimi rreth asaj se si ta detektojnë dezinformatën, të drejtat e autorit dhe çështjet që kanë të bëjnë me shpifjen;
- Sistemi i drejtësisë, përfshirë policinë dhe institucionet tjera të sigurisë, duhet t'i intensivikojnë hetimet për t'i detektuar burimet e rrezikshme të dezinformimit, sidomos ato që nxisin dhunë dhe urrejtje. Hetimet financiare ndaj atyre që prodhojnë dhe shpërndajnë dezinformim duhet të intensivikohen;

PËR MEDIAT NË TË GJITHA GJUHËT DHE INSTITUCIONET ARSIMORE

- Mediat në Kosovë duhet t'i kushtojnë vëmendje burimit të materialit të sponsoruar që publikohet në gjuhën shqipe pasi që ky studim ka identifikuar se materiale propaganduese ruse e kineze përkthehen në gjuhën shqipe dhe u ofrohen mediave të Kosovës për ripublikim;
- Mediat duhet të angazhohen që të prodhojnë përmbajtje që edukon audiencën rreth edukimit për mediat dhe pasojat që bart dezinformimi;
- Media duhet t'i forcojë politikat redaktuese dhe procesin redaktues në atë mënyrë që përmbajtja që e shpërndajnë të mos prodhojë dezinformata.
- Mediat duhet t'i përditësojnë politikat e tyre redaktuese në mënyrë që t'u ndihmojnë gazetarëve ta dallojnë çka është propagandë ruse e kineze dhe pastaj të vendosin si ta paraqesin, redaktojnë apo kontekstualizojnë atë material në publikimet e tyre;
- Nëse materiali i sponsoruar nga Kina e Rusia publikohet në mediat e Kosovës, ato duhet ta përmbajnë njoftimin e duhur që tregon se ato njihen si përmbajtje të sponsoruara dhe të tregojnë burimin e agjencisë që sponsoron këtë material;
- Mediat e Kosovës duhet t'i rrisin kapacitetet e brendshme për verifikim të fakteve si dhe kapacitetet për hulumtim të burimeve të dezinformimit;
- Mediat duhet ta shmangin gjuhën nxitëse që inkurajon urrejtje mes grupeve etnike në Kosovë. Kjo shpesh përfshin fshirjen e gjuhës së urrejtjes nga kanalet e rrjeteve sociale;
- Do të ishte e mirëseardhur nëse drejtuesit e emisioneve në programet politike të mbrëmjes u bëjnë thirrje shikuesve të tyre të përmbahen nga komentet nxitëse në kanalet e këtyre programeve në rrjete sociale dhe në seksionin e komenteve, sidomos kur tensionet etnike janë të ngritura për shkak të protestave, barrikadave etj;

- Institucionet arsimore duhet të nisin hulumtime të thelluara rreth pasojave të dezinformimit në të gjitha gjuhët që publikohen në Kosovë (kjo përfshin mediat në gjuhën shqipe dhe serbe);
- Influencuesit në rrjete sociale duhet të fillonë ta edukojnë veten se si ta detektojnë dezinformimin dhe të mos e promovojnë atë në platformat e tyre.

PËR TRUPAT E MEDIAVE

- Këshilli i Mediave të Shkruara, KMSH, duhet t'i forcojë kapacitetet e veta për të identifikuar mediat që ripublikojnë ose transmetojnë dezinformata dhe të marrin masa ndaj mediave që shkelin standardet etike;
- Komisioni i Pavarur për Media, KPM, duhet t'i forcojë kapacitetet e veta monitoruese dhe të marrë masa adekuate ndaj mediave që shkelin standardet etike;
- Komisioni i Pavarur për Media duhet ta forcojë mbikëqyrjen në mënyrë që ta kontrollojë përmbajtjen problematike të shpërndarë nga kanalet transmetuese përmes rrjeteve kablovike;
- Komisioni i Pavarur për Media dhe Këshilli i Mediave të Shkruara duhet të dizajnojnë dhe të bëjnë projekte të pavarura për edukim për media si dhe të kërkojnë partnerë medialë për këtë.

PËR KUVENDIN E KOSOVËS

- Kuvendi i Kosovës duhet t'i përshpejtojë procedurat për amendamentimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës, RTK;
- Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojë resurse të mjaftueshme financiare për KPM-në në mënyrë që të jetë në gjendje ta rrisë mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të etikës në mediat audiovizuale;
- Programe të specializuara duhet të organizohen për politikanë dhe anëtarë të Kuvendit në mënyrë që të përgatiten me njohuri se si të shmangët shpërndarja e dezinformatave në seancat e Kuvendit;
- Deputetët duhet të mbështeten në edukimin e audiencës së gjerë, përfshirë edhe bazën e tyre votuese, rreth dezinformimit dhe pasojave që sjell ai.




Figura 1. - Harta e dezinformimit medial në Kosovë bazuar në vlerësimin e Krypometrit

Dezinformimi në kontekstin e Kosovës

Kosova është një shtet ballkanik me 1.7 milion banorë. Rreth 90% e popullatës janë shqiptarë, përdherisa 5% e popullatës janë serbë. Romët, ashkalitë, egjiptianët, turqit, boshnjakët dhe goranët përbëjnë 5 përqindëshin e mbetur të popullatës.

Kosova ka 38 komuna nga të cilat 27 janë me shumicë shqiptare, dhjetë me shumicë serbe dhe një me shumicë turke.¹ Sipas sondazhit të publikuar nga UNDP me 10 mars 2023 përafërsisht 50% e qytetarëve të Kosovës janë të kënaqur me performancën e institucioneve kryesore. Kënaqshmëria me qeverinë e Albin Kurtit është 44.9%, me punën e Kuvendit është 39.1% ndërsa me Zyrën e Presidentes arrin në 56.8%.²

Kosova është pjesë e Ballkanit Perëndimor, regjion i cili nga studime të shumta është identifikuar si i pambrojtur nga dezinformimi.³ Këta janë faktorët që kontribuojnë në cenueshmërinë e Kosovës nga dezinformimi:

- **Ndikimet nga jashtë**
- **Terren i plleshëm për konflikte ndëretnike**
- **Mungesë e edukimit për median**
- **Mungesë e kapaciteteve për mekanizma të kontrollit medial**
- **Mungesë njohurie dhe kapacitetesh të institucioneve tjera në vend për ta adresuar çështjen**

¹ Agjencia e Statistikave e Kosovës, *Libri Vjetor i Statistikave i Republikës së Kosovës 2022, Shtator 2022, Faqe 30.* <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/statistical-yearbook-of-the-republic-of-kosovo-2022>

² UNDP, *Public Pulse 23, Mar 10, 2023.* <https://www.undp.org/kosovo/press-releases/undp-publishes-public-pulse-brief-23>

³ *Vulnerability Index of Disinformation in Kosovo, Democracy Plus, November 2022,* <https://dplus.org/publikimet/indeksi-i-cenueshmerise-ndaj-dezinformimit-ne-kosove/15369/>, <https://www.ndi.org/our-stories/monitoring-information-integrity-disorders-kosovo>, <https://www.nato.int/docu/review/articles/2020/12/21/disinformation-in-the-western-balkans/index.htm>

Kosova e ka shpallur pavarësinë në shkurt të vitit 2008. Më shumë se 100 shtete e kanë njohur Kosovën, megjithatë pesë shtete anëtare të Bashkimit Evropian nuk e kanë njohur.⁴ Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, dhe e sfidon këtë pavarësi si prej përbrenda Kosovës duke themeluar struktura paralele, ashtu edhe nga jashtë duke u angazhuar në përpjekje diplomatike për t'i bindur shtetet tjera të mos e njohin sovranitetin e Kosovës. Për më tepër, Serbia e ka penguar anëtarësimin eventual të Kosovës në organizata ndërkombëtare. Komunitetit shqiptar dhe serb vazhdojnë të kenë shumë pak bashkëpunim dhe jetojnë në shoqëri të përzgëra.

Dy komunitetet janë përballur me sfida në adresimin e krimeve të luftës dhe për tu pajtuar. Drejtësia tranzicionale ka pasur sukses të kufizuar. Për më tepër, popullata shqiptare dhe serbe mbeten të përzgëra rreth asaj se çka ka ndodhur gjatë luftës në Kosovë.

Shqiptarët dhe serbët e Kosovës vazhdojnë të kenë dy sisteme të ndara arsimore. Komuniteti serb ndjek mësimin brenda kornizës së sistemit të qeverisë së Serbisë ndërsa komuniteti shqiptar ndjek mësimin brenda sistemit arsimor të Kosovës.⁵ Asnjë shkollë në këto komunitete nuk i mëson nxënësve gjuhën e komunitetit tjetër. Ndasitë ndërmjet dy komuniteteve shtrihen përtej gjuhëve. Asnjëra palë nuk e njeh historinë dhe kulturën e palës tjetër. Kurrikula arsimore e përdorur nga secili komunitet paraqet narrativa të ndryshme rreth ngjarjeve të njëjta historike dhe perspektivat kulturore e vlerat e komunitetit tjetër nuk janë të përfshira në kurrikula.

Si rezultat i kësaj, dy komunitetet jetojnë gati në mjedise paralele ku janë në mënyrë konstante të ekspozuara ndaj narrativave që promovojnë mosbesim të thellë ndaj tjetrit. Kjo prodhon njerëz që janë të ndjeshëm ndaj dezinformimit.

Hartimi i këtij raporti koïncidoi me zhvillime të rëndësishme ndërkombëtare, politike, ekonomike dhe shoqërore të cilat ndikuan në marrëdhëniet ndëretnike. Që nga viti 2011, Kosova dhe Serbia janë të angazhuara në një dialog të fokusuar në normalizimin e marrëdhënieve mes tyre. Pavarësisht se ka kaluar më shumë se një dekadë e dialogu po vazhdon, zbatimi i marrëveshjeve të arritura ka qenë i kufizuar. Vetëm një e katërta e marrëveshjeve të nënshkruara janë zbatuar në mënyrë efikase.⁶ Zbatimi i marrëveshjeve ka nxitur debate në çështje të shumta, përfshirë tabelat e veturave dhe themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Asociacioni është një çështje veçanërisht e debatueshme në opinionin publik shqiptar për shkak të frikës që mund të shndërrohet në një entitet të ngjashëm me Republikën Serbe.

⁴ Spanja, Greqia, Sllovakia, Rumania dhe Qipro

⁵ Edhe pse pakoja e Ahtisaari-t shtroi rrugën që pavarësia e Kosovës t'i lejojë serbët ta përdorin kurrikulën e Serbisë, ajo kërkon që kjo kurrikulë të jetë në vijë me Kushtetutën e Kosovës. Shih 'Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement', Neni 7, Acts 7.1.1 and 7.1.2 http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf

⁶ BIRN ka monitoruar marrëveshjet e nënshkruara mes Kosovës dhe Serbisë bashkë me organizata të shoqërisë civile në Serbi dhe rezultatet e këtij monitorimi mund të gjenden në faqen BIG DEAL në Prishtina Insight <https://prishtinainsight.com/reports/>

Sipas Marrëveshjes së Dejtonit, pushteti në Bosnjë dhe Hercegovinë është i ndarë ndërmjet dy entiteteve autonome (Federata e Bosnjës dhe Republika Serbe). Marrëveshja u dha serbëve të Bosnjës pushtet real në nivel shtetëror dhe fuqinë e vetos në shumë vendime strategjike. Ekziston një frikë në mesin e publikut në Kosovë se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe mund t'i përngjajë Republikës Serbe duke kërcënuar pushtetin qendror të shtetit.

Për më tepër, dezinformimi rreth shpërthimit të mundshëm të një lufte të re mes Serbisë dhe Kosovës nxit edhe më shumë tensionet. Në nëntor të vitit 2022, përfaqësuesit serbë në institucione në katër komunat veriore, që janë të banuara me shumicë dërmuese me serbë, kanë dhënë dorëheqje.⁷

Ndarja historike, arsimore, gjuhësore dhe kulturore që ekziston ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë prek edhe peisazhin medial. Pas luftës, në Kosovë janë themeluar media monoetnike. Ato shpesh raportojnë rreth çështjeve që u përkasin vetëm njërit komunitet.

Sipas pakos së Ahtisaarit,⁸ transmetuesi publik, Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ishte menduar ta mbushë hendekun duke krijuar dy kanale transmetimi, një në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën serbe, për të ofruar përfaqësim medial për të dy komunitetet. Kanali në gjuhën serbe, RTK 2, u themelua por deri më tani ai vazhdon të ketë vështirësi që të depërtojë në komunitetin serb.

Radio Televizioni i Kosovës ka dështuar të shtyjë përpara një parapagim për transmetuesin publik që do t'i mundësonte atij të mos jetë i varur nga financimi prej të buxhetit të shtetit. Duke marrë parasysh se investimi privat është i limituar, kjo ka krijuar një situatë ku shumica e mediave në gjuhën serbe në Kosovë të jenë kryesisht të varura nga mbështetja financiare nga Serbia, gjë që e ka penguar pavarësinë e tyre. Mediat në gjuhën shqipe në Kosovë, nga na tjetër, kanë financime më të larmishme nga burimet private dhe donatorët ndërkombëtarë, gjë që i bën ato më të qëndrueshme dhe më pak të varura nga financimi shtetëror (vetëm transmetuesi publik, RTK, është i varur nga financat e shtetit sa i përket mediave shqiptare të Kosovës).

Trajtimi i dezinformimit paraqet sfida të konsiderueshme, sidomos rreth efikasitetit të trupave rregulluese të mediave. Komisioni i Pavarur për Media lëshon licenca dhe mbikëqyr zbatimin e kodit të etikës nga mediat audiovizuale, përderisa Këshilli i Mediave të Shkruara i trajton mediat online përmes vetë-rregullimit.

Megjithatë, funksionaliteti i KPM-së është penguar për shkak të mungesës së një bordi të plotë dhe refuzimit të qeverisë për të emëruar anëtarë të mjaftueshëm në këtë institucion

⁷ Kosovo: Serbs Agree to Dismantle Barricades After Talks," BBC News, December 29, 2022, <https://www.bbc.com/news/world-europe-64117730>

⁸ Comprehensive Proposal for the Kosovo Status Settlement. United Nations Security Council Report. March 2007. <https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kosovo%20S2007%20168.pdf>

për disa muaj gjatë 2022/2023. Si pasojë e kësaj, në atë periudhë, aftësia e KPM-së për t'i mbikëqyrur mediat ka qenë e kufizuar, gjë që ka rezultuar me dështimin e tij për t'i përmbushur obligimet në rregullimin e mediave. Si pasojë, institucioni ka pasur periudha të vonesave në marrjen e vendimeve. Për më tepër, përpjekjet e KPM-së janë të kufizuara me që institucioni ka të punësuar vetëm një numër të vogël të monitoruesve.⁹

Në anën tjetër, KMSHK¹⁰ ka ndërmarrë disa iniciativa për t'i zbatuar rregulloret dhe urdhërat brenda tregut të mediave online siç është përditësimi i kodit të shtypit dhe etikës me instruksione të qarta se si të përballet me dezinformimin.¹¹

Sistemi i drejtësisë gjithashtu dështon të merret me shkeljet nga ana e medias. Hulumtimi i kryer nga BIRN tregon se më pak se 10% e rasteve janë procesuar në mënyrë adekuate ose janë zgjidhur deri më tani.¹² Sistemi i drejtësisë ka trajtuar keq edhe rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e autorit. Hulumtimi i BIRN tregon se disa padi që kanë të bëjnë me të drejtën e autorit nuk janë adresuar nga ana e gjykatave.¹³

Popullsia e Kosovës është veçanërisht e pambrojtur nga dezinformimi për shkak të sistemit të dobët arsimor në vend. Nxënësit e Kosovës u ranguan ulët në testin e Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) i cili tregoi se nxënësve në Kosovë u mungon aftësia për mendim kritik. Përkundër kësaj, qeveria nuk ka nisur ndonjë strategji për ta adresuar edukimin për mediat në shkolla.¹⁴

Për ta adresuar hendekun me ligjet dhe agjencitë që merren me sigurinë kibernetike, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Sigurinë Kibernetike në fillim të vitit 2023. Ky ligj parasheh themelimin e një agjencie që adreson sfidat që lidhen me sigurinë kibernetike.

Indeksi për Edukimin Medial e rangoi Kosovën në vendin e 39-të nga 41 shtete të Evropës.¹⁵ Përderisa edukimi për media është në nivel të ulët, Kosova është e ranguar lart

⁹ Komisioni i Pavarur për Media, Raporti vjetor për 2021 i dorëzuar në Kuvendin e Kosovës, Faqe 9, 78, <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Komisioni%20i%20Pavarur%20i%20Mediave%20Raporti%20Vjetor%20i%20pun%C3%ABs%20s%C3%AB%20KPM-s%C3%AB%20p%C3%ABr%20vitin%202021.pdf>

¹⁰ Anëtarët e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) përfshijnë media në gjuhën shqipe, serbe e turke: Arberesh.info, Betimi për Drejtësi, Bota Sot, Botapress.info, Buletini Ekonomik, Ekonomia Online, Epoka e Re, Fakte Plus, Front Online, Gazeta Blic, Gazeta Express, Gracanica Online, Indeksonline, Infosot, InLajmi, Insajderi, Jeta në Kosovë, Kallxo.com, Katror.info, Koha Ditore, Kosova Info, Kosova Live, Kosova Post, Kosovapress, Kosovo 2.0, Kultplus, Lajmi.net, Motilokal.com, Nacionale, New Perspektiva, PaRrotlla, Periskopi, Portali Radio Kontakt Plus, Radio Gorazdevac, Radio Kosovska Mitrovica, RajoniPress, Reporter.net, Sbuker, Shqip.com, Sinjali, Sporti1, SuharekaOnline, Tan Haber, Telegrafi, Tribuna, Veriu.info, Zëri.

¹¹ Këshilli i Mediave të Shkruara i Kosovës. KODI i përditësuar i Shtypit, Qershor 2022. http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2022/06/presscode_design_47x10.5_EN_May-2022.pdf

¹² "Më pak se 10% e padive për shpifje me përgjigje nga gjykata", Kallxo, April 24, 2022, <https://kallxo.com/gjate/analize/me-pak-se-10-e-padive-per-shpifje-me-pergjigje-nga-gjykata/>

¹³ "Dosjet e heshtura të të drejtave të autorit", Kallxo, May 27, 2022, <https://kallxo.com/gjate/dosjet-e-heshtura-te-te-drejtave-te-autorit/>

¹⁴ "Rezultatet e Kosovës në testin PISA 2018", Kallxo, December 3, 2019, <https://kallxo.com/lajm/dokument-rezultatet-e-kosoves-ne-testin-pisa-2018/>

¹⁵ OSIS, How It Started, How It is Going: Media Literacy Index 2022, October 2022, p.9. https://osis.bg/wp-content/uploads/2022/10/HowItStarted_MediaLiteracyIndex2022_ENG_.pdf

në përdorimin e mediave dhe shpërndarjen e internetit. Në vitin 2022, Kosova ka pasur numrin më të madh të amvisërive në Evropë me qasje në internet në shtëpi (96%), sipas Eurostat.¹⁶ Përqindja është më e larta në rajon dhe më e lartë se mesatarja e Bashkimit Evropian (91%). Shkalla e përhapjes së internetit është afërsisht 97%.¹⁷ Mediat online dhe rrjetet sociale janë ndër burimet kryesore të informacionit përveç televizionit, i cili është ndër burimet më të përdorura dhe më të besueshme të informacionit në Kosovë.¹⁸ Deri në janar 2022, Kosova ka pasur rreth 1.04 milion përdorues të rrjeteve sociale. Facebook është rrjeti social më i përdorur me mbi 869 mijë përdorues.¹⁹

Përdorimi i gjerë i rrjeteve sociale dhe mungesa e edukimit për media ofrojnë një terren të plleshëm për dezinformim dhe keqinformim. Studimet e mëhershme tregojnë se shumica e popllsisë në Kosovë nuk mund ta dallojnë informatën e saktë nga ajo e rreme.²⁰ Për më tepër, sipas një hulumtimi të bërë nga Këshilli i Mediave të Shkruara,²¹ rreth 60% e mediave online operojnë pa redaktim apo mekanizma filtrimi të përmbajtjes para publikimit. Kjo e rrit mundësinë që informacioni i pasaktë të publikohet online.

Është e rëndësishme të theksohet trendi i mediave me proceset politike e sociale. Në vitin 2022, Indeksi i Lirisë së Shtypit i Reporterëve pa Kufij e rangoi Kosovën në vendin e 61-të në mesin e 180 vendeve, 17 pozita më lart se në vitin 2021.²² Ky është rangimi më i lartë që nga viti 2009; megjithatë, duhet theksuar se metoda e kalkulimit ka ndryshuar në vitin 2022. Sipas Indeksit të vitit 2022, Kosova u rangua më lart se shtetet fqinje si Mali i Zi (63), Serbia (79) dhe Shqipëria (103), si dhe më lart se disa shtete të BE-së si Bullgaria (91) dhe Greqia (108). Edhe pse korniza ligjore në Kosovë garanton lirinë e mediave, Freedom House, një organizatë që monitoron lirinë e mediavë në mbarë botën, vëren se interesat e politikanëve dhe bizneseve ndikojnë në qëndrimet editoriale të mediave të Kosovës.²³ Siguria e gazetarëve është një çështje tjetër, sidomos që nga koha kur ka filluar një numër i sulmeve ndaj gazetarëve në veri të Kosovës gjatë incidenteve të vitit 2022 dhe 2023.²⁴

¹⁶ "Basic figures on the Western Balkans and Turkey - Factsheets, 2022 Edition", Eurostat, <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/4031688/14589427/KS-05-22-089-EN-N.pdf/35508d49-956b-9f20-2c47-1b38636e38b6?t=1651049579047>

¹⁷ "DataReportal, Kosovo Digital Report 2022", <https://datareportal.com/reports/digital-2022-kosovo>

¹⁸ "Dren Gërguri et al., Roli i medieve në perceptimin e publikut të Kosovës për luftën në Ukrainë, raport hulumtues, Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, korrik 2022; National Democratic Institute, Information Integrity in Kosovo: Assessment of the Political Economy of Disinformation, July 2022, <https://www.ndi.org/sites/default/files/Information%20Integrity%20in%20Kosovo%20-%20Assessment%20of%20the%20Political%20Economy%20of%20Disinformation.pdf>

¹⁹ DataReportal, Kosovo Digital Report 2022, <https://datareportal.com/reports/digital-2022-kosovo>

²⁰ Gëzim Qerimi & Dren Gërguri, Infodemic and the Crisis of Distinguishing Disinformation from Accurate Information: Case Study on the Use of Facebook in Kosovo during COVID-19. *Information & Media*, 94, 2022.

²¹ Qerim Ondozi, Misinformation, Disinformation and Fake News in Online Media in Kosovo, June 2022, http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2022/09/Raporti_Keqinformimi_ENG_Final-2.pdf

²² Reporters Without Borders, 2022 Press Freedom Index, <https://rsf.org/en/index>.

²³ Freedom House, Freedom in the World 2022: Kosovo. <https://freedomhouse.org/country/kosovo/freedom-world/2022>

²⁴ Reporters Sans Frontiers. After an increase in attacks on journalists in Kosovo, police and international forces asked to provide better protection. December 30th, 2022. <https://rsf.org/en/after-increase-attacks-journalists-kosovo-police-and-international-forces-asked-provide-better>

Metodologjia

Hulumtimi është kryer në shtatë faza: Një përshkrim i detajuar i metodologjisë i është bashkëngjitur këtij raporti:

Faza e parë:

Identifikimi i 41 fjalëve kryesore/kyçe (keywords) dhe platformave automatike monitoruese; Identifikimi dhe rishikimi manual i dezinformimit jashtë fjalëve kryesore të vendosura;

Faza e dytë:

Mbi 1,000 lajme/informata të bazuara në fjalët kyçe; Rreth 1,065 lajme të analizuar për përmbajtje të dyshimtë nga Krypometri, detektori i rrenave i BIRN-it;

Faza e tretë:

Hulumtimi i opinionit publik identifikoi 12 narrativa dezinformuese;

Faza e katërt:

Ekperimenti social i bërë identifikoi pesë grupe institucionale që janë të prirur t'u besojnë dezinformatave: gjykatësit, prokurorët, mësuesit, punëtorët socialë dhe mjekët;

Faza e pestë:

Mbajtja e pesë fokus-grupeve me palët e interesit për të matur kapacitetet e tyre për luftimin e dezinformimit dhe për të mos rënë pre e dezinformatave me anëtarë të Këshillit të Mediave të Shkruara, menaxherë të rrjeteve sociale, zyrtarë të institucioneve të sigurisë, gazetarë dhe organizata të shoqërisë civile.

Faza e gjashtë:

Analizimi i të dhënave të mbledhura dhe hartimi i raportit.

Faza e shtatë:

Validimi i të dhënave dhe informacionit të mbledhur me ekspertët.

Figura 2: Harta e mbledhjes së të dhënave dhe metoda e përdorur (metodologjia e detajuar e bashkëngjitur ne Akensin I).

Harta a mbledhjes së të dhënave

Monitorimi i drejtpërdrejtë

TV & Uebsajte

40 burime

Influencuesit dhe politikanët

60 burime

Mbi 1,000
raportime të identifikuar

1,065 artikuj
të identifikuar me narrativa të ndryshme

6 deri 14 mars 2023

OMNIBUS

Mbledhja e të dhënave

1,056
respondentë të kontaktuar

50.4%
gra



49.6%
burra



12 pyetje
rreth lajmeve të reme

19 pyetje
rreth burimeve

Eksperimenti social

50 zyrtarë publikë

Mësues

Mjekë

Prokurorë

Gjykatës

Punëtorë socialë

5 grupe të fokusit

40 përfaqësues

Përfaqësues të mediave

Anëtarë të Këshillit të Mediave të Shkruara

Menaxherë të rrjeteve sociale

Zyrtarë të institucioneve të sigurisë

Analizimi dhe shqyrtimi i të dhënave të fituara

Autorët dhe hulumtuesit analizojnë narrativat e identifikuar

3 ekspertë të pavarur rishikojnë raportin

Aneksi prezanton metodologjinë dhe definicionet e përdorura në raport

I. Gjetjet rreth ndikimit nga jashtë dhe propagandës kundër integritimit

Studimi ka gjetur se ndërmjet 15 tetorit 2022 dhe 15 marsit 2023, Kosova ka qenë e prekur nga dezinformimi dhe ndikimi nga jashtë. Një pjesë e studimit është fokusuar në identifikimin dhe shpërndarjen e artikujve të ndikuar nga Rusia dhe Kina.

Studimi identifikoi dezinformimin rus që fokusohej në narrativat anti-NATO dhe anti-perëndim. Kriza Kosovë-Serbi ishte nxitur nga deklaratat e liderëve politikë të të dyja palëve si dhe nga fushatat dezinformuese ruse të cilat promovojnë narrativa që ndajnë komunitetet. Të dhënat nga monitorimi, hulumtimi i opinionit dhe eksperimentet sociale tregojnë se Kosova është në mënyrë të drejtpërdrejtë e prekur nga narrativat dezinformuese nga Rusia dhe Serbia rreth sigurisë politike dhe integritimit euro-atlantik. Për më tepër, dezinformimi nga Kina e Rusia preku ekonominë dhe fushën e mjekësisë gjatë një periudhe të inflacionit duke nxitur panik rreth mungesave në furnizime tregtare.


Harta e narrativave dezinformuese të propagandës së ndikuar nga jashtë dhe kundër integritimit



Politikanët në Kosovë kanë shprehur mbështetje për qeverinë e Ukrainës, përderisa disa serbë lokalë kanë shprehur mbështetje për Rusinë dhe invazionin e saj në Ukrainë. Në Prishtinë ka pasur shprehje masive të mbështetjes për Ukrainën përderisa në Mitrovicën e Veriut janë shfaqur grafito me shkronjën 'Z', në mbështetje të Putinit.

Në mënyrë që të analizohen narrativat luftënxitëse që kanë frymëzuar tensione në Kosovë, ne e kemi strukturuar këtë pjesë të analizës në nën-narrativat si më poshtë:

Figura 4: Harta e ndikimit kinez në media dhe publik bazuar në të dhënat e monitoruara



1.1 Narrativat luftënxitëse të dezinformimit nga Kremli

BIRN ka identifikuar burime të shumta që vijnë nga Rusia të cilat influencojnë narrativat e propagandës dhe dezinformimit rreth Kosovës.

Rusia është duke e vëzhguar rajonin. Rusia kundërshtoi ashpër fushatën e bombardimeve të NATO-s të vitit 1999 dhe, pa sukses, kërkoi vazhdimisht nga NATO që ta ndalë zgjerimin në Ballkan. Gjithashtu, si anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ajo ka bllokuar njohjen e pavarësisë së Kosovës në OKB. Rusia në mënyrë aktive përhap ndikimin e vet në Ballkan dhe ka ndikim të jashtëzakonshëm në Serbi. Ky është konteksti politik në të cilin narrativa dezinformuese e Rusisë gjen terren të plleshëm për t'u kultivuar dhe rritur në Kosovë (jo vetëm në Serbi).

Narrativat dezinformuese të përhapura përmes uebfaqeve zyrtare shtetërore ruse dhe mediave pro-Kremli kanë nisur nga presidenti Vladimir Putin dhe janë forcuar nga zyrtarë tjerë rusë. Një nga narrativat kryesore ruse rreth Kosovës synon rrejshëm të krijojë analogji mes Kosovës dhe rajoneve ukrainase të Donbasit dhe Luhanskut. Kjo narrativë është e ancoruar në logjikën se Rusia ka të drejtë të ndërhyjë në rajone specifike të Ukrainës të cilat më pas të mund t'i shpëtojë, në mënyrë të njëjtë siç ndërhyri NATO duke bombarduar Serbinë, që rezultoi më pas me pavarësinë e Kosovës.

Një tjetër narrativ i rremë i Kremli është ai se shqiptarët e Kosovës po i bashkohen ushtrisë së Ukrainës në luftën kundër Rusisë.

Së fundmi, Kremli gjithashtu pretendon se qeveria e Kosovës planifikon një operacion për t'i larguar serbët nga Kosova.

Në mars të vitit 2022, Putin zhvilloi një bisedë me Kancelarin e Gjermanisë, Olaf Scholz, në të cilën ai pretendoi se shqiptarët e Kosovës po i bashkoheshin luftës në Ukrainë, duke theksuar se “ne jemi duke dokumentuar gjithnjë e më shumë paraqitjen e mercenarëve nga vendet e treta përfshirë Shqipërinë dhe Kroacinë, militantët nga Kosova madje edhe xhihadistë me përvojë nga lufta e Sirisë”.²⁵

Institucionet e Kosovës e kanë mohuar krejt këtë.²⁶

Në sesionin plenar të Forumit Ekonomik Lindor më 7 shtator 2022, Presidenti Putin përmendi Kosovën sërish në kontekst të shpëtimës së Donetskut dhe Luhanskut nga Ukraina.²⁷

²⁵ Biseda telefonike mes Presidentit të Rusisë Vladimir Putin dhe Kancelarit të Gjermanisë, Olaf Scholz, 4 mars 2022, President of Russia, Events, <http://en.kremlin.ru/events/president/news/67907>

²⁶ Agjencia e lajmeve KosovaPress. There are Kosovo citizens fighting in Ukraine. April 2022. <https://kosovapress.com/en/there-are-no-kosovo-citizens-fighting-in-ukraine/>

“Karta e OKB-së ka një dispozitë rreth të drejtave të kombeve për vetëvendosje. Gjatë krizës në Kosovë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vendosi që nëse një pjesë e territorit, një pjesë e vendit, zgjedh ta shpallë pavarësinë, nuk ka nevojë ta pyesë qeverinë qendrore të atij vendi për leje. Ky ishte rasti me Kosovën. A nuk është e njëjtë situata me Republikën e Donetskut dhe Republikën e Luhanskut? Është e njëjtë. Meqë ata e kishin këtë të drejtë - dhe ata e kanë atë në përputhje me Kartën e OKB-së dhe të drejtën e vetëvendosjes - ata e shfrytëzuan atë dhe e shpallën pavarësinë. A e kanë ata këtë të drejtë sipas të drejtës ndërkombëtare dhe Kartës së OKB-së? E kanë, dhe kjo e drejtë është përsëritur nga vendimi korrespondues i Gjykatës së OKB-së në lidhje me Kosovën. Ky është një precedent.”²⁸

Putin e ka përsëritur këtë narrativë në disa raste tjera.²⁹

Për më tepër, qeveria ruse e ka përsëritur narrativën se autoritetet e Kosovës kanë planifikuar përzënien e serbëve nga Kosova.

Më 31 korrik 2022, zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme të Rusisë, Maria Zahharova, tha “një vendim i ‘autoriteteve’ në Prishtinë për të filluar aplikimin e rregullave të paarsyeshme diskriminuese rreth ri-lëshimit të detyruar të dokumenteve personale dhe tabelave të veturave për serbët lokalë nga 1 gushti është një hap tjetër drejt përzënies së popullatës serbe nga Kosova dhe largimit të serbëve të Kosovës nga institucionet që mbrojnë të drejtat e banorëve serbë nga veprimet arbitrare të radikalëve të Prishtinës të drejtuar nga ‘Kryeministri’ Albin Kurti. Liderët e Kosovës e dinë që serbët nuk do të rrinë indiferentë kur bëhet fjalë për sulmet e drejtpërdrejta ndaj lirive të tyre dhe janë duke përkeqësuar qëllimshëm situatën në mënyrë që të nisin një skenar të dhunshëm”.³⁰ Ajo më tej bëri ShBA-të dhe BE-në përgjegjës për këto zhvillime.

Ngjashëm si kjo, në janar të vitit 2023, Ambasadori i Rusisë në Beograd akuzoi shqiptarët për sulm ndaj fëmijëve serbë dhe për sulm të koordinuar ndaj serbëve të Kosovës duke thënë se “radikalët nga Prishtina, të drejtuar nga ‘kryeministri’ i provincës Kurti, vazhdojnë të nxisin serbofobi me bekimin e perëndimorëve”.³¹

Narrativa ruse gjithashtu e lidhi angazhimin e BE-së në Ballkan me incidentet e dhunshme në Kosovë. Zakharova, zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme, tha se “disa njerëz e kanë vërejtur se situata në Kosovë eskaloj menjëherë pasi Bashkimi Evropian mbajti një samit në Shqipëri (<https://is.gd/v3XhoQ>), në të cilin morën pjesë shtetet e Ballkanit Perëndimor”.³²

²⁷ *Eastern Economic Forum plenary session - Remarks by President Vlafimir Putin, September 7, 2022, President of Russia, Events, <http://en.kremlin.ru/events/president/news/69299>*

²⁸ *Ibid.*

²⁹ *St. Petersburg International Economic Forum Plenary session - Remarks by President Vladimir Putin, June 17, 2022, <http://en.kremlin.ru/events/president/news/68669>*

³⁰ *Komente nga Maria Zakharova, Zëdhënëse e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, Faqja zyrtare në Facebook, 31 korrik 2022. <https://www.facebook.com/photo/?fbid=364141262575607&set=a.225128283143573>*

³¹ *Ambasada ruse në Serbi (Посольство России в Сербии), Telegram Channel, 9 janar 2023, <https://t.me/rusembserbia/239>*

³² *Ministria e Jashtme e Rusisë - МИД России - Facebook, 18 dhjetor 2022, Opinion nga Maria Zakharova*

Ndërmjet tetorit 2022 dhe janarit 2023, Rusia ka zhvilluar një fushatë të gjerë për të krijuar mosbesim ndaj NATO-s, BE-së dhe ShBA-ve në Kosovë. Platforma e BE-së rreth dezinformimit rus thekson narrativat që akuzojnë NATO-n³³ dhe shtete specifike perëndimore³⁴ për nxitje të një lufte të re³⁵ në veri të Kosovës për ta dëmtuar Rusinë.

Të dhënat e monitorimit të mediave tregojnë se mediat në Kosovë ripublikuan propagandën ruse pa i vendosur ndonjë kontekst, redaktim ose ndonjë pikëpamje balancuese. Hulumtimi i BIRN gjeti artikuj në gjuhën shqipe që ishin riprodhime të dezinformatave me origjinë nga mediat ruse ose që platformat e BE-së i kanë identifikuar si narrativa të dezinformimit rus.

Të dhënat e monitorimit të mediave tregojnë se rusët e shpërndajnë propagandën se NATO dhe perëndimi kanë kryer pastrim etnik ndaj serbëve të Kosovës dhe se NATO po përpiqet të nxisë konflikt të ri në Kosovë.³⁶ Këto narrativa janë identifikuar nga EUvsDisinfo.³⁷ Më 30 prill 2023, një ditë pas zgjedhjeve për kryetarë të komunave në komunat veriore të Kosovës, Zakharova tha se këto zgjedhje treguan se “sa e rrezikshme është politika perëndimore në rajon dhe se pastrimi etnik dhe diskriminimi nuk mund të kontribuojnë në paqe dhe pajtim”.³⁸

Narrativa e njëjtë është publikuar edhe në Sputnik,³⁹ dhe arriti edhe në mediat e Kosovës (lajmi 1 dhe 2).⁴⁰ Deklarata e saj e plotë ishte publikuar në mediat në gjuhën shqipe pa ndonjë informacion shtesë rreth realitetit të situatës në terren. Tekstit nuk i është shtuar asnjë kontekst apo informacion shtesë për ta balancuar narrativën dezinformuese ruse si deklaratat e zyrtarëve të BE-së dhe ShBA-ve apo vendimi i institucioneve të Kosovës për t'i shtyrë zgjedhjet deri në fund të vitit 2022. Një postim i bërë në Twitter nga profili i Russia in the UN⁴¹ dhe komunikata e lëshuar nga Lista Serbe promovuan të njëjtat akuza.

Në një nga narrativat dezinformuese ruse të indentifikuar nga EUvsDisinfo, propaganda ruse thotë se prania e KFOR-it në veri “është një kërcënim i vazhdueshëm për popullatën”

³³ “Kremlin ABC: Adapt, Focus, Blame Others, Cancel Events,” EU vs Disinfo, December 15, 2022, <https://euvsdisinfo.eu/kremlin-abc-adapt-focus-blame-others-cancel-events/>

³⁴ “Joe Biden May Be Planning to Put Together a Team of Neocons to Find the Next Victim for the Pentagon to Try Out New Weapons Systems,” EU vs Disinfo, November 18, 2020, <https://euvsdisinfo.eu/report/joe-biden-may-be-planning-to-put-together-a-team-of-neocons-to-find-the-next-victim-for-the-pentagon-to-try-out-new-weapons-systems>

³⁵ “NATO Escalated the Situation in Kosovo to Distract Russia from Ukraine,” EU vs Disinfo, December 12, 2022, <https://euvsdisinfo.eu/report/nato-escalated-the-situation-in-kosovo-to-distract-russia-from-ukraine>

³⁶ “NATO Decided to Invade the Serbian Enclave of Mitrovica to Punish Belgrade,” EU vs Disinfo, December 13, 2022, <https://euvsdisinfo.eu/report/nato-decided-to-invade-the-serbian-enclave-of-mitrovica-to-punish-belgrade>

³⁷ “Disinformation Cases,” EU vs Disinfo, <https://euvsdisinfo.eu/disinformation-cases/?text=NATO%2C%20Kosovo&date=&orderby=date>

³⁸ Russian Foreign Ministry Spokeswoman Maria Zakharova Gives Weekly Briefing, Youtube Video, Timestamp: 1:15:47, April 27, 2023, <https://youtu.be/eCTBALGezbQ?t=4547>

³⁹ “The West is an Accomplice of the Ethnic Cleansing of Serbs in Kosovo,” EU vs Disinfo, December 19, 2023 <https://euvsdisinfo.eu/report/the-west-is-an-accomplice-of-the-ethnic-cleansing-of-serbs-in-kosovo>

⁴⁰ <https://nacionale.com/politike/zaharova-serbet-e-kosoves-kane-treguar-dinjitet-kombetar-duke-mos-marre-pjese-ne-zgjedhje> & <https://gazetablic.com/rusia-per-zgjedhjet-ne-veri-te-kosoves-serbet-refuzuan-pjesemarrjen-treguan-dinjitet-dhe-unitet/>

⁴¹ RussiaUN, Twitter post, April 21, 2022, <https://twitter.com/RussiaUN/status/1516902544412483588>

dhe se “NATO, njëjtë siç ka vepruar në vendet tjera nëpër botë, mund gjithashtu ta krijojë një shkas për t’i sulmuar serbët e Kosovës”.⁴² Narrativa e njëjtë ishte publikuar në të paktën 18 media në gjuhën shqipe⁴³ dhe mori 63 ndërveprime.⁴⁴ Kjo narrativë ishte përsëritur nga burime jo-ruse.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, hodhi dyshime mbi aftësinë e KFOR-it për të garantuar siguri për serbët e Kosovës, duke nxitur një fushatë të gjerë kundër KFOR-it. Kjo narrativë ishte përdorur në vitin 2019⁴⁵ dhe në 2023.⁴⁶ Narrativa e Serbisë se KFOR nuk po i mban serbët të sigurt, ishte përdorur si argument më vonë nga Vuçiqi për të kërkuar kthimin e ushtrisë serbe në Kosovë.⁴⁷ Kjo kërkesë ishte paraprirë nga disa ngjarje tjera. Fillimisht, më 5 nëntor 2022, serbët e Kosovës dhanë dorëheqje nga të gjitha institucionet publike në komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Dorëheqjet krijuan një hendek të thellë në polici, institucione të drejtësisë dhe në praninë civile në këtë zonë.

Më 11 dhjetor 2022, kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, paralajmëroi serbët e Kosovës se një operacion i ngjashëm me operacionin “Stuhia” (Oluja), i cili u zhvillua në Kroaci në vitin 1995,⁴⁸ është gati të ndodhë në Kosovë. Operacioni Stuhia ishte një ofensivë ushtarake që synonte rimarrjen e vendbanimeve të Republikës së Kroacisë të cilat ishin okupuar nga forcat rebele serbe. Operacioni çoi në numër të madh të viktimave dhe nxiti eksod masiv të serbëve nga kjo zonë. Serbët e perceptojnë operacionin Stuhia si një ngjarje të pastrimit etnik, që ka shkaktuar zhvendosje të gjerë të popullatës civile dhe shkelje të të drejtave të njeriut, përfshirë edhe vrasje. Në të kundërtën, shumë kroatë e shohin atë si operacion të domosdoshëm ushtarak për rivendosjen e integritetit territorial të Kroacisë gjatë luftës së kroatëve për pavarësi.

Deklarata e Rakiqit nuk ishte e bazuar në fakte por ajo qe ripublikuar në mediat në gjuhën serbe⁴⁹ dhe shqipe⁵⁰. Deklarata e tij ishte publikuar 75 herë në Facebook dhe mori 1,700 ndërveprime (like, komente, shpërndarje, tags etj). Kjo deklaratë u pasua nga deklaratat e

⁴² “Having NATO in Kosovo is a Risk for the Population as the West is Expert in Creating Conflict,” EU vs Disinfo, January 9, 2023, <https://euvsdisinfo.eu/report/having-nato-in-kosovo-is-a-risk-for-the-population-as-the-west-is-expert-in-creating-conflict>

⁴³ “Vuçiq si Putini: Po rrezikohet mbijetesa e serbeve në Kosovë”, BotaPress, October 27, 2022, <https://botapress.info/vuciq-si-putini-po-rrezikohet-mbijetesa-e-serbeve-ne-kosove/>

⁴⁴ “Data from CrowdTangle”, accessed at <https://apps.crowdtangle.com/auth?view=3>

⁴⁵ “Vuçiq: Nëse KFOR-i s’i mbron serbët, ka kush ta bëjë këtë”, Insajderi, March 2019, <https://insajderi.com/vuciq-nese-kfor-i-si-mbron-serbet-ka-kush-ta-beje-kete/>

⁴⁶ “Serbia nis kërkesë të KFOR-i për kthimin e ushtarëve dhe policëve në Kosovë”, Radio Free Europe/Radio Liberty, December 15, 2022, <https://www.evropaelire.org/a/vuciq-kfor-kosova-/32178648.html>

⁴⁷ Ibid.

⁴⁸ “Paralajmërimi i Rremë i Goran Rakiqit për Operacionin ‘Oluja’”, Kallxo, December 11, 2022, <https://kallxo.com/krypometer/paralajmimerimi-i-rreme-i-goran-rakiqit-per-operacionin-oluja/>

⁴⁹ “Dëgjohen breshëri zjarri dhe shpërthimi, shkollat në veri të Republikës së Kosovës nga nesër nuk do të hapen” (Чуле се рафална палба и детонација, школе на северу КуМ од сутра неће радити), Radio Televizioni i Serbisë (RTS), 11 dhjetor 2022, <https://www.rts.rs/vesti/politika/5051638/sever-kosovo-i-metohija-barikade-.html>


⁵⁰ “Rakiq: Sonte Kurti do dërgojë Rosu në dhe njësi të armatosura në veri të Kosovës” InLajmi, 11 dhjetor 2022, <https://inlajmi.com/2022/12/11/rakiq-sonte-kurti-do-dergoje-rosu-ne-dhe-njesi-te-armatosura-ne-veri-te-kosoves/>

Figura 5: Ilustrimi i shpërndarjes së narrativit

Narrativa dezinformuese

Rakiq:

“Albin Kurti njoftoi se sonte do ta dërgojë njësinë speciale të policisë dhe njerëz tjerë të armatosur në veri të Kosovës për ta ndjekur popullin tonë dhe për ta ndërmarrë operacionin ‘Stuhia’”.



76 postime

1,703 ndërveprime

Vuçiqit drejtuar NATO-s që kërkonte kthimin e 1,000 ushtarëve serbë në Kosovë.⁵¹ Vuçiq deklaroi se “4,000 paqeruajtësit ndërkombëtarë, të njohur si KFOR, nuk kanë qenë në gjendje ta ruajnë paqën në rajonet etnike serbe në veri të Kosovës dhe se qeveria do ta bëjë kërkesën javën tjetër.”⁵²

Tri javë kaluan ndërmjet kohës kur qeveria e Serbisë parashtrroi kërkesën për dërgim të 1,000 trupave në Kosovë (15 dhjetor 2022)⁵³ dhe kohës kur NATO e ktheu përgjigjen (6 janar 2023).⁵⁴ Brenda kësaj periudhe trijavore, u publikuan 307 artikuj në rrjete sociale rreth gatishmërisë së ushtrisë serbe për të hyrë në Kosovë. Këta 307 artikuj morën 10,500 ndërveprime në rrjete sociale⁵⁵. Dy profile në Facebook publikuan lajmin që thoshte se Aleksandar Vuçiq kishte një plan të shkaktonte trazira. Mekanizmi i verifikimit të fakteve Krypometri gjeti se kjo ishte e rreme,⁵⁶ por informacioni ishte publikuar në dhjetë faqe në Facebook dhe mori 20 ndërveprime.

Në anën tjetër, qeveria e Kosovës po e shtynte një narrativë tjetër muaj para krizës në veri. Kjo narrativë fajësonte Rusinë dhe qeverisjen e Vuçiqit për të gjitha problemet e Kosovës me Serbinë. Në një intervistë në gusht të vitit 2022, kryeministri i vendit Albin Kurti, deklaroi: “Ne po rrezikohemi me luftë. Putini është prapa Serbisë. Nuk mund të them se rreziku është i lartë, pasi që kemi kontingjentin e NATO-s këtu, por është vërtet i lartë. Ne jemi një demokraci që është e rrethuar me autokraci (vendet fqinje)”.⁵⁷ Për më tepër, në dhjetor 2022, qeveria e Kosovës tha të ketë zbuluar një plan rus për t'i rritur tensionet.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi tha më 19 dhjetor 2022 se ka pasur një plan rus për ta djegur pikën kufitare të Jarinjës në veri të Kosovës.⁵⁸ Kjo gjë nuk është konfirmuar asnjëherë. Jeton Zulfaj, këshilltar i kryeministrit Kurti tha se qeveria e Kosovës ka vendosur të mos i largojë barrikadat me forcë për shkak se “grupet ruse që donin eskalim të situatës ishin infiltruar në zonë”.⁵⁹

Në përgjithësi, ka pasur dy narrativa të kundërta me njëra-tjetrën. Zyrtarët publikë të Kosovës thonin se protestuesit që vendosën barrikadat ishin grupe kriminale të lidhura

⁵¹ “Serbia Will Ask KFOR For Permission To Intervene In Kosovo, Vučić Says”, Radio Free Europe/Radio Liberty, December 10, 2022, <https://www.rferl.org/a/kosovo-serbia-tensions-pm-comment/32170704.html>

⁵² Ibid.

⁵³ “Serbia nis kërkesë të KFOR-i për kthimin e ushtarëve dhe policëve në Kosovë”, Radio Free Europe/Radio Liberty, Nëntor 2022, <https://www.evropaelire.org/a/vuciq-kfor-kosova-/32178648.html>

⁵⁴ “Serbian request to deploy troops in Kosovo denied by NATO”, Politico January 8 2023, <https://www.politico.eu/article/nato-denies-serbia-request-deploy-military-kosovo-aleksandar-vucic/>

⁵⁵ Ibid.

⁵⁶ “Titull i Pambështetur në Fakte për Skenarin e Vuçiqit për Veriun”, Kallxo, 28 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/titull-i-pambeshtetur-ne-fakte-per-skenarin-e-vuciqit-per-veriun/>

⁵⁷ “Kosovo, il premier Kurti: “Rischiame la guerra. Dietro la Serbia c’è Putin”, la Repubblica, 17/08/22 https://www.repubblica.it/esteri/2022/08/08/news/kosovo_serbia_tensioni_confine_premier_albin_kurti-36077797/?ref=search

⁵⁸ “Besnik Bislimi: Plani ishte të digjej pika kufitare e Jarinjës”, Kallxo, 19 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/lajm/besnik-bislimi-plani-ishte-te-digjej-pika-kufitare-e-jarinjes/>

⁵⁹ “Këshilltari i Kurtit për barrikadat: Ekzistonte mundësia e eskalimit të situatës”, Koha, 30 dhjetor 2022, <https://www.koha.net/arberi/359353/keshilltari-i-kurtit-per-barrikadat-ekzistonte-mundesia-e-eskalimit-te-situates/>

me Rusinë, përderisa diplomatët ndërkombëtarë në Kosovë konkluduan se aktivitetet në barrikada në veri ishin aktivitete paqësore. Megjithatë, EULEX konfirmoi se persona të armatosur ishin parë në barrikada. Përmes një deklaratë të përbashkët, ShBA dhe BE mirëpritën sigurinë e dhëna nga lidershpi i Kosovës që konfirmojnë se nuk ka listë të arrestimeve për qytetarët serbë të Kosovës ose për ndjekjen e atyre që kanë protestuar në mënyrë paqësore ose që kanë vendosur barrikadat.⁶⁰ Tensionet filluan të bien pas fillimit të negociatave mes Kosovës e Serbisë në Bruksel dhe Ohër në shkurt dhe mars të vitit 2023.


Figura 6: Ndikimi i narrativës rreth rritjes së ekonomisë ruse, sipas hulumtimit Omnibus

Ndikimi i narrativave rreth rritjes së ekonomisë së Rusisë

Të dhënat nga hulumtimi i opinionit (Omnibus) të zhvilluar në maj tregojnë se dezinformimi gjatë kësaj periudhe ka pasur një ndikim te qytetarët.

1,056 qytetarë nga komuniteti shqiptar dhe ai serb u përgjigjën nëse “Rusia pati rritje ekonomike nën sanksionet e BE-së”.

Të dhënat tregojnë se serbët i besojnë dezinformatave se ekonomia e Rusisë po rritet pas sanksioneve.



⁶⁰ “Hiqen barrikadat në veri”, Radio Free Europe, 29 dhjetor 2022, <https://www.evropaelire.org/a/largimi-barrikadat-veri-/32198958.html>

1.2 Narrativa dezinformuese se NATO dhe perëndimi po i mbështesin shqiptarët

Përveç narrativës ruse se BE dhe NATO po provokojnë një konflikt të ri në Mitrovicë, arrestimi i Dejan Pantiqit, ish-pjesëtar i Policisë së Kosovës, më 10 dhjetor 2022, nisi një krizë të re barrikadash dhe një fushatë të re mediale me të cilën NATO portretizohej si agresor në komunat e veriut dhe bashkëpunuese me njësitet speciale të Policisë së Kosovës.

Ky kapitull liston portretizimin negativ të KFOR-it në mediat në gjuhën serbe, të cilat kanë kryesisht selinë në Beograd dhe janë burim i rëndësishëm i informimit për serbët e Kosovës.

Më 7 dhjetor 2022, portali serb i Kosovës⁶¹ në gjuhën serbe raportoi se patrulla e KFOR-it amerikan kishte hyrë në oborrin e një çerdheje në Leposaviq në kohën kur 300 fëmijë ishin duke fjetur. Artikulli ishte publikuar në fillim pa komentin e KFOR-it. Lajmi ishte ripublikuar në një faqe tjetër në Serbi me me titullin e rremë: Trazira në Kosovë, Leposaviqi nën rrethim: KFOR dhe ROSU hynë në çerdhe derisa fëmijët po flinin! Qytetarët u shqetësuan dhe ky ripublikim nuk e ka komentin e KFOR-it me siguri për shkak se është kopjuar nga portali serb i Kosovës i cili në kohën e publikimit nuk e ka pas komentin e KFOR-it lidhur me këtë incident.⁶² Artikulli u ripublikua nga media të ndryshme edhe në Serbi.⁶³ Ky informacion u prezantua si sulm ndaj fëmijëve.⁶⁴

Megjithatë, KFOR shpjegoi se ushtarët e këtij misioni kishin hyrë në oborr të çerdhes për t'i kthyer automjetet e tyre për shkak se e kishin gabuar një kthesë.⁶⁵ Pas këtyre ngjarjeve tensionet mbetën të larta dhe grupet etno-nacionaliste djathtiste mbajtën një protestë afër Leposaviqit më 18 dhjetor 2022. Pak orë para protestës, media e përshkroi këtë si një situatë

⁶¹ Kosovo Online: KFOR: Naša patrola slučajno ušla u dvorište vrtića u Leposaviću (KFOR: Patrulla jonë ka hyrë në oborrin e çerdhes) Kosovo Online, 7 dhjetor 2022, <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/kfor-nasa-patrola-slucajno-usla-u-dvoriste-vrtica-u-leposavicu-7-12-2022>

⁶² "KURTI UDARIO I NA DECU! ROSU upao u dvorište vrtića u Leposaviću, specijalci naoružani do zuba, dok mališani spavaju! (FOTO/VIDEO)" (KURTI GODET EDHE FËMIJËT! ROSU hyn në oborrin e një kopshti në Leposaviq, forcat speciale të armatosura deri në dhëmbë, ndërsa të vegjlit ishin duke fjetur! (PHOTO/VIDEO)", Alo.rs, 8 dhjetor 2022, <https://www.alo.rs/vesti/kim/701052/kosovo-vrtic-policija-leposavic/ves>

⁶³ "NOVA DRAMA NA KOSMETU: ROSU naoružana do zuba bornim kolima upala u dvorište vrtića u Leposaviću dok su deca spavala (VIDEO)" (DRAMË E RE NË KOSMET: ROSU, e armatosur deri në dhëmbë me një mjet luftarak, pushtoi oborrin e një kopshti në Leposaviq derisa fëmijët ishin duke fjetur". Kurir.rs, 8 dhjetor 2022. <https://www.kurir.rs/vesti/politika/4066318/rosu-bornim-kolima-upala-u-dvoriste-obdanista-u-leposavicu-video>

⁶⁴ "DŽIPOVI KFORA UPALI U DVORIŠTE VRTIČA DOK SU DECA SPAVALA! Nisu hteli da razgovaraju, vaspitačice preplašene (Xhipat e KFOR-it HYNË NË OBOR TË NJË KOPSHTI TË FËMIJËVE KUR ATA PO FLININ! Ata nuk donin të flisnin, mësuesit ishin të frikësuar)", Mondo.rs, 7 dhjetor 2022, <https://mondo.rs/Info/Srbija/a1721896/kfor-upao-u-dvoriste-vrtica-u-leposavicu.html>; "KFOR uleteo u vrtić u Leposavići, u njemu bilo 300 dece (KFOR-i sulmoi një kopsht fëmijësh në Leposaviq, ku kishte 300 fëmijë)", Telegraf.rs, 7 dhjetor 2022, <https://www.telegraf.rs/vesti/srbija/3597019-kfor-uleteo-u-vrtic-u-leposavici-u-njemu-bilo-300-dece>; "KFOR u dvorištu vrtića u Leposaviću naoružani automatskim puškama vršljali dok su djeca spavala (FOTO)" (KFOR-i në oborrin e çerdhes në Leposaviq është shfaqur i armatosur me automatikë, derisa fëmijët ishin duke fjetur)" Večernje Novosti, 7 dhjetor 2022, <https://vecernjenovosti.ba/132086/vijesti/srbija/kfor-u-dvoristu-vrtica-u-leposavicu-naoruzani-automatskim-puskama-vrsljali-dok-su-djeca-spavala-foto/>.

⁶⁵ NATO KFOR Press Release, "KFOR vehicles entering the parking of a kindergarten", Email to BIRN Kosova, 7 dhjetor 2022

krize. Mediat në gjuhën serbe gjithashtu raportuan informatën se KFOR-i britanik po i pyeste qytetarët nëse do t'i bashkoheshin protestës, duke shfaqur dyshime rreth rolit të KFOR-it.⁶⁶

Më 26 nëntor 2022, gazeta online në gjuhën shqipe Bota Sot publikoi një artikull në të cilin pretendonte ta ketë zbuluar se Vuçiq po synonte të niste një luftë me NATO-n dhe “tmerrin që Serbia do ta përjetonte nëse nuk e njeh Kosovën”. Lajmi ishte raportuar si i rremë, sipas verifikimit të fakteve nga KALLXO.com. Ai synonte të krijonte panik dhe keqperceptim se Serbia po hynte në luftë me NATO-n.

Një artikull tjetër i publikuar më 26 dhjetor 2022 pretendonte rrejshëm se ShBA reagoi kundër serbëve pas sulmit ndaj gazetarëve në veri të Kosovës.⁶⁷ Kur dy gazetarë u sulmuan në veri, ambasadori i ShBA-ve e dënoi këtë sulm me anë të një postimi në Twitter dhe bëri thirrje për mbrojtjen e gazetarëve nga kërcënimet e sulmit por ai nuk e fajësoi dikë për sulmin dhe nuk përmendi përkatësi etnike të dikujt.

Gjatë dhjetorit 2022 vendi pati dezinformata të reja por studimi zbuloi se gjatë kësaj kohe janë ricikluar, ripublikuar dhe rishpërndarë edhe forma të vjetra të dezinformimit. Lajmi rreth kërcënimit të ShBA-ve ndaj Serbisë në përgjigje ndaj kërcënimit ndaj territorit të Kosovës, i cili së pari ishte publikuar në shkurt 2022, u rishfaq në Facebook duke u publikuar nga 49 faqe, dhe gjeneroi 1,338 ndërveprime në Facebook.⁶⁸

Një narrativë tjetër e rreme që ishte identifikuar gjatë tensioneve në veri të Kosovës ishte informata se Shqipëria, një shtet anëtar i NATO-s, do të dërgonte 500 zyrtarë policorë në Kosovë.⁶⁹ Kjo ishte theksuar në një storje që thoshte se ushtarët shqiptarë ishin parë duke patrulluar në veri të Kosovës. Më shumë se 30 ushtarë nga Shqipëria janë të angazhuar në misionin e KFOR-it dhe KFOR i informoi qytetarët se këto ishin patrullime standarde të NATO-s.⁷⁰

Dezinformimi ishte prodhuar edhe në platforma tjera, sidomos rreth zgjedhjeve në Mitrovicën e Veriut.⁷¹ Platforma jonë e verifikimit të fakteve, Krypometri, gjeti se një portal publikoi një artikull të titulluar “Zëvendës Komandanti i NATO-s “tmerron” Serbinë: Nëse kërcënohet stabiliteti në Kosovë, KFOR është i gatshëm të intervenojë”. Një artikull tjetër

⁶⁶ “Kfor tela me gjëmba në Jarinjë, në Leshkë pyesin për tubimin e sotëm”, Kosovo Online, 18 dhjetor 2022, <https://www.kosovo-online.com/sq/lajm/politike/kfor-tela-me-gjëmba-ne-jarinje-ne-leshke-pyesin-tubimin-e-sotem-18-12-2022>

⁶⁷ “Rrena se reagimi i SHBA se ishte kundër Serbëve”, Kallxo (Krypometer), 28 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-reagimi-i-shba-se-ishte-kunder-serbeve/>

⁶⁸ Lexo.Sot, Facebook. <https://www.facebook.com/lexo.sot/posts/pfbid028T6zwpUKDQTW8iz7hFnU1p5UpTdgdnYE63LjpDogHTPvdj-tiavc5bWGBX7GzLrl>

⁶⁹ “Rrena se Shqipëria do të dërgojë 500 policë në Kosovë”, Kallxo (Krypometer), 21 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-shqiperia-do-ti-dergoje-500-police-ne-kosove>

⁷⁰ “KFOR-i sqaron pse ushtarët shqiptarë shkuan në veri të Mitrovicës”, Telegrafi, 4 prill 2019, <https://telegrafi.com/kfor-gjendja-ne-veri-nen-kontroll-nuk-ka-deshmi-per-trazira/>

⁷¹ “Titulli i Rremë se në Beograd është Ngritur Alarm për Zgjedhjet në Mitrovicë të Veriut,” Kallxo, 17 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-se-ne-beograd-eshte-ngritur-alarm-per-zgjedhjet-ne-mitrovice-te-veriut>

me përmbajtje të rreme⁷² ishte publikuar në todaynews80.com, i titulluar: Një deklaratë e komandantit të KFOR! Nuk do ta braktisim Kosovën derisa Serbia ta njohë pavarësinë e saj!⁷³ Ky tekst ishte ripublikuar 15 herë në portale dhe rrjete sociale. Një artikull tjetër në mënyrë të rrjeshme⁷⁴ thoshte: “ShBA dhe NATO tmerrojnë Vuçiqin! “Serbia nënshkruan kapitullimin”.⁷⁵

Në mënyrë simultane, kanë qarkulluar edhe narrativa propaganduese që rrejshëm e fajësojnë BE-në për situatën në veri të Kosovës. Maria Zakharova, zëdhënëse e Ministrisë së Jashtme të Rusisë, tha në dhjetor se situata “është në prag të luftës” për shkak të veprimeve të Kosovës dhe “mosveprimeve të BE-së”.⁷⁶ Zakharova gjithashtu e krahasoi Kosovën me Osetinë Jugore. Në Telegram, Zakharova shkroi: “Ne tashmë kemi vërejtur diçka të ngjashme me vitin 2008 kur Mishko Saakashvili, i frymëzuar nga vendimet e samitit të NATO-s në Bukuresht (se Gjeorgjia do t’i bashkohej Aleancës), u çmend dhe filloi ta bombardojë Osetinë e Jugut, qytetarët rusë dhe paqeruajtësit.

Një mekanizëm i dëshmuar i mosndëshkimit të frymëzuar. Rreziku i eskalimit dhe konfrontimi i armatosur në pjesën veriore të territorit është në rritje. Prandaj, në vend të perspektivës evropiane, duket se do të jetë krejt ndryshe.”⁷⁷ Kjo deklaratë ishte publikuar të paktën në tri media në gjuhën shqipe pa ndonjë kontekst apo balancim pikëpamjesh.⁷⁸

Serbët organizuan një protestë në afërsi të pikës kufitare të Jarinjës, në pjesën serbe të kufirit, më 15 dhjetor 2022. Të dhënat tregojnë se Russia Today⁷⁹ raportoi për protestën dhe se kishte arrestime të protestuesve që tentuan të hynin në Kosovë.⁸⁰ Qeveria e Kosovës pretendoi se ka pasur një plan rus në mes të dhjetorit për ta djegur pikën kufitare në Jarinjë.⁸¹

Disa ditë para protestës, KFOR rriti praninë e vet në Jarinjë për shkak të shqetësimeve të tyre se kishte grupe të rrezikshme kriminale në mesin e protestuesve.⁸² Tensionet në atë zonë mbetën të larta. Kryeministri Albin Kurti po i bënte presion KFOR-it që t’i largonte barrikatadat

⁷² “Një Tjetër Titull i Rremë për Deklaratat e Shefit të NATO-s në Serbi më 2018”, Kallxo, 29 korrik 2022, <https://kallxo.com/krypometer/nje-tjeter-titull-i-rreme-per-deklaratat-e-shefit-te-nato-s-ne-serbi-me-2018>

⁷³ “Komandanti i KFOR-it me Deklaratë: Kosovën nuk do ta Lëshojmë deri sa Serbia të pranojë Pavarësinë”, Lajme.icu, <https://lajme.icu/komandanti-i-kfor-it-me-deklarate-kosoven-nuk-do-ta-ieshojme-deri-sa-serbia-te-pranoj-pavaresine-3>

⁷⁴ “Titulli i Rremë se SHBA e NATO tmerrojnë Vuçiqin dhe se Serbia Nënshkruan Kapitullimin”, Kallxo, 13 tetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-se-shba-e-nato-tmerrojne-vuciqin-dhe-se-serbia-nenshkruan-kapitullimin>

⁷⁵ Post Lajmee, Facebook post, 8 tetor 2022, <https://www.facebook.com/100064549185694/posts/471726831655619>

⁷⁶ “Situata në veri të Kosovës, Rusia e fajëson BE-në”, Zeri, 12 dhjetor 2022, <https://zeri.info/aktuale/473856/situata-ne-veri-te-kosoves-rusia-e-fajeson-be-ne/>

⁷⁷ “Tensionet në veri të Kosovës, Rusia fajëson Tiranën”, Sot.com.al, 18 dhjetor 2022, <https://sot.com.al/bota/tensionet-ne-veri-te-kosoves-rusia-fajeson-tiranen-i556829>

⁷⁸ ‘Data from CrowdTangle’, accessed at <https://apps.crowdtangle.com/auth?view=3>


⁷⁹ “Zhvillimet në Jarinjë”, Kallxo, 18 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/lajm/zhvillimet-ne-jarinje>

⁸⁰ Kallxo.com, Facebook video, December 18, 2022, <https://www.facebook.com/watch/?ref=external&v=1609655969498356>

⁸¹ “Besnik Bislimi: Plani ishte të digjej pika kufitare e Jarinjës”, Kallxo, 19 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/lajm/besnik-bislimi-plani-ishte-te-digjej-pika-kufitare-e-jarinjes>

⁸² “KFOR-i shton prezencën me trupa në veri të Kosovës”, Deutsche Welle, 19 dhjetor 2022, <https://www.dw.com/sq/kfor-i-shton-prezenc%C3%ABn-me-trupa-n%C3%AB-veri-t%C3%AB-kosov%C3%ABs/a-64145284>

Figura 7: Ndikimi i narrativave luftënxitëse dhe të rrejshme në komunitet bazuar në të dhënat e mbledhura nga hulumtimi Omnibus



duke paralajmëruar se nëse KFOR nuk e bën këtë, atëherë institucionet e Kosovës do t'i largojnë vetë, duke rrezikuar konfrontimin.

1.3 Narrativat se NATO dhe perëndimi po mbështesin serbët⁸³

Kur misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, refuzoi ta transportojë të arrestuarin Dejan Pantiq me anë të helikopterit, mediat në gjuhën shqipe krijuan një narrativë të re e cila synonte të krijonte përçarje ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe NATO-s.

Dimal Basha, një deputet në Kuvendin e Kosovës nga partia në pushtet Vetëvendosje, shkroi në Facebook se: “Pas 15 ditëve, KFOR tha se dialogu me bandat e Radoiçiqit është i nevojshëm⁸⁴ për t'i larguar barrikatat.” Duke marrë parasysh se Radoiçiq është një politikan serb i vendosur në listën e zezë të ShBA-ve për shkak të veprimtarisë kriminale, kjo sugjeronte që KFOR po negocionte me kriminelët. Ky mesazh ishte ripublikuar në 11 artikuj dhe mblodhi 659 reagime. Në realitet, KFOR asnjëherë nuk tha se duhet të negociohet me Radoiçiqin. Misioni pati thënë se largimi i barrikadave duhet të organizohet “përmes dialogut”, duke mos specifikuar me kë.⁸⁵

⁸³ “KFOR-I t'i mbrojtë serbët” (Kfor da zaštiti Srbe), FoNet, 20 dhjetor 2022, <https://fonet.rs/politika/36240983/kfor-da-zastiti-srbe.html>

⁸⁴ Milan Radoicic është politikan nga veriu i Kosovës që gjendet në listen e zezë të ShBA-ve, <https://balkaninsight.com/2021/12/09/kosovo-serbs-close-to-serbias-rulers-join-us-blacklist/>

⁸⁵ “Komandanti i KFOR për gjendjen në veri: Të shmangët shfaqja provokuese e forcës, zgjidhja përmes dialogut”, Telegrafi, 23 dhjetor 2022, <https://telegrafi.com/komandanti-kfor-per-gjendjen-ne-veri-te-shmanget-shfaqja-provokuese-e-forces-zgjidhja-permes-dialogut/>

Ka pasur gjithashtu denoncime publike⁸⁶ dhe akuza se KFOR nuk e ka ndihmuar qeverinë e Kosovës për t'i larguar barrikatat. Artan Abrashi, një tjetër deputet i Vetëvendosjes, postoi në Facebook për KFOR-in duke shkruar: “U bënë 11 ditë që disa rrugë në veri të Kosovës janë bllokuar nga barrikatat, KFOR nuk është përgjigjur ende... ShBA dhe BE kanë kërkuar heqjen e barrikadave”.⁸⁷ Postimi mori 201 reagime. Por informata nuk ishte e plotë sepse dy ditë më parë, KFOR⁸⁸ ndërmori një operacion për të ofruar siguri në pikën e kalimit kufitar në Jarinjë dhe e rriti praninë ushtarake në atë zonë. BE dhe ShBA gjithashtu kërkuan heqjen e barrikadave përmes dialogut.

Narrativa se KFOR donte të takohet me grupe kriminale në veri dhe nuk po bashkëpunonte me institucionet e Kosovës ishte përcjellë me kërkesën se Kosova nuk duhet të vazhdojë të jetë e varur nga KFOR-i. Në janar 2023, pak javë pasi tensionet në veri u zbutën, deputeti Dimal Basha deklaroi se Kosova duhet ta blejë një helikopter dhe t'i japë fund varësisë nga KFOR.⁸⁹ Kjo deklaratë ishte publikuar në 13 media dhe mori 307 ndërveprime.⁹⁰

Hapësira ajrore e Kosovës është e kontrolluar nga KFOR-i, përfshirë edhe lejet për përdorimin e dronëve, pavarësisht kërkesave të përsëritura që këto kompetenca të barten tek autoritetet e Kosovës. Janë bërë edhe iniciativa për grumbullimin e fondeve që institucionet e Kosovës ta blejnë një helikopter.

Një narrativë tjetër anti-KFOR dhe anti-NATO pretendonte se anëtarësimi i Serbisë në NATO do të kishte pasoja për Kosovën. Një artikull i titulluar “Në pritje të KFOR-it, vjen paralajmërimi: Në rast se ndodh kjo gjë, Kosova hyn në luftë me ushtarët serbë!” thoshte se nëse Serbia i bashkohet NATO-s, ajo do të mund të dërgojë ushtarë në misionin e KFOR-it, gjë e cila do të shënonte fillimin e një lufte mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës.⁹¹ Kjo narrativë portretizon anëtarësimin eventual të Serbisë në NATO si rrezik për Kosovën.

⁸⁶ Artan Abrashi (abrashi.a), Facebook Post, 20 dhjetor 2022, <https://www.facebook.com/abrashi.a/posts/pfbid0No9ZrjhNr8E-JGaLKSMzyvmtwjqJt2gXzGRPu7vF0oa5VEa8ba7HEsYUptYERBRkl>

⁸⁷ Ibid.

⁸⁸ “KFOR-i kishte informacione për grupe kriminale brenda protestuesve në Jarinjë”, Kallxo, 18 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/lajm/kfor-i-kishte-informacione-per-grupe-kriminale-brenda-protestuesve-ne-jarinje/>

⁸⁹ “A dështoi shteti ta çojë Pantiqin në paraburgim, Basha: Po përforcohem, duhet të kemi një helikopter”, Gazeta Express, 12 janar 2023, <https://www.gazetaexpress.com/a-deshtoi-shteti-ta-coje-pantiqin-ne-paraburgim-basha-po-perforcohem-duhet-te-kemi-nje-helikopter/>

⁹⁰ Facebook Post, Veriu.info, January 13, 2023, <https://www.facebook.com/327128460749009/posts/5826263787502088>


⁹¹ “Në pritje të KFOR-it, vjen paralajmërimi: Në rast se ndodh kjo gjë, Kosova hyn në luftë me ushtarët serbë”, Bota Sot, 5 janar 2023, <https://www.botasot.info/politika-lajme/1928010/ne-pritje-te-kfor-it-vjen-paralajmerimi-ne-rast-se-ndodh-kjo-gje-kosova-hyn-ne-lufte-me-ushtaret-serbe/>

Figura 8: Ndikimi i narrativave anti-NATO në komunitet, sipas të dhënave të mbledhura nga hulumtimi Omnibus

Ndikimi i narrativave rreth pushtimit rus të Ukrainës në komunitet

Të dhënat nga sondazhet e opinionit (Omnibus) në maj tregojnë se dezinformimi nga kjo kohë kishte një ndikim në publik.

1,056 të anketuar nga etnitë shqiptare dhe serbe u pyetën nëse “Rusia ka vënë arsenalin e saj bërthamor në gatishmëri.”



Lajmi se Rusia vendosi armët e saj bërthamore në gatishmëri u përhap në fillim të vitit 2022. Megjithëse u publikuan informacione që tregonin se kjo është e pavërtetë, njerëzit vazhduan të besonin historinë fillestare.

1.4 Narrativa dezinformuese për kriminalizimin e NATO-s

Narrativat dezinformuese ruse përfshijnë edhe akuzat se perëndimi po i jep armë Ukrainës për t'u përdorur në vrasje të civilëve dhe të cilat do të shkaktojnë vdekje nga kanceri në të ardhmen. Për ta mbështetur këtë narrativë, mediat e kontrolluara nga Rusia kanë shpërndarë dezinformatat për vdekje masive të qytetarëve të Serbisë pas luftës në ish-Jugosllavi për shkak të bombardimeve të NATO-s dhe përdorimit të uraniumit të varfëruar.⁹² Për shembull, një imazh i një vajze të vogël pranë nënës së saj të vdekur nga filmi “Fortress of War”⁹³ është shpërndarë në disa postime në Facebook dhe Twitter.

Këto postime në mënyrë të rrejshme raportojnë se fotografia ishte marrë gjatë bombardimeve të NATO-s në ish-Jugosllavi.⁹⁴ Për më tepër, Misioni i Rusisë⁹⁵ në OSBE rrejshëm e paraqiti një fotografi të marrë nga lufta në Irak e vitit 2003⁹⁶ si të marrë gjatë bombardimeve të NATO-s në ish-Jugosllavi në vitin 1999. Ish-Ministri i jashtëm i Serbisë Vuk Jeremic⁹⁷ gjithashtu e përdori këtë fotografi të njejtë nga 2003 në një tweet të tij për t'i përkujtuar bombardimet e NATO-s me 24 mars, 2023, duke sugjeruar që foto tregon bombardimet e NATO-s në Beograd.⁹⁸

Në një tweet të mëvonshëm, ai e pranoi gabimin por nuk e largoi postimin e mëhershëm i cili mori 240 shpërndarje. Për më tepër, në Serbi, shumë politikanë dhe influencues në rrjete sociale dhe gjatë debateve publike thanë se Serbia ishte viktimë e bombardimeve të NATO-s, pa e pranuar se bombardimet ishin nxitur nga dhuna e Serbisë kundër shqiptarëve të Kosovës. Një shembull i tillë është Novak Gjkoviç, një tenist i famshëm serb, i cili tha se e gjeti fuqinë brenda vetes “për ta falur” perëndimin për atë që, sipas tij, “padrejtësisht u ka bërë serbëve”.⁹⁹

Për më tepër, mediat ruse publikuan informacione të rrejshme për vdekjen e mijëra civilëve si rezultat i sulmeve të NATO-s në Serbi (lajmi se 2500, 1500 njerëz janë vrarë).¹⁰⁰

⁹² Facebook Post, Sputnik, March 23, 2023, <https://www.facebook.com/357990416180/posts/10160483043451181>

⁹³ IMDb Media Viewer, Fortress of War, 2010, <https://www.imdb.com/title/tt1343703/mediaviewer/rm1845916672/>

⁹⁴ Facebook Post, Српски Ослободилачки Покрет Отаџбина, March 24, 2022, <https://www.facebook.com/srpskioslobodilackipokret/photos/a.1647517155461210/3122964021249842/>

⁹⁵ Tweet nga Misioni Permanent i Federatës Ruse në OSBE (@RF_OSCE), 24 mars 2022, https://twitter.com/RF_OSCE/status/1507085114676756487

⁹⁶ “Bombardimet e NATO-s në ish-Jugosllavi ilustrohen me fotografi të rreme nga misionit rus i OSBE-së”, Kallxo, 30 mars 2022, <https://kallxo.com/krypometer/bombardimet-e-nato-s-ne-ish-jugosllavi-ilustrohen-me-fotografi-te-rreme-nga-misionit-rus-i-osbe-se/>

⁹⁷ Tweet nga Vuk Jeremić (@jeremic_vuk), 24 mars 2023, https://twitter.com/jeremic_vuk/status/1639195915230785536

⁹⁸ Ibid.

⁹⁹ Narrativa e Novak Gjkoviçit si viktimë e bombardimeve të NATO-s është amplifikuar në profiling KanekoatheGreat me afme afër gjysmë milion ndjekës më 6 maj 2023, <https://twitter.com/KanekoatheGreat/status/1654671932338630657> në një intervistë që u bë në gusht 2022

¹⁰⁰ “Si e bombarduan forcat e NATO-s Jugosllavinë” (Как силы НАТО бомбили Югославию) Sputnik Armenia, 31 tetor 2019, <https://web.archive.org/web/20191112094734/https://ru.armeniasputnik.am/video/20191031/20945059/kak-sily-nato-bombili-yugoslaviyu.html>; “Bombardimet ndaj Jugosllavisë vranë ndërmjet 1200 dhe 2500 civilë,” EU vs Disinfo, October 31, 2019, <https://euvsdisinfo.eu/report/bombings-of-yugoslavia-killed-between-1200-and-2500-civilians>

Ndërkohë, mediat në gjuhën shqipe publikuan artikuj me përmbajtje të rreme¹⁰¹ që pretendonin se NATO dhe ShBA janë duke e kërcënuar Serbinë me luftë dhe se Serbia pritet të kapitulojë sërisht.¹⁰² I njëjti postim është shpërndarë në gjashtë faqe në Facebook dhe mori 74 ndërveprime. Nuk ka pasur kërcënime të tilla nga ShBA apo NATO. Kjo është një narrativë e rrejshme që vjen nga Rusia,¹⁰³ e publikuar fillimisht në mediat ruse.¹⁰⁴¹⁰⁵

Figura 9: Ndikimi i narrativave anti-NATO në komunitet, sipas të dhënave të mbledhura nga hulumtimi Omnibus

Ndikimi në komunitet i narrativave kundër NATO-s

Të dhënat nga hulumtimi i opinionit (Omnibus) të zhvilluar në maj tregojnë se dezinformimi gjatë kësaj periudhe ka pasur një ndikim te qytetarët.

1,056 respondentë nga komuniteti shqiptar dhe ai serb u pyetën nëse “ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 ishte akt agresioni”.



Ndërhyrja e NATO-s e vitit 1999 ishte ndërhyrje ushtarake humanitare

¹⁰¹ “Titulli i rremë se SHBA e NATO ‘tmerrojnë’ Vuçiqin dhe se Serbia nënshkruan ‘kapitullimin’”, Kallxo, 13 tetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-se-shba-e-nato-tmerrojne-vuciqin-dhe-se-serbia-nenshkruan-kapitullimin/>

¹⁰² Facebook Post, Post Lajmee, 8 tetor 2022, <https://www.facebook.com/100064549185694/posts/471726831655619>

¹⁰³ “US trying to provoke Serbia into a military operation,” EU vs Disinfo, December 14, 2022, <https://euvsdisinfo.eu/report/us-trying-to-provoke-serbia-into-a-military-operation>

¹⁰⁴ Ibid

¹⁰⁵ “Capture Snapshot,” Capture, <https://app.capture.cc/snapshots/1ed7ba93-0763-6e2a-9812-06a13b0e4978>

1.5 Narrativat dezinformuese se perëndimi dhe NATO po përgatisin shqiptarët për luftë kundër serbëve

Raporti i “EuVsDisinfo”¹⁰⁶ përmbledhi narrativat dezinformuese që e fajësojnë NATO-n për zhvillimet në Kosovë dhe për mbështetje të Kosovës kundër Serbisë. Dezinformimi rus e paraqet NATO-n si armike të serbëve dhe i portretizon synimet e Aleancës si anti-serbe. Këto pretendime janë publikuar edhe në mediat në gjuhën shqipe, përfshirë një artikull që pretendon se NATO do ta sulmojë sërish Serbinë.¹⁰⁷ pa ofruar asnjë fakt të vetëm. Postimi i njëjtë ishte shpërndarë në katër faqe të Facebook-ut dhe mori ¹⁰⁶ ndërveprime.

Narrativa e parë e identifikuar është se shqiptarët janë duke ndërtuar bazë ushtarake në Mitrovicë të veriut për ta mbrojtur veten ose për t'i sulmuar serbët. Autoritetet e Kosovës kanë nisur t'i forcojnë pikat kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak si dhe për të ndërtuar një bazë kontraverse policore në fshatin Dren të Leposaviqit. Në këtë mënyrë, storjet për ‘okupim’ të ri, ‘pushtim’ të veriut nuk ishin vetëm narrativa të ndikuara nga rusët por edhe lokale.

Në nëntor, Russia Today publikoi një artikull që pretendonte se ishte në proces ndërtimi i një baze ushtarake “shqiptare” në Mitrovicë të Veriut.¹⁰⁸ Artikulli i paraqiste stacionet policore si baza ushtarake dhe pretendonte se shtetet si Gjermania dhe ShBA-të kishin premtuar të ndihmonin ndërtimin e një baze ushtarake në Cërnushë, në afërsi të Mitrovicës. Kjo storje nuk kishte bazë faktike. Narrativa më pas u përdor nga serbët e Kosovës për të pretenduar se shqiptarët e Kosovës po përpiqeshin ta pushtojnë veriun me ndihmën e NATO-s dhe BE-së. Në fakt, ata po provonin të ndërtonin disa baza shtesë të policisë në veri për t'i adresuar rrugët e kontrabandës, por kjo gjë u bë pa ndihmën e NATO-s dhe BE-së.

Një akuzë tjetër e shpeshtë është që NATO po e armatos Forcën e Sigurisë së Kosovës. Media të shumta në Kosovë, përfshirë portale të dyshimta online, publikuan thashetheme dhe të pavërteta rreth FSK-së. Një portal, emri i të cilit fillon me “BBC” dhe vazhdon me “NEWSCOM”, në mënyrë që qëllimshëm ta konfuzojë publikun kinse është i lidhur me BBC-në, raportoi se “një bazë e madhe ushtarake e FSK-së do të ndërtohet afër Serbisë, e pajisur me raketa kundër-ajrore”.¹⁰⁹ Informacioni i njëjtë ishte ripublikuar në tri uebsajte dhe 80 herë në 15 faqe të Facebook të cilat morën gjithsejt 1.2 milion pëlqime. Ky artikull fillimisht ishte publikuar në maj 2022 dhe së fundmi u shpërnda në janar 2023.


¹⁰⁶ “There is proof of a formation of a pact against Serbia,” EU vs Disinfo, September 13, 2019, <https://euvsdisinfo.eu/report/there-is-proof-of-a-formation-of-a-pact-against-serbia>

¹⁰⁷ ShqipPress, Facebook Post, February 3, 2023, <https://www.facebook.com/shqippressofficial/posts/pfbid0k46kPvbfh1ivVz7fmQ4vifc-Q6Db8SyNkL6MXZQ1FxCvekd7gJJUXpWKv2v7eDc6xl>

¹⁰⁸ “Bazat e reja të shqiptarëve në veri të Kosovës dhe Metohisë: Shtërëngohet unaza e çeliktë rreth serbëve” (Нове базе Албанаца на северу КуМ: Стеже се челични прстен око Срба), Russia Today Serbia, 12 nëntor 2022, <https://rt.rs/news/5458-jarinje-brnjak-policijske-baze/>

¹⁰⁹ “Tmerr për Serbinë, Bondsteel i shqiptarëve afër Serbisë, pajiset me sisteme kundërajrore”, BBC News M, <https://bbcnews.com/tmerr-per-serbine-bondsteel-i-shqiptare-afër-serbisë-pajiset-me-sisteme-kunderajrore/>

Figura 10: Shpërndarja e dezinformatave se perëndimi po e përgatit Kosovën për luftë kundër serbëve



Narrativat e rreme janë promovuar edhe në lidhje me donacionet që Kosova ka pranuar nga SHBA-të¹¹⁰ për FSK-në. Një donacion ishte dhënë në gusht të vitit 2021,¹¹¹ por informacioni për këtë donacion ishte ripublikuar 385 herë ndërmjet viteve 2021 dhe 2023.¹¹² Edhe pse ishte dhënë vetëm një donacion, ai gjithmonë ishte paraqitur si donacion i ri. Njëjtë, media publikoi një artikull që pretendon se "Kosova blen 40 avionë / SHBA pajis FSK me dronë vëzhgimi e filmimi".¹¹³

¹¹⁰ Lajme Reale, Facebook Post, January 30, 2023, <https://www.facebook.com/108857771041571/posts/641769774417032>

¹¹¹ "Kurti: SHBA-ja luan rol të rëndësishëm në rrugën e rritjes dhe zhvillimit të Ushtrisë tone", Telegrafi, 31 gusht 2021, <https://telegrafi.com/kurti-shba-ja-luan-rol-te-rendesishem-ne-rrugen-e-rritjes-dhe-zhvillimit-te-ushtrise-tone/>

¹¹² Data from Crowdtangle, accessed at: <https://apps.crowdtangle.com/search?customStartDate=2021-08-03T12:48:00&customEndDate=2023-05-05T12:48:45&platform=facebook&postTypes=&producerTypes=3&q=Dridh%20FSK%20SHBA&sortBy=date&sortOrder=-desc&timeframe=custom>

¹¹³ "Top News: Kosova blen 40 avione, SHBA pajis FSK me drone, vëzhgimi e filmimi", Top Channel, 25 janar 2022, <https://top-channel.tv/video/top-news-kosova-blen-40-avione-shba-pajis-fsk-me-drone-vezhgimi-e-filmimi/>

Përveç kësaj, një deklaratë e fabrikuar¹¹⁴ nga ish-gjenerali amerikan në NATO Wesley Clark¹¹⁵ mori vëmendje në Beograd. Ky artikull ishte shpërndarë 79 herë në rrjete sociale duke marrë 796 ndërveprime.

Një lajm tjetër i titulluar “Vuçiq nuk do ta pëlqejë këtë, SHBA është e vendosur: nëse Serbia kërcënon territorin e Kosovës, ju duhet ta dini këtë...” ishte publikuar 35 herë në rrjete sociale dhe ka marrë 1,210 ndërveprime.¹¹⁶ Këtij lajmi i mungonte konteksti në raportim. Një narrativë e ngjashme, e cila synonte ta portretizonte perëndimin të jetë kundër Serbisë, është vërejtur në një artikull me titull: “LAJMI MADHESHTOR/ Kosova merr lajmin e HISTORIK: “Serbia s’ka qenë asnjëherë aleate e SHBA-së”.¹¹⁷ Ai është publikuar 62 herë në rrjete sociale dhe ka marrë 3,272 ndërveprime.

Përveç dezinformimit rreth FSK-së dhe sentimentit anti-Serbi ndër ShBA-të, ka pasur edhe dezinformim të shpërndarë se ushtria e Kosovës do të hyjë në veri. Ky informacion është publikuar kryesisht në kohë krizash në veri ose para takimeve në kuadër të dialogut mes Kosovës dhe Serbisë.

Portali i Serbisë “Novosti.rs” raportoi rrejtshëm se FSK ka hyrë në Zubin Potok. Dezinformata gjithashtu u publikua nga së paku pesë media tjera, disa nga të cilat janë nga Kosova. Megjithatë, informacioni ishte i rrejtshëm.¹¹⁸

Informacioni që e lidh FSK-në me tensionet në veri ishte publikuar në korrik 2022, gjatë kontestit rreth tabelave të veturave. Dy uebsajte dhe gjashtë faqe në Facebook postuan se “Ushtria do ta marrë kontrollin e veriut para 25 gushtit”. Informacioni nuk ishte i bazuar në burim zyrtar dhe u gjet të jetë i rremë.¹¹⁹

¹¹⁴ Artistet Shqiptar Facebook page. July 25th 2022. https://www.facebook.com/ArtistetShqiptar/posts/3295342284080220/?paipv=0&ea_v=AfbF58IEod8uSkYjiGSydyKCd7JJQyNQEqLkH76VtGGmGikv2tliik0hFl544McUeE

¹¹⁵ “Rrena se deklarata e gjeneralit Clark ka shkaktuar tërmet në Beograd”, Kallxo, 7 janar 2023, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-deklarata-e-gjeneralit-clark-ka-shkaktuar-termet-ne-beograd/>

¹¹⁶ “Rrena rreth një deklarimi të profesorit amerikan”, Kallxo, 21 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-rreth-nje-deklarimi-te-profesorit-amerikan/>

¹¹⁷ “Gazeta Parlamenti” Facebook, 16 shkurt 2022, <https://www.facebook.com/110733877932940/posts/235630658776594>

¹¹⁸ “Rrena për hyrjen e ushtarëve të Kosovës në komunën e Zubin Potokut”, Kallxo, 9 shtator 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-hyrjen-e-ushtarëve-te-kosoves-ne-komunen-e-zubin-potokut/>

¹¹⁹ “Dezinformata se Ushtria do ta marrë veriun para datës 25 Gusht”, Kallxo, 3 gusht 2022, <https://kallxo.com/krypometer/dezinformata-se-ushtria-do-ta-marre-veriun-para-dates-25-gusht/>


Figura 11: Ilustrimi i artikujve të përzgjedhur me dezinformimin se Kosova po përgatitet për luftë

| | | |
|--|-------------------------|-------------------------|
| Katastrofë për Serbinë: Bondstilli shqiptar afër Serbisë i pajisur me sistem të raketave kundërajrore | Publikime 142 | Reagime 1,128 |
| Një bazë ushtarake e FSK-së do të ndërtohet afër Serbisë, e pajisur me raketa kundërajrore | Publikime 174 | Reagime 245 |
| Albin Kurti 'dridh' Ballkanin me fjalimin e tij për donacionin amerikan për FSK-në | Publikime 8 | Reagime 162 |
| Mbarë bota po flet për këtë: Albin Kurti dërgon Ushtrinë e Kosovës në Ishujt Falkland | Publikime 6 | Reagime nn |
| Kurti nuk tërhiqet: Pas ROSU, ushtria hyn në veri | Publikime 10 | Reagime 54 |
| Kaq shumë investime në Ushtrinë e Kosovës këtë vit: Në tri vitet e ardhshme, autoritetet tona do të blejnë armë në vlerë 300 milionë euro për ushtrinë | Publikime 87 | Reagime 275 |
| Rinia jonë po largohet, por po kërkohen para. Kush do t'i përdorë ato? | Publikime 7 | Reagime 1,093 |
| Kosova blen 40 aeroplanë/ SHBA pajis FSK-në me dronë vëzhgues dhe filmues | Publikime 2 | Reagime 4 |
| Armatosja e FSK-së po e çmend Serbinë | Publikime 28 | Reagime 1,557 |
| Vuçiq pyet britanikët: Pse po e armatosni Kosovën? | Publikime 101 | Reagime 2,791 |
| Çka janë 'Javelin' dhe 'NLAW', armët të cilat Serbia frikësohet se Britania ia dhuroi Kosovës | Publikime 2 | Reagime 74 |
| Turqia armatos Kosovën | Publikime 2 | Reagime 837 |

1.6 Narrativat dhe dezinformimi rreth dialogut Kosovë-Serbi dhe narrativat kundër diplomatëve të BE-së dhe ShBA-ve

Bashkimi Evropian është donatori më i madh¹²⁰ në Kosovë dhe mbi 91% e qytetarëve kanë shprehur mbështetjen për integrimin e Kosovës në BE.¹²¹ Megjithatë, ende qarkullojnë sentimente lokale kundër BE-së të cilat shfrytëzohen dhe përforcohen nga narrativat dezinformuese ruse. Këto narrativa e portretizojnë BE-në si diskriminuese në raport me Kosovën sepse:

Figura 12: Narrativat dhe dezinformimi rreth dialogut Kosovë- Serbi dhe narrativat kundër diplomatëve të BE-së dhe ShBA-ve



1. BE është e krishterë dhe nuk dëshiron një vend me shumicë muslimane si Kosova në mesin e saj.
2. Pesë shtete anëtare nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës (Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia, dhe Spanja) dhe si të tilla janë në anën e Serbisë..
3. Disa emisarë të BE-së janë në anën e Serbisë sepse vijnë nga shtetet që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

¹²⁰ “EU and Kosovo,” European External Action Service (EEAS), https://www.eeas.europa.eu/kosovo/eu-and-kosovo_en?s=321.

¹²¹ International Republican Institute. (2021). Public Opinion Survey: Residents of Kosovo (September 3-18, 2021) (p. 53). Center for Insights in Survey Research.

Rreth rolit të BE-së në Ballkan, EUvsDisinfo ka identifikuar disa dezinformata që portretizojnë BE-në kinse po tenton t'i kontrollojë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe tregjet e tyre.¹²² Dezinformimi rus e portretizon negativisht ndikimin e BE-së në Ballkan, e konteston unitetin e BE-së dhe e ekzagjeron varësinë e BE-së në politikat amerikane.¹²³ Për më tepër, mediat ruse pretendojnë se qytetarëve të Ballkanit Perëndimor u mungon entuziazmi për integrim në BE.¹²⁴ Megjithatë, përveç Serbisë, qytetarët në vendet e Ballkanit i besojnë më shumë BE-së se sa qeverive të tyre.¹²⁵

Lajmet rreth liberalizimit të vizave kanë qenë të mbushura me deklarata të rreme nga politikanët.¹²⁶ Gjatë pesë viteve të kaluara, 25 informacione të ndryshme të rrejshme¹²⁷ në mënyrë të gabuar thonin se liberalizimi i vizave për Kosovën do të ndodhë së shpejti¹²⁸ ose brenda një periudhe të caktuar¹²⁹ (Lajmi 1, 2, 4).¹³⁰ Përveç kësaj, mediat publikuan informacione se Franca dhe Holanda po e bllokujnë liberalizimin e vizave ose po paraqesin kushte shtesë¹³¹ ndaj Kosovës. Edhe pse kryeministri i atëhershëm i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se Franca nuk do ta pengojë liberalizimin e vizave ose nuk do të paraqesë kushte tjera,¹³² dezinformata megjithatë u shpërnda.

Lajmet e portretizuan Francën si shtet anti-musliman¹³³ dhe pretenduan se liberalizimi i vizave po bllokohet për shkak se shumica e qytetarëve të Kosovës janë muslimanë.¹³⁴

¹²² "The EU wants to expand its imperialism in the Balkans," EUvsDisinfo, October 11, 2021, <https://euvsdisinfo.eu/report/the-eu-wants-to-expand-its-imperialism-in-the-balkans>

¹²³ "The European Union is obliged to participate in US wars," EUvsDisinfo, April 25, 2019, <https://euvsdisinfo.eu/report/the-european-union-is-obliged-to-participate-in-us-wars>

¹²⁴ "Western Balkans countries have a deficit of Euroenthusiasm," EUvsDisinfo, February 9, 2020, <https://euvsdisinfo.eu/report/western-balkans-countries-have-a-deficit-of-euroenthusiasm>

¹²⁵ "Serbia: The only WB country with more trust in the government than in the EU," European Western Balkans, August 6, 2019, <https://europeanwesternbalkans.com/2019/08/06/serbia-the-only-wb-country-with-more-trust-in-the-government-than-in-the-eu/>

¹²⁶ "Liars of the visa liberalisation (Rrencat e liberalizimit të vizave)", Kallxo (Krypometër), July 18, 2019, <https://kallxo.com/krypometer/rrencat-e-liberalizimit-te-vizave/>

¹²⁷ "Vazhdojnë lajmet e rreme për liberalizimin e vizave", Kallxo (Krypometër), 5 shkurt 2022 <https://kallxo.com/krypometer/vazhdojne-lajmet-e-rreme-per-liberalizimin-e-vizave/>

¹²⁸ "Titulli i rremë për heqjen e vizave", Kallxo (Krypometër), 17 shtator 2022, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-per-heqjen-e-vizave/>

¹²⁹ "Titulli i rremë për datën e saktë të liberalizimit të vizave", Kallxo (Krypometër), 9 gusht 2022 <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-per-daten-e-sakte-te-liberalizimit-te-vizave/>

¹³⁰ "Rrena për lajmin e mirë nga BE-ja për liberalizim të vizave", Kallxo (Krypometër), 6 gusht 2022 <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-lajmin-e-mire-nga-be-ja-per-liberalizim-te-vizave/> "Rrena për datën e liberalizimit të vizave", Kallxo (Krypometër), 27 korrik 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-daten-e-liberalizimit-te-vizave/> "Lajmi i rremë për liberalizimin e vizave për Kosovën nga Holanda", Kallxo (Krypometër), 15 tetor 2021 <https://kallxo.com/krypometer/lajmi-i-rreme-per-liberalizimin-e-vizave-per-kosoven-nga-holanda/>


¹³¹ "Titulli i rremë se liberalizimi i vizave është kushtëzuar me finalizim të dialogut", Kallxo (Krypometër), 25 qershor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-se-liberalizimi-i-vizave-eshte-kushtezuar-me-finalizim-te-dialogut/>

¹³² "Tri arsyt pse Franca po e bllokoi Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor", Bota Sot, 8 tetor 2021, <https://www.botasot.info/politika-lajme/1681941/tri-arsyet-pse-franca-po-e-bllokon-kosoven-dhe-ballkanin-perendimor/>

¹³³ "Shikojeni çka i bëjnë kësaj gruaja muslimane me mbulesë në Francë!", pcnmedia2.com, 25 nëntor 2022 <https://pcnmedia2.com/2022/11/25/shikojeni-cka-i-bejne-kesaj-gruaja-muslimane-me-mbulesa-ne-france/s>

¹³⁴ "Nuk ka viza, Kosova është muslimane", Botapress.info, 2 shkurt 2019 <https://www.facebook.com/botapressweb/posts/pfbid02GLE83abR8DLUR8f1Xpsp1BFKmcFmZpV2rUphZEtrZuw7xxzbnquxNb9ARD1h3aX4l>

Figura 13: Ndikimi i narrativave rreth liberalizimit të vizave



Ndërmjet 15 tetorit 2022 dhe 15 marsit 2023 kanë qarkulluar edhe informacione të manipuluar rreth bisedimeve të Kosovës me Serbinë dhe themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Këto informacione nuk janë vlerësuar të gjitha si të rreme, pasi disa prej tyre janë paraqitur si opinione në atë mënyrë që e portretizojnë negativisht BE-në apo përfaqësuesit e saj për dialog pa ofruar fakte për atë konstatim.

Bashkimi Evropian luan rol udhëheqës në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë, e sidomos Përfaqësuesi i Lartë Josep Borrell dhe emisari për dialogun Miroslav Lajcak. Që nga emërimi i tyre ka pasur lajme të cilat kanë hedhur dyshime rreth paanësisë së fasciatorëve¹³⁵ për shkak se Borrell vjen nga Spanja ndërsa Lajcak nga Sllovakia, dy vende që nuk e kanë njohur ende Kosovën. Artikujt që e sulmojnë Borrellin e Lajcakun shpesh janë opinione të shkruara nga ekspertë dhe analistë.¹³⁶

¹³⁵ "Liderët e rinj të BE, Kosovë: Pesimizëm për Josep Borrell", Top Channel, 4 korrik 2019, <https://top-channel.tv/2019/07/04/lideret-e-rinj-te-be-kosove-pesimizem-per-josep-borrell/>

¹³⁶ YouTube Video, "Borrell dhe Lajcak kundër Kosovës! Analistët thonë se Brukseli nuk po e kryen detyrën për dialogun", Euronews Albania, 30 prill 2023, <https://www.youtube.com/watch?v=WSfsf-tsl-E>

Deklaratat e bëra nga Borrell janë interpretuar si kundër Kosovës.¹³⁷ Për shembull, disa media kanë shkruar se “Z. Borrell dëshiron veriun e Kosovës jashtë kontrollit të republikës së pavarur të Kosovës dhe dëshiron që kjo pjesë të shkëputet nga Kosova.¹³⁸ Këta artikuj ishin publikuar si opinione por ato portretizuan negativisht përfaqësuesit e BE-së që janë të angazhuar drejtpërdrejt në dialogun Kosovë-Serbi. Media diskreditoi facilitatorët e BE-së në dialog pasi Kryeministri i Kosovës Albin Kurti¹³⁹ u pa të kishte përplasje me Borrell pas një takimi të tensionuar në Bruksel rreth Asociacionit. Media në Kosovë raportoi se Borrell nuk mund të jetë më tej në krye të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë¹⁴⁰ (31 postime dhe 3,017 ndërveprime),¹⁴¹ por nuk ofruan ndonjë dëshmi. Ky artikull bëri që më shumë politikanë vendorë ta kontestojnë paanësinë¹⁴² e lehtësueve të BE-së.

Edhe paanësia e Miroslav Lajçak ishte kontestuar.¹⁴³ Rezistenca ndaj Lajçakut së pari ishte shprehur nga ish-Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi i cili kundërshtoi emërimin e tij si emisar i BE-së për dialogun Kosovë- Serbi.¹⁴⁴ Opinione të njëjta¹⁴⁵ ishin publikuar sërish kur rifilloi dialogu. Artikuj të tjerë paraqitën një takim standard të Lajçakut me Presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, si një takim sensacional me titullin: “Zbulohet arsyeja pse Lajçak u takua me Vuçiqin.”¹⁴⁶ Artikuj tjerë në mënyrë të rrejshme pretendonin se deklarata e Lajçakut rreth Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe ishte pritur mirë në Kosovë.¹⁴⁷

¹³⁷ “Borel, këmbëngul në shkatërrimin e Kosovës, del hapur në anën e Serbisë”, Drini, 7 dhjetor 2021, <https://drini.us/borel-kembengul-ne-shkaterrimin-e-kosoves-del-hapur-ne-anen-e-serbise/>; Data from CrowdTangle, accessed at: <https://apps.crowdtangle.com/search?customStartDate=2021-01-01T22:59:59&customEndDate=2023-05-01T12:48:00&platform=facebook&postTypes=&producerTypes=3&q=Borel%20k%20C3%ABmb%20C3%ABngul%20n%20C3%AB%20shkat%20C3%ABrrimin%20e%20Kosov%20C3%ABs%20C%20del%20hapur%20n%20C3%AB%20an%20C3%ABn%20e%20Serbis%20C3%AB&sortBy=date&sortOrder=asc&timeframe=custom>

¹³⁸ “BE duhet t’i ndalë Z. Borel dhe Z. Lajçak nga veprimet e njëanshme në raport me Kosovën”, Kosova Sot, 13 tetor 2021, <https://www.kosova-sot.info/opinione/574815/be-duhet-ti-ndali-z-borel-dhe-z-lajcak-nga-veprimet-e-njeanshme-ne-raport-me-kosoven/>

¹³⁹ “Kurti e Borrelli përplasen për Asociacionin”, Koha, 7 dhjetor 2021, <https://www.koha.net/arberi/300252/kurti-e-borrelli-per-plasen-per-asociacionin/>

¹⁴⁰ “Përplasja Kurti-Borrell në Bruksel, ky i fundit mund të mos udhëheq më dialogun Kosovë-Serbi”, Parrotlla, 22 dhjetor 2022, <https://parrotlla.org/perplasja-kurti-borrell-ne-bruksel-ky-i-fundit-mund-te-mos-udheheq-me-dialogun-kosove-serbi/>

¹⁴¹ Data from CrowdTangle, accessed at: <https://apps.crowdtangle.com/search?customStartDate=2022-10-14T12:59:59&customEndDate=2023-05-14T12:12:06&platform=facebook&postTypes=&producerTypes=3,1&q=P%20C3%ABrplasia%20Kurti-Borrell%20n%20C3%AB%20Bruksel%20C%20ky%20i%20fundit%20mund%20t%20C3%AB%20mos%20udh%20C3%ABheq%20me%20dialogun%20Kosov%20C3%AB-Serbi&sortBy=score&sortOrder=desc&timeframe=custom>

¹⁴² “Osmani se zhgënjën Kurtin, për të e goditi edhe kupolën e Bashkimit Europian”, Gazeta Express, 22 nëntor 2022, <https://www.gazetaexpress.com/osmani-se-zhgenjen-kurtin-per-te-e-goditi-edhe-kupolen-e-bashkimit-europian/>

¹⁴³ Shtypi.net, Facebook, 21 nëntor 2020, https://www.facebook.com/shtypi.net/posts/2970781439640221/?paipv=0&eav=AfZk2QJt9f17n-eSti3k7pdIjvAdCtaQi5nyYXv4bXzkODoN0aU57XCdbQp4kaRtjQqQ&_rdr

¹⁴⁴ YouTube Video, “Thaçi kunder Lajçakut si perfaqesues i BE-së”, Lajme-News, RTV KLAN, 26 maj 2020, <https://www.youtube.com/watch?v=aGr9ppqIqN0>

¹⁴⁵ “Dastid Pallaska: E pabesueshme, njëanshmëria e Miroslav Lajçak kundër Kosovës dhe heshtja e qeverisë!”, Gazeta Blic, 16 prill 2021, <https://gazetablic.com/dastid-pallaska-e-pabesueshme-njeanshmeria-e-miroslav-lajcak-kunder-kosoves-dhe-heshtja-e-qeverise/>

¹⁴⁶ “Zbulohet arsyeja pse Lajçak u takua me Vuçiqin”, Kosova Sot, 13 mars 2023, <https://www.kosova-sot.info/lajme/667501/zbulohet-arsyeja-pse-lajcak-u-takua-me-vuciqin/>; “Titulli i rremë për një zbulim rreth takimit Lajçak-Vuçiq”, Kallxo, 28 mars 2023, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-per-nje-zbulim-rreth-takimit-lajcak-vuciq/>

¹⁴⁷ Postim në Facebook, Hitshqipvideo, February 24, 2023, <https://www.facebook.com/hitshqipvideo/posts/pfbid0JxeHGMZL5jEYivZ1k-T9QqGS1zPv1ux2FNbUdBKpxWV4EtJoUj33n1ai5qGZR01hal>; “Titulli i rremë se deklarata e Lajçak po gëzon Kosovën”, Kallxo, 26 shkurt 2023, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-se-deklarata-e-lajcak-po-gezon-kosoven/>

Një postim tjetër në Facebook që mori 624 ndërveprime rrejtshëm deklaronte se Miroslav Lajçak kishte thënë se Marrëveshja e Ohrit nuk e kishte paraparë Asociacionin.¹⁴⁸

Më 29 nëntor 2022, disa uebsajte publikuan një lajm që pretendonte se zyrtarët serbë ishin në ankth dhe se kryeministrja e Serbisë, Ana Brnabiq, i kishte thënë Presidentit të Gjermanisë se propozimi i ri për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk mund të diskutohet pa formimin e Asociacionit. Megjithatë, artikulli nuk ofron ndonjë dëshmi që të konfirmojë se kryeministrja e Serbisë apo ndonjë zyrtar tjetër serb ishin “në ankth”.

Përderisa zyrtarët amerikanë ishin drejtpërdrejt të përfshirë në proces, informacione të rrejshme u publikuan edhe rreth emisarit amerikan në dialogun Kosovë- Serbi. Në disa raportime të mediave, Gabriel Escobar, Përfaqësues Special për Ballkanin Perëndimor, pretendohet të ishte anti-shqiptar. Një fotografi me tekstin “Escobar kundër popullit shqiptar të Kosovës”¹⁴⁹ ishte publikuar në Facebook pa ndonjë fakt mbështetës. Një publikim tjetër rreth Escobarit shkruan: “Gabriel Escobar nuk e përfaqëson politikën e jashtme të ShBA-ve. Ai përfaqëson lobin e fuqishëm serb në ShBA.”¹⁵⁰ Një fotografi e Ambasadorit të Serbisë në ShBA, Marko Gjuriq, ishte paraqitur si dëshmi e këtij pretendimi, por pa dhënë ndonjë dëshmi reale.

Më 4 shkurt 2023, një faqe në Facebook publikoi një lajm me titull “Escobar kundër popullit të Kosovës.”¹⁵¹ Përderisa artikulli flet se si emisari amerikan Gabriel Escobar nuk respekton vullnetin e popullit të Kosovës që është kundër Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ai nuk tregon nëse është lajm apo opinion dhe nuk ka autor. Ky artikull mori 921 reagime në Facebook. Aty shkruhet vetëm rreth kërkesës së kryeministres së Serbisë për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë Serbe në Kosovë, pa të cilin nuk mund të diskutohet propozimi i ri për dialogun mes dy vendeve.

Mediat ruse gjithashtu e kanë portretizuar negativisht edhe përfshirjen e BE-së dhe ShBA-ve në dialog. Për shembull, në platformën EUvsDisinfo, dezinformimi nga mediat ruse e paraqet Marrëveshjen e Ohrit si një grabitje ndaj Serbisë dhe si diçka që është arritur nën presionin e sanksioneve dhe nën kërcënimin e përjashtimit nga rruga e integritetit dhe fondet e BE-së.¹⁵² Ky postim thotë se nuk ka marrëveshje, dialog apo negociata ndërmjet Kosovës

¹⁴⁸ “Titulli i rremë se lajmi për vetëmenaxhimin po i qetëson qytetarët e Kosovës”, Kallxo, 25 prill 2023, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-se-lajmi-per-vetemenaxhimin-po-i-qeteson-qytetaret-e-kosoves/>

¹⁴⁹ Pelqeje faqen nese e perkrahe Albin Kurtin per kryeminister, Facebook, 3 shkurt 2023, <https://www.facebook.com/albinkurtikryemister2020/posts/pfbid0rgxbSmmA9AVViFugKJAVo1ZJ43kXGi62ERFxdHucu79WUHLrAgLH8trDZj4yHGQL>

¹⁵⁰ Pelqeje faqen nese e perkrahe Albin Kurtin per kryeminister, Facebook, 3 shkurt 2023 <https://www.facebook.com/albinkurtikryemister2020/posts/pfbid02S8e5SMcJuyJzV6HWBA3o3TYWnqQSoUwtn56nhYwTSYmQQ8MUFshhz5QhYTUeE47yt>

¹⁵¹ Facebook: Pelqeje faqen nese e perkrahe Albin Kurtin per kryeminister. 3 shkurt 2023. <https://www.facebook.com/albinkurtikryemister2020/posts/pfbid02viRYJRFzLzMXmHaEuYJDBgqhwEuMAyUToaga7MzRjbbza5RmMpeb2HW3c1E8LxAgvl>

¹⁵² EUvsDisinfo, The EU wants to expand its imperialism in the Balkans, October 11, 2021 <https://euvsdisinfo.eu/report/the-eu-wants-to-expand-its-imperialism-in-the-balkans>

dhe Serbisë pasi që Serbia nuk ka nënshkruar ndonjë dokument dhe se Vuçiq ka thënë se nuk do ta njohë Kosovën.

Dialogu është një nga temat më të mbuluara nga mediat e Kosovës, dhe një temë për të cilën janë publikuar më së shumti artikuj të rremë.

Verifikuesit e fakteve¹⁵³ kanë identifikuar 25 artikuj me informacion jokorrekt rreth kësaj çështjeje gjatë periudhës që mbulon ky studim. Një numër i madh i dezinformative synon ta paraqesë BE-në, Gjermaninë, Britaninë e Madhe dhe ShBA-të si pro- Kosovë dhe anti-Serbi. Dezinformatat e identifikuar nga platforma EUvsDisinfo¹⁵⁴ e paraqesin negativisht BE-në dhe hedhin dyshime se perëndimi, NATO dhe shtetet e BE-së po i bëjnë presion Serbisë për t'i imponuar sanksione për shkak të Rusisë dhe Kinës, dhe se po e mbështesin Kosovën. Dezinformatat që e paraqesin perëndimin si kundër Serbisë ishin publikuar dhe ripublikuar kryesisht para raundeve të ndryshme të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Për shembull, artikujt i portretizojnë vendet e perëndimit si kundërshtarë të Serbisë dhe Presidentit Aleksandar Vuçiq.

Artikulli me titull “Ndërkombëtarët “shuplakë” Vuçiqit dhe kundërshtarëve të Albin Kurtit brenda Kosovës!”¹⁵⁵ ishte publikuar 24 herë në Facebook. Ky artikull është i bazuar vetëm në burime anonime. Përveç kësaj, një citat i shpikur i Presidentit të ShBA-ve ishte publikuar 11 herë në Facebook.¹⁵⁶ Presidenti Biden nuk kishte thënë “s’ka më kompromis me Serbinë. S’ka marrëveshje pa njohje reciproke dhe s’ka Asociacion jokushtetues”, siç ishte raportuar në media. Një artikull tjetër i rremë me titull: “LAJM MADHËSHTOR / Kosova merr lajmin HISTORIK: “Serbia s’ka qenë asnjëherë aleate e SHBA-ve”¹⁵⁷ e paraqet perëndimin të jetë kundër Serbisë.¹⁵⁸ Lajme tjera dolën në sipërfaqe në janar 2023 të cilat e portretizonin Angela Merkelin si mbështetëse të Kosovës dhe kërcënim për Serbinë edhe pse Merkel nuk ishte atë kohë Kancelare e Gjermanisë.

Artikulli me titull, “Merkel i jep mësim Serbisë: “Kosova është shtet shqiptar”¹⁵⁹ ishte publikuar 260 herë në Facebook në 15 faqe gjatë janarit të vitit 2023. Ky lajm mori 17,792

¹⁵³ Krypometer (Fact Checking)

¹⁵⁴ EUvsDisinfo, Disinformation Database, https://euvsdisinfo.eu/disinformation-cases/?text=Kosovo+EU&date=&orderby=date&offset=20&per_page=10

¹⁵⁵ “Ndërkombëtarët “shuplakë” Vuçiqit dhe kundërshtarëve të Albin Kurtit brenda Kosovës!”, Lajme Origjinale, Facebook, 13 dhjetor 2022, <https://www.facebook.com/lajmeorigjinale/posts/pfbid02ZwRb7P6p6bMgDbz5H9EW5hjnEviDvAQMxkmf5KwBgTrAPsws-JPA9cACFjr1Vz62Kl>

¹⁵⁶ Data from CrowdTangle, accessed at: <https://apps.crowdtangle.com/search?platform=facebook&postTypes=&producer-Types=3&q=asn%20kompromis%20m%20C3%AB%20me%20Serbin%20C3%AB.%20Jo%20marr%20C3%ABvshja%20pa%20njohje-n%20reciproke%20dhe%20Jo%20asociacion%20antikushtetues&sortBy=date&sortOrder=desc&timeframe=1year>

¹⁵⁷ Pamfleti.com, Facebook, LAJM MADHËSHTOR / Kosova merr lajmin e HISTORIK: “Serbia s’ka qenë asnjëherë aleate e SHBA-së”, 17 shkurt 2023, https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=pfbid02HAFvknK7ogtkUibg18HrBWkiUffwFH2U1MKU7rNHydEe-boDtBnx24NhoP41Uq49oI&id=101118555235758

¹⁵⁸ Kallxo (Krypometër): “Lajmi rremë se Kosova do të marrë lajm historik”, 20 shkurt 2023 <https://kallxo.com/krypometer/lajmi-rreme-se-kosova-do-te-marre-lajm-historik/>

¹⁵⁹ NEWZ, “Merkel u jep shkollë Serbisë: “Kosova është shtet shqiptarë””, 4 janar 2023 <https://www.newztype.com/newz/?p=908>

reagime në Facebook. Vlen të theksohet fakti se kjo dezinformatë është e vjetër por vazhdon të marrë ndërveprime edhe sot.

1.7 Narrativat rreth dezinformimit për EULEX-in dhe për Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës

Ka pasur qarkullim të dezinformatave edhe lidhur me BE-në në Kosovë, kryesisht rreth misionit për sundim të ligjit, EULEX. Për shkak të aktiviteteve të EULEX-it në Kosovë, ka pasur shumë raportime të rreme për korrupsion rreth zyrtarëve të EULEX-it. Përveç kësaj, lajmi dominues ka qenë se EULEX transferoi te qeveria e Serbisë dosjet e krimeve të luftës që ishte duke i hetuar. Kjo narrativë është ndezur jo vetëm nga popullata vendase, por edhe nga ish-pjesëtarë të EULEX-it siç është rasti me ish-gjykatësin Malcolm Simmons, i cili ka synuar ta diskreditojë Gjykatën Speciale.¹⁶⁰ Simmons ka qenë i ftuar nga një komision parlamentar i Kuvendit të Kosovës për të dëshmuar kundër EULEX-it por edhe kundër Gjykatës Speciale.

Më 12 korrik 2021, përderisa po jepte dëshminë para Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, Simmons tha se misioni kishte transferuar dosjet e krimeve të luftës në Serbi në një lëvizje për ta promovuar dialogun mes Kosovës dhe Serbisë.¹⁶¹

Përveç kësaj, mediat në Kosovë¹⁶² raportuan për një letër që besohej se ishte shkruar nga Malcolm Simmons më 16 korrik 2020 e cila i ishte dërguar Kuvendit të Kosovës. Në të, Simmons tregonte për një bisedë që kishte me Boris Johnson, i cili atëherë ishte Sekretar i Jashtëm i Britanisë së Madhe. Johnson raportohet ta ketë përshkruar Gjykatën Speciale si “një gjykatë politike që i është përkulur vullnetit të Brukselit dhe e mbushur me sahanlëpirës që punojnë për xhepat e tyre”. Kjo narrativë është përsëritur sërish në vitin 2022 nga mediat e njëjta.¹⁶³

Simmons i tha Kuvendit të Kosovës: “Fatkeqësisht, ka plot njerëz atje që faktikisht duan t’i mbushin xhepat me ar”.¹⁶⁴

¹⁶⁰ “How a British Judge Caused Turmoil at the EU’s Kosovo Mission”, Bronwyn Jones, BIRN, June 6, 2022, <https://balkaninsight.com/2022/06/06/how-a-british-judge-caused-turmoil-at-the-eus-kosovo-mission/>


¹⁶¹ EULEX has denied these claims <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,11,2413>

¹⁶² “Simmons: Kryeministri i Britanisë Boris Johnson, e shihte Gjykatën Speciale si politike”, Gazeta Express, 25 nëntor 2020, <https://www.gazetaexpress.com/ish-gjykatesi-kryesor-i-eulex-it-kryeministri-i-britanise-boris-johnson-e-shihte-gjykatën-speciale-si-politike/>

¹⁶³ “Kryeministri i Britanisë: Gjykata Speciale është Gjykatë Politike, për t’i mbushur xhepat e lajkatarëve të BE-së”, Prishtina News, 18 dhjetor 2022, <https://prishtinanews.de/kryeministri-i-britanise-gjykata-speciale-eshte-gjykate-politike-per-ti-mbushur-xhepat-e-lajkatave-te-be-se/>

¹⁶⁴ “Dëshmia e Michael Simmons para Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulla të Procedurës dhe Mbikëqyrje të Agjencisë Kundër Korrupsionit “ Kuvendi i Kosovës. 1:31:45. <https://www.youtube.com/watch?v=1pLpB-4pkK4&>

Figura 14: Ndikimi i narrativave rreth EULEX-it



Edhe pse Simmons dëshmoi në vitin 2021, deklaratat e tij vazhduan të përdoren edhe në vitin 2022. Deklarata e tij ishte publikuar së paku gjashtë herë në dhjetor 2022 por asnjë nga këto publikime nuk përmbanin deklaratat e Kryeministrit të Britanisë së Madhe. Ajo që e dimë, së paku nga deklaratat e publikuara, është se Boris Johnson, gjatë një fjalimi në Kuvendin e Kosovës në vitin 2016, ka thënë që qytetarët duhet të bashkëpunojnë me Gjykatën Speciale.¹⁶⁵

Numri i artikujve të publikuar për Gjykatën Speciale u rrit përderisa koha e fillimit të gjyqimit të liderëve të UÇK-së po afrohej. Raportimet e përzgjedhura për analizë janë ato që përmbajnë akuza se gjykata është produkt i Serbisë dhe Ruisë. Kanë qenë 16 artikuj që kanë promovuar këto narrativa. Pretendimet e pambështetura ishin bërë kryesisht në studiot televizive nga ana e analistëve. Për shembull, televizioni publik RTK, më 2 nëntor 2022, transmetoi një debat me Bekim Çollakun, ish-këshilltar i Presidentit Hashim Thaçi. Në debat, Çollaku foli rreth arsyeve pse ishte themeluar Gjykata Speciale dhe punën e bërë nga kjo gjykatë. Çollaku tha se “gjithçka është e kontrolluar politikisht”.¹⁶⁶ Më vonë ai tha se kjo gjykatë “përveç investimit në propagandë, ka filluar edhe t’i frikësojë qytetarët e Kosovës: ka

¹⁶⁵ “Johnson Duhet të bashkëpunoni me Gjykatën Speciale)” Portali RTV 21, Youtube video, 10 nëntor 2016, <https://www.youtube.com/watch?v=H8ijlRyV8GU>

¹⁶⁶ “RTK Prime – Gjykata Speciale – “Krerët e UÇK-së tash e dy vjet në Hagë”, Program televiziv, RTK, 22 nëntor 2022. Minuta 07:03, <https://www.youtube.com/watch?v=wFY9ukFOugo>

Figura 15: Narrativat në Facebook kundër EULEXit dhe kundër Dhomave të Specializuara dhe Zyres së Prokurorit të Specializuar të Kosovës

Nga 15 tetori 2022 deri më 1 maj 2023, Gjykata Speciale është përmendur në 5,325 postime në Facebook të cilat kanë marrë 190,000 ndërveprime. Narrativat kryesore kundër EULEX-it dhe Gjykatës Speciale kanë qenë:

- Gjykata Speciale ka zyrë në Beograd
- Dëshmitarët e Gjykatës Speciale janë të paguar nga Serbia
- Gjykata Speciale është një gjykatë politike dhe raciste që është vënë në shërbim të krimeve dhe gjenocidit të Serbisë
- 19 orë e 24 minuta janë videot të cilat Serbia i ka përdorur për ta shantazhuar Hashim Thaçin- Naim Miftari hedh 'bombën': Këto janë vendet ku ata takohen me UDB-në!
- Kryeministri britanik: Gjykata Speciale është gjykatë politike për t'i mbushur xhepat e sahanlëpirësve të BE-së

njerëz që nuk guxojnë të flasin rreth saj sepse ekziston frika që një ditë dikush nga gjykatata do t'u vijë te dera”¹⁶⁷

Këto pretendime nuk mund të kategorizohen si të rreme, por është e qartë se ato nuk janë të mbështetura mjaftueshëm në fakte ose të paktën ato fakte nuk janë bërë të ditura deri në momentin e botimit të këtij studimi.

Në platformën e verifikimit të fakteve, Krypometri, janë shkruar 13 artikuj që kanë identifikuar informacionet e rrejshme, jo të plota ose pjesërisht të rrejshme rreth punës së Gjykatës Speciale ose rreth personave ndaj të cilëve Gjykata Speciale ka ngritur aktakuzë.

Artikujt e rremë rreth liderëve të UÇK-së që janë të akuzuar dhe kanë udhëtuar në Hagë kanë filluar të shpërndahen shumë kohë para se të nisnin proceset gjyqësore. Në vitin 2019, televizioni shtetëror serb, RTS, publikoi një lajm¹⁶⁸ në të cilin rrejshëm raportohej se liderët e UÇK-së ishin transferuar në Hagë. Në realitet, aktakuza ndaj Thaçit ishte ngritur më 5 nëntor 2020. Një artikull tjetër në vitin 2020 rrjeshëm raportonte se Xhavit Haliti,¹⁶⁹ një deputet i Kuvendit të Kosovës, ishte marrë në pyetje nga prokurorët e Hagës.

Ky artikull është shpërndarë 153 herë në Facebook dhe ka marrë 2,963 reagime.¹⁷⁰

Një storje tjetër e publikuar në mediat në gjuhën shqipe më 2 shkurt 2023 raportonte se Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati, krerët e Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, ishin

¹⁶⁷ *Ibid*, Minuta 31:22

¹⁶⁸ “Rrena mediale për fluturimet e ish-anëtarëve të UÇK-së për në Hagë”, Kallxo (Krypometër), 12 janar 2019 <https://kallxo.com/krypometer/rrena-mediale-per-fluturimet-e-ish-anetareve-te-uck-se-per-ne-hage/>

¹⁶⁹ “Xhavit Haliti demantoi lajmet se është ftuar nga Gjykata Speciale”, Kallxo (Krypometër), 10 nëntor 2020 <https://kallxo.com/krypometer/xhavit-haliti-demantoi-lajmet-se-eshte-ftuar-nga-gjykata-speciale>

¹⁷⁰ Crowdtangle

dënuar për krime të kryera gjatë luftës.¹⁷¹ E vërteta është se ata janë gjetur fajtorë për shpërndarje të informacionit jo-publik rreth hetimeve të Task Forcës Speciale Hetuese dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar pa autorizim. Ata nuk kanë qenë të akuzuar për krime të luftës.

Përveç kësaj, një artikull tjetër i rrejshëm zbuloi identitetin e një dëshmitari¹⁷² në rastin kundër ish-Presidentit Hashim Thaçi. Lajmi pretendonte se një dëshmitar kundër Thaçit është zbuluar në portalin Lajme.Buzz portal, dhe është shpërndarë në tetë faqe në Facebook: Gazeta Atdheu, Telegram.info, Janina Press, Der Kosova Albaner, Lajme Buzz, Der Albaner +, Der Albanian, Global INFO. Bazuar në informacionin e nxjerrë nga aplikacioni “CrowdTangle”, administruesit e të gjitha këtyre faqeve janë nga Maqedonia e Veriut.

Artikuj tjerë të rremë apo të pakompletuar ishin publikuar rreth shëndetit të liderëve të UÇK-së¹⁷³ që janë në Hagë, për deklarimin e tyre në gjykatë, si dhe për lirin e tyre të përhershëm¹⁷⁴ ose të përkohshëm¹⁷⁵.

¹⁷¹ “Rrena se Gucati e Haradinaj u dënuan për krime luftime” Kallxo (Krypometër), 2 shkurt 2023 <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-gucati-e-haradinaj-u-denuan-per-krime-lufte/>

¹⁷² “Rrena për zbulimin e dëshmitarit kundër ish presidentit Thaçi në Hagë”, Kallxo (Krypometër), 11 gusht 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-zbulimin-e-deshmitarit-kunder-ish-presidentit-thaci-ne-hage/>

¹⁷³ Rrena se Hashim Thaçi ka pësuar sulm në zemër, Kallxo (Krypometër), 28 prill 2023 <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-hashim-thaci-ka-pesuar-sulm-ne-zemer/>

¹⁷⁴ “Rrena për lirin e krerëve të UÇK-së nga Haga, Kallxo (Krypometër), 9 shtator 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-lirin-e-krereve-te-uck-se-nga-haga/>

¹⁷⁵ Lajmi rrejshëm për kthimin e Kadri Veselit në Kosovë, Kallxo (Krypometër), 10 dhejtor 2021, <https://kallxo.com/krypometer/lajmi-rrejshem-per-kthimin-e-kadri-veselit-ne-kosove/>

Figura 16: Ilustrimi i hartës së shpërndarjes nga burimet nga Maqedonia e Veriut rreth Gjykatës Speciale



Figure 17: The impact of narratives about the establishment of the Specialist Chambers

Ndikimi i narrativave rreth themelimit të Gjykatës Speciale

Të dhënat nga hulumtimi i opinionit (Omnibus) të zhvilluar në maj tregojnë se dezinformimi gjatë kësaj periudhe ka pasur një ndikim te qytetarët.

1,056 qytetarë nga komuniteti shqiptar dhe ai serb janë pyetur nëse i besojnë lajmit se “Hashim Thaçi është i akuzuar për trafikim organesh”.



Në aktakuzën e publikuar nga Gjykata Speciale, Hashim Thaçi nuk është i akuzuar për trafikim organesh; megjithatë, storjet e rreme kanë bërë që qytetarët t'i besojnë këtyre supozimeve.

Ndikimi kinez në media dhe në publik

1.8 Narrativat promovuese të ekonomisë dhe produkteve kineze

Kina nuk e njeh sovranitetin e Kosovës, megjithatë kjo nuk e ka ndaluar atë që të angazhohet në tregti me Kosovën. Në vitin 2021, vlera e produkteve të eksportuara nga Kina në Kosovë ka arritur shumën prej 450 milionë euro, apo 30 milionë euro më shumë se sa në vitin paraprak.

Në Kosovë, nuk ka ndonjë agjenci të lajmeve që dihet se është kineze. Megjithatë, ekziston një faqe në Facebook e një radioje,¹⁷⁶ që publikon lajme në gjuhën shqipe, e që është një media e kontrolluar nga shtetit kinez, radio kjo që ka 1.1 milion ndjekës në Facebook. Përdersa faqja në Facebook e kësaj radioje shpërndan lajme që lidhen me Kinën dhe ShBA-të, portali i saj po ashtu publikon lajme nga Shqipëria e Kosova e që prodhohen nga mediat lokale. Megjithatë, ky portal po ashtu publikon deklarata të qeverisë së Kinës rreth ngjarjeve aktuale në Kosovë, siç ishte arrestimi i dy zyrtarëve të OKB-së¹⁷⁷ nga Policia e Kosovës.

Një temë e raportuar gjerësisht nga Kina ka të bëjë me përdorimin e teknologjisë kineze 5G, e cila është e ndaluar në ShBA. Në një marrëveshje të nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë në mes të Kosovës e Serbisë me 4 shtator 2020, Kosova ishte zotuar që të mos përdor teknologjinë kineze 5G.¹⁷⁸ Qeveria e Kosovës ua ka ndaluar institucioneve të Kosovës që të blejnë teknologji nga vende të cilat janë nën masa të sanksioneve, duke përfshirë këtu edhe disa prodhues kinezë.¹⁷⁹ Një artikull pjesërisht i rrejshëm ishte publikuar në mediat e Kosovës, e që thoshte se qeveria e ka ndaluar edhe prodhuesin kinez Huawei.

E vërteta qëndron në faktin që megjithëse institucionet shtetërore nuk mund të blejnë produkte nga ky prodhues, qytetarët dhe bizneset ende mund të vazhdojnë të importojnë produkte të Huawei. Në periudhën prej 15 tetor 2022 deri me 15 mars 2023, faqja në

¹⁷⁶ Radio Ejani, Facebook, qasur së fundmi me 17 maj 2023, <https://www.facebook.com/CMGShqip>

¹⁷⁷ I dërguari kinez: Arrestimet e stafit të OKB-së në Kosovë janë të papranueshme, CRI Online Shqip, 11 qershor 2019, <https://albanian.cri.cn/1552/2019/06/11/28s179825.html>

¹⁷⁸ Serbia dhe Kosova nënshkruajnë marrëveshje për normalizim ekonomik në një ceremoni në Zyrën Ovale, CNN, 4 shtator 2020, <https://edition.cnn.com/2020/09/04/politics/serbia-kosovo-agreement/index.html>

¹⁷⁹ Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, Republika e Kosovës.. "Njoftim për Ndalimin e Pajisjeve të Prodhura nga Subjektet Kineze" <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Lajmet%20levizese/alb/576/Njoftim%20p%C3%ABr%20AK%20-%20Specifikimet%20teknike.pdf>

Facebook e radios së kontrolluar nga Kina ka postuar 68 storje që kanë përmendur rrjetin 5G. Artikujt nga mediat e kontrolluara nga Kina rreth rrjetit 5G janë publikuar edhe nga mediat në Kosovë dhe në Maqedoni të Veriut. Shembull i kësaj është artikulli i quajtur “Dërgesat e telefonave kinezë 5G rriten për 70 për qind në periudhën janar-shtator” e që është publikuar e ripublikuar në disa media në Kosovë¹⁸⁰,¹⁸¹ dhe në Maqedoni të Veriut. Mediat kosovare¹⁸² dhe ato maqedonase¹⁸³ kanë ripublikuar edhe artikullin e kontrolluar nga Kina: “Gjiganti teknologjik kinez Huawei paralajmëron thellimin e partneritetit me prodhuesin kryesor austriak të dronëve Dronetech për një bujqësi inteligjente të mundësuar nga teknologjia 5G”.

Po ashtu janë publikuar edhe artikuj nga media të kontrolluara nga Kina rreth investimeve të huaja. Një artikull i këtillë “Norma e inflacionit mbetet e qëndrueshme përballë pandemisë, ndërkohë që viti 2022 shënon rritje në investimet e huaja” fillimisht ishte publikuar nga një medium,¹⁸⁴ e pastaj ishte ripublikuar një medium tjetër lokal¹⁸⁵ si dhe në Radion e Jashtme e Kinës (China Foreign Radio, albanian.cri.cn).¹⁸⁶ Një artikull tjetër me titull “Tregtia e jashtme e Hebei tejkalon mbi 310 bilion yuan në janar-korrik” ishte publikuar një media¹⁸⁷ dhe më vonë u publikua edhe në një media tjetër në gjuhën shqipe¹⁸⁸ dhe në një faqe të një mediumi të kontrolluar nga Kina, Albanian.cri.cn.¹⁸⁹ Mediat e kontrolluara nga Kina kanë publikuar artikuj të shumtë në gjuhën shqipe që lavdërojnë Kinën, ekonominë kineze si dhe turizmin, si dhe që promovojnë produktet kineze, si për shembull veturat elektrike.¹⁹⁰

¹⁸⁰ “Dërgesat e telefonave 5G të Kinës arrijnë 70 për qind në janar-shtator”, Infokus, 25 tetor 2021, <https://gazetainfokus.com/dergesat-e-telefonave-5g-te-kines-arrijne-70-per-qind-ne-janar-shtator/>

¹⁸¹ “Rritet me 70% dergesa e telefonave 5G në Kinë”, TV21, postim në Facebook, 25 tetor 2021, https://www.facebook.com/673190229477851/posts/2409811612482362/?locale=de_DE&paipv=0&eav=AfbrN1aFkbJUoezEQnh-4Lxf-wZB_jcvGqykotcqmqJg-j9wqLjYbV-Z5plMXzjzSLxo&_rdr

¹⁸² Huawei dhe prodhuesi austriak i dronëve Dronetech thellojnë partneritetin në bujqësinë inteligjente TV21, 6 tetor, 2022, <https://tv21.tv/huawei-dhe-prodhuesi-austriak-i-droneve-dronetech-thellojne-partneritetin-ne-bujqesine-inteligjente/>

¹⁸³ Huawei dhe prodhuesi austriak i dronëve Dronetech thellojnë partneritetin në bujqësinë inteligjente, ZHURNAL.MK, postim në Facebook, 6 tetor 2022, <https://www.facebook.com/100064455442235/posts/470146325143878>

¹⁸⁴ “Norma e inflacionit mbetet e qëndrueshme përballë pandemisë, ndërkohë që viti 2022 shënon rritje në investimet e huaja”, Infokus, 24 dhjetor 2022, <https://gazetainfokus.com/norma-e-inflacionit-mbetet-e-qendrueshme-perballe-pandemise-nderkohe-qe-viti-2022-shenon-rritje-ne-investimet-e-huaja/>

¹⁸⁵ “Norma e inflacionit mbetet e qëndrueshme përballë pandemisë, ndërkohë që viti 2022 shënon rritje në investimet e huaja”, TV21, 24 dhjetor 2022, <https://tv21.tv/norma-e-inflacionit-mbetet-e-qendrueshme-perballe-pandemise-nderkohe-qe-viti-2022-shenon-rritje-ne-investimet-e-huaja/>

¹⁸⁶ Numrat në luftën kundër COVID-19 në Kinë: norma e inflacionit e Kinës mbetet e qëndrueshme pavarësisht rritjes globale të çmimeve, CRI Online Shqip, 24 dhjetor 2022, <https://albanian.cri.cn/2022/12/24/ARTIUAWnh4qTKR3W8iBid87G221224.shtml>

¹⁸⁷ Tregtia e jashtme e Hebeit tejkalon 46 miliardë dollarë në janar-korrik, Infokus, 21 gusht 2022 <https://gazetainfokus.com/tregtia-e-jashtme-e-hebeit-tejkalon-46-milarde-dollare-ne-janar-korrik/>

¹⁸⁸ Tregtia e jashtme e Hebeit tejkalon 46 miliardë dollarë në janar-korrik,, TV21, postim në Facebook, 21 gusht 2022 <https://www.facebook.com/tv21hd/posts/tregtia-e-jashtme-e-hebeit-tejkalon-46-milard%C3%AB-dollar%C3%AB-n%C3%AB-janar-korrik/2674193912710796/>

¹⁸⁹ Tregtia e jashtme e Hebeit tejkalon 310 miliardë juan në janar-korrik, CRI Online Shqip, 21 gusht 2022 <https://albanian.cri.cn/news/china/3124/20220821/777432.html>

¹⁹⁰ Industria e automjeteve me energji të re në Kinë, me ritme të shpejta zhvillimi, CRI Online Shqip, 31 dhjetor 2022 <https://albanian.cri.cn/2022/12/31/ARTIpe4m3ntEcqorrA7IRLQw221231.shtml?fbclid=IwAR3OutoS4KcPrj1RbJRX1XplihcqX282dp-nD6OUBf3mB2QPCyhr4Uw2lAk>

1.9 Narrativat e Kinës kundër ShBA-ve

Një temë tjetër e mbuluar gjerësisht nga faqet e kontrolluara nga Kina ka të bëjë me ShBA-të, e cila është përmendur në 253 postime në periudhën 15 tetor 2022 deri me 1 prill 2023. Postimet kanë përfshirë kundërpërgjigjet e zyrtarëve kinezë kundrejt deklaratave e politikave të ShBA-ve. Mediat kineze e përshkruajnë ShBA-në si të dhunshme, të mbushur me armë dhe me një shkallë të lartë të vrasjeve.¹⁹¹ Një nga këto postime thoshte që “Demokracia amerikane, brenda sjellë përçarje shoqërore e jashtë shkakton luftëra”.¹⁹²

Në ndërkohë, një postim tjetër e akuzon ShBA-në që po sillet si një “polici botërore” dhe ka pyetur nëse “ShBA-të po e shtyjnë demokracinë e tyre drejt një rruge pa kthim?”¹⁹³ Mediat e kontrolluara nga Kina i kanë dedikuar një video edhe Samitit për Demokraci që është organizuar nga Presidenti Joe Biden, ku e kanë kritikuar ShBA-në për organizimin e një samiti në kohën kur vetë demokracia e tyre ka probleme të mëdha.¹⁹⁴ Mediat e kontrolluara nga Kina kanë raportuar që “Lindja e Mesme përsëri doli jashtë ‘skenarit të ShBA-së’”.¹⁹⁵ Pas 12 viteve të izolimit, Siria është rikthyer në familjen e Ligës së Shteteve Arabe.

CNR po ashtu e paraqet Amerikën si një shtet ku nuk ka siguri, nuk ka demokraci dhe ku shëndetësia e ekonomia janë në nivele të ulëta.

Përmes disa artikujve të tillë në gjuhë shqipe, ShBA-të paraqiten si një shtet me një shkallë të lartë të vrasjeve duke krijuar përshtypjen që ShBA-të janë vend i rrezikshëm për të jetuar në të, siç ilustron në tekstin në vijim:

“Shën Luisi në shtetin amerikan të Missouri ishte një nga qendrat më me prosperitet industrial në ShBA në shekullin e 20-të. Mirëpo, sot, Shën Luisi është një nga qytetet më të rrezikshme amerikane me shkallën më të lartë të vrasjeve në botë.”¹⁹⁶

Për të përforcuar edhe më shumë këtë narrativë, një artikull tjetër flet se si është rritur kërkesa për libra për fëmijë që merren me trauma të llojeve të ndryshme dhe e theksojnë

¹⁹¹ Sipas njoftimeve të 28 marsit të rrjetit televiziv amerikan ABC, në tre muajt e parë të këtij viti të shtënave me armë përsëri ishin në krye të lajmeve të medie, Radio Ejani, postim në Facebook, 30 mars, 2023 <https://www.facebook.com/100069414030566/posts/525862076404256>

¹⁹² Demokracia” amerikane, brenda sjell ndarje shoqërore dhe jashtë shkakton luftëra, Radio Ejani, postim në Facebook, 30 mars 2023, <https://www.facebook.com/watch/?v=543321644607955>

¹⁹³ Po aty..

¹⁹⁴ A nuk është ajo si ata kërmijtë në zjarr?. Radio Ejani, postim në Facebook, 27 Mars 2023 <https://www.facebook.com/100069414030566/posts/524390969884700>

¹⁹⁵ Postim në Facebook post, Lindja e Mesme doli përsëri jashtë “skenarit të ShBA-së”, Radio Ejani, 9 maj 2023 <https://www.facebook.com/watch/?v=543321644607955>

¹⁹⁶ Amerika e vërtetë: Banorë të Shën Luisit thonë se duhet të ndalojnë krimin vetë, CRI Online Shqip, 24 mars 2023, <https://albanian.cri.cn/2023/03/24/VIDEcV7PMq8X3g7J0b6vQ4BH230324.shtml>

çështjen e vrasjeve nëpër shkolla¹⁹⁷ apo një artikull që tregon se si “vrasjet me armë dhe vetëvrasjet kanë arritur një numër historikisht të lartë në Shtetet e Bashkuara”¹⁹⁸.

Në kuadër të këtyre narrativave anti-ShBA, CNR herë pas here publikon artikuj që reflektojnë mbi atë se si është dobësuar ekonomia amerikane¹⁹⁹ apo se si ajo ka dështuar të përballet me pandeminë, duke përdorur tituj si “ShBA-ja, pengesa nr. 1 e përbashkimit të përbashkët global të COVID-19”.²⁰⁰

Gjithashtu, CNR mundohet të krijojë besimin që në emër të demokracisë, ShBA-të kanë ndërmarrë veprime anti-demokratike. Politikat amerikane janë prezantuar si politika që prodhojnë polarizime dhe përçarje shoqërore brenda vetë vendit, ndërsa në vende të tjera si politika që shkaktojnë luftëra.²⁰¹ Gjithashtu, një artikull tjetër flet se si Samiti për Demokraci, është “një farsë tjetër amerikane që bëhet në emër të demokracisë”²⁰².

¹⁹⁷ ShBA, rritet ndjeshëm kërkesa për libra fëmijësh mbi trajtimin e traumave, CRI Online Shqip, 14 tetor 2022, <https://albanian.cri.cn/2022/10/14/ARTI5iDmDh0766VVUBPorxtT221014.shtml>

¹⁹⁸ “Vdekjet me armë në SHBA shënojnë rekord të lartë, CRI Online Shqip, 13 tetor 2022, <https://albanian.cri.cn/2022/10/13/ARTIN-7JcBs5MQ6TxTJZxfjz221013.shtml>

¹⁹⁹ PBB-ja e tremujorit të katërt në SHBA, më e dobët nga sa pritej, CRI Online Shqip, 26 shkurt 2023, <https://albanian.cri.cn/2023/02/26/ARTIQxDZRNmc0HpjHh2Clf6o230226.shtml>

²⁰⁰ CMG: ShBA-ja, pengesa nr. 1 e përbashkimit të përbashkët global të COVID-19, CRI Online Shqip, 11 janar 2023, <https://albanian.cri.cn/2023/01/11/ARTIpesivQfCKc348TtykVF5230111.shtml>

²⁰¹ “Demokracia” amerikane, brenda sjell ndarje shoqërore dhe jashtë shkakton luftëra, Radio Ejani, 30 mars 2023, <https://www.facebook.com/watch/?v=543321644607955>

²⁰² “ShBA-ja zhvillon Samitin për Demokracinë me qëllime egoiste”, CRI Online Shqip, 27 mars 2023, <https://albanian.cri.cn/2023/03/27/ARTILvCaW5KLQuYt7XYqUO8E230327.shtml>

1.10 Narrativat mbi shëndetin publik e që mbështeten nga Kina

Përgjatë periudhës kur janë analizuar postimet, narrativat e shpërndara nga agjencia kineze e lajmeve Radio e Jashtme e Kinës²⁰³ (CRI Online) rreth shëndetit publik në gjuhën shqipe janë ripublikuar nga mediat në Kosovë. CRI Online ka postuar 317 postime rreth COVID-19 në faqen e tyre në Facebook,²⁰⁴ e disa sosh janë ripublikuar edhe në portale e ueb faqe të ndryshme.

Një artikull i quajtur, “Zyrtari kinez: numri i qytetarëve që kërkojnë trajtim nëpër klinika është në rënie”, është ripublikuar nga platforma mediale²⁰⁵ dhe në faqe të tjera²⁰⁶ në gjuhën shqipe. Një shembull tjetër është edhe një lajm i titulluar, “FMN ngrit parashikimet për rritje globale në vitin 2023 pas rihapjes së Kinës,” e cila është ripublikuar nëpër portale online²⁰⁷ pasi që ishte publikuar në median e sponsoruar nga shteti kinez, CRI Online.²⁰⁸ I njëjti artikull pastaj ishte shpërndarë edhe në pesë media të tjera.²⁰⁹

Mediat e qeverisë kineze kanë publikuar edhe artikuj të cilët janë prodhuar apo gjeneruar nga mediat e Kosovës. Kjo mund të jetë bërë me qëllim që të rritet shpërndarja dhe audienca si dhe për të bërë që mediat të duken sa më gjithëpërfshirëse. Disa artikuj të tjerë të publikuar në media vendore mund të gjenden edhe në ueb faqen e CRI Online. Koha në të cilën janë publikuar është e rëndësishme; ka pasur raste kur një portal kosovar e ka publikuar së pari tekstin, e pastaj i njëjti është ripublikuar nga CRI Online. Një shembull që e ilustron këtë është artikulli, “Kinë, vala e fundit e COVID-19 ka përfunduar”, i cili ishte publikuar fillimisht nga një media në gjuhën shqipe,²¹⁰ e pastaj ishte ripublikuar në CRI Online.²¹¹

²⁰³ Radio e Jashtme e Kinës Online, media e kontrolluar nga shteti kinez, <https://albanian.cri.cn/>

²⁰⁴ Radio Ejani, <https://www.facebook.com/CMGShqip>

²⁰⁵ Në rënie numri i njerëzve që kërkojnë trajtim në klinika, Infokus, 16 janar 2023, <https://gazetainfokus.com/ne-renie-numri-i-njerezve-ke-kerkojne-trajtim-ne-klinika/>

²⁰⁶ Në rënie numri i njerëzve që kërkojnë trajtim në klinika, Javanews.al, postim në Facebook, 16 janar 2023 <https://www.facebook.com/100064036089709/posts/558596142951584>

²⁰⁷ FMN-ja ngre parashikimin për rritjen globale më 2023 pas rihapjes së Kinës, Infokus, 31 janar 2023, <https://gazetainfokus.com/fmn-ja-ngre-parashikimin-per-rritjen-globale-me-2023-pas-rihapjes-se-kines/>

²⁰⁸ FMN-ja ngre parashikimin për rritjen globale më 2023 pas rihapjes së Kinës, CRI Online Shqip, 31 janar 2023, <https://albanian.cri.cn/2023/01/31/ARTI4Jqu5rdH7aZOCG0Yd80T230131.shtml>

²⁰⁹ FMN-ja ngre parashikimin për rritjen globale më 2023, TV21, postim në Facebook, 31 janar 2023, <https://www.facebook.com/100076150463072/posts/210532178161796>

²¹⁰ Kinë, vala e fundit e Covid-19 ka përfunduar, TV21, 30 janar 2023, <https://tv21.tv/kine-vala-e-fundit-e-covid-19-ka-perfunduar/>

²¹¹ Përqindja e infektimit nga COVID-19 gjatë Festës së Pranverës në Kinë është e ulët, CRI Online Shqip, 30 janar 2023, <https://albanian.cri.cn/2023/01/30/ARTI3w0Gfmrww0dDQwAzvgXI230130.shtml>

Figura 18: Dezinformimi i shpërndarë nga Maqedonia e Veriujë

Dezinformimi i shpërndarë nga Maqedonia e Veriut

Profili i quajtur Lajme.buzz ka publikuar më parë lajme rreth Kosovës. Nga korriku 2022 deri në maj 2023, sipas Krypometrit, ky profil ka publikuar 30 artikuj me dezinformata, kontekst të munguar etj.

Ky portal menaxhon së paku 10 faqe të Facebook-ut që postojnë lajme: Lajme Buzz, Der Kosova Albaner, Atdheu.net, Janina Press, Der Albaner, Telegrami.info, Ich Bin Albaner, Der Albaner+, Info Globale dhe Video Interesante.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga 'Crowd Triangle', të gjitha këto faqe kanë administratorë nga Maqedonia e Veriut. Lajmet e publikuara në uebsajtin <https://web.lajme.buzz> dhe <https://mainneesplus.com> u shpërndanë nga faqet e Facebook-ut. Këto tri uebsajte publikojnë lajme të njëjta.





Figura 19: Tri narrativat dezinformuese të deputetit të Parlamentit Evropian gjatë vizitës në Kosovë

Tri narrativat dezinformuese të eurodeputetit Bay gjatë vizitës në Kosovë

Në fund të tetorit 2022, eurodeputeti francez Nicolas Bay vizitoi Kosovën dhe lansoi një fushatë propaganduese.

Një anëtar i partisë së ekstremit të djathtë “Reconquete”, Bay në Twitter dhe Facebook shpërndau tri narrativa kryesore: Së pari, ai njollosoi UÇK-në si terroriste. Së dyti, shtrembëroi kontekstin historik të Kosovës duke thënë se ajo nuk është aneksuar asnjëherë nga Serbia.

Së treti, ai e portretizoi Kosovën si një vend islamik dhe insinuoï se në Kosovë ka mungesë tolerance për kishat dhe praktikimin e fesë ortodokse.



Për më tepër, mesazhet e tij janë shpërndarë 48 herë


në 42 faqe të ndryshme në Facebook.

II. Narrativat dhe dezinformatat që dëmtojnë sigurinë, ulin besimin ndaj Perëndimit dhe i përkeqësojnë marrëdhëniet ndër-etnike

Megjithëse narrativat që dëmtojnë sigurinë, ulin besimin ndaj Perëndimit dhe i përkeqësojnë marrëdhëniet ndër-etnike janë prezente edhe në shtete të tjera, dëmi që shkaktohet nga narrativat e rrejshme është posaçërisht i dëmshëm për Kosovën, si rrjedhojë e situatës aktuale politike.

Edhe në rastin më të mirë, dezinformatat e thellojnë mosbesimin në mes të komuniteteve që kanë raporte të ftohura në mes vete, në këtë rast shqiptarët dhe serbët e Kosovës. Në rastin më të keq, ato e dëmtojnë jetën e njerëzve. Prandaj, ky është fokusi kryesor i analizës sonë në këtë kapitull. Ky kapitull synon të rrisë vetëdijen e qytetarëve dhe të institucioneve për faktin se ky nivel i dezinformatave e dëmton sigurinë e qytetarëve dhe marrëdhëniet ndër-etnike.

Figura 20 - Harta e dezinformatave të brendshme dhe ndër-etnike



2.1 Dezinformatat rreth marrëdhënieve dhe incidenteve ndëretnike

Përderisa shqiptarët dhe serbët e Kosovës kanë interpretime qartësisht të ndryshme rreth luftës në Kosovë, ngjarjet aktuale po ashtu i përshtaten një narrative të caktuar.

Ne fillimisht kemi analizuar ngjarjet që pasuan pas vendimit të qeverisë së Kosovës për të ndaluar përdorimin e tabelave të makinave 'KM' të lëshuara nga Serbia dhe që përdoreshin nga banorët e komunave në veri të Kosovës (Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq).²¹² Ky vendim ishte jashtëzakonisht i papëlqyeshëm në mesin e popullsisë lokale, veçanërisht kërkesa që zyrtarët policorë të komunitetit serb (e që përbëjnë shumicën e popullsisë së komunave në veri të vendit) të shqiptojnë gjoba për popullsinë lokale të përbërë në shumicë nga serbë të cilët i përdorin tabelat KM (kjo ngase institucionet e Kosovës i konsiderojnë këto tabela si ilegale).

Zyrtarët policorë serbë dhanë dorëheqje masive, e pas tyre njëjtë vepruan edhe prokurorët e gjykatësit. Veturat me tabela të lëshuara nga institucionet e Kosovës u dogjën. Katër kryetarët e komunave në veri po ashtu dhanë dorëheqje. Si kundërpërgjigje, institucionet e Kosovës filluan të përgatisnin zgjedhjet e reja. Komisioni Komunal Zgjedhor u sulmua në dy komuna, ndërsa zyrat e tyre u demoluan.

Kjo çoi deri te arrestimi i Dejan Pantiqit nga institucionet e Kosovës, një ish zyrtar i Policisë së Kosovës, me pretendimin se ai e kishte organizuar sulmin në zyrat e Komisionit Zgjedhor. Pantiqi u deklarua i pafajshëm ndaj akuzave që rëndonin kundër tij. Pas arrestimit të Pantiqit, serbët lokalë organizuan barrikatadat që i bllokuan rrugët për një muaj. Barrikatadat u larguan në të njëjtën kohë kur Pantiqi u lirua nga paraburgimi, dhe kjo masë e paraburgimit ndaj tij, u zëvendësua me masën e arrestit shtëpiak.

Zgjedhjet për kryetarë të komunave që fillimisht ishin vendosur të mbaheshin në muajin dhjetor, u shtynë për muajin prill të vitit 2023. Para zbatimit të fazës së dytë të politikës për tabelat e regjistrimit të makinave, e cila do t'u kërkonte zyrtarëve policorë që të shqiptojnë gjoba për vozitësit e veturave me tabelat KM, një marrëveshje e re u arrit në Bruksel, më mes të udhëheqësve të Kosovës dhe të Serbisë. Institucionet e Kosovës u pajtuan që të mos e zbatojnë vendimin për veturat që tashmë ishin regjistruar me tabelat KM, e në anën tjetër, Beogradi u pajtua që të mos lëshojë tabela të reja KM për komunat me shumicë të

²¹² *Popullsia në veri të Kosovës llogaritet të jetë rreth 40,000 njerëz, shumica e të cilëve janë serb. Tabelat KM e marrin e tyre nga "Kosovska Mitrovica", si referencë nga sistemi i ish Jugosllavisë e që përdorte shkronjat e qyteteve për identifikim të tabelave. Megjithatë, që nga përfundimi i luftës, Kosova ka përdorur një sistem të numërimit, dhe përdor numrat për të identifikuar të shtatë regjionet e vendit nëpër tabela.*

popullatës serbe në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe, mediat në gjuhën serbe e vendosën fokusin në prodhimin e përmbajtjes që tregonte kërcënimet dhe presionin e vendosur në serbët e Kosovës dhe dhe në agresivitetin dhe radikalizmin e njësive të Policisë së Kosovës²¹³ si dhe të Kryeministrit të Kosovës.

Në anën tjetër, mediat në gjuhën shqipe në Kosovë, po ashtu shpërndanë dezinformata. Një shembull i kësaj ishte nga një portal në gjuhën shqipe, ku artikulli thoshte se ishte lëshuar një lajmërim rreth zgjedhjeve në veri²¹⁴ dhe që Vuçiqi kishte një plan për të destabilizuar veriun e Kosovës.²¹⁵ Nëndërkohë, një nga narrativat e shpërndara në komunitetin serb ishte që një aksion i ngjashëm me “Oluja (Stuhia)”²¹⁶ do të ndodhte ndaj serbëve të Kosovës.

Kjo narrativë filloi pasi që Policia e Kosovës vendosi njësi të reja në Mitrovicë të Veriut më 8 dhjetor 2022, e që erdhi si rezultat i një sulmi ndaj ndërtesave të qeverisë që ishin destinuar që të shërbejnë si qendra komunale të zgjedhjeve. Dezinformatat që Policia po dërgonte përforcime në veri²¹⁷ për të sulmuar popullatën serbe u raportuan fillimisht nga portali serb në Kosovë,²¹⁸ dhe u ripublikuan (me gjithë përmbajtjen dezinformuese) nga dhjetëra media të tjera serbe, duke përfshirë ueb faqe si blic.rs,²¹⁹ naslovi.et,²²⁰ pink.rs,²²¹

²¹³ Njësitë ROSU në “gjah” kundër serëve në Gazivodë dhe zjarri shkrepet nga makineritë e armatosura; KP: Ne gjuajmë në vetëmbrojtje (kosovo-online.com, dhjetor 2022) dhe Zyratë e Policisë e kanë bllokuar veriun, nuk ka incidente por ka tension, (kosovo-online.com, dhjetor 2022).

²¹⁴ Titulli i rremë së në Beograd është “ngritur alarm” për zgjedhjet në Mitrovicë të veriut, Kallxo (Krypometer), 17 dhjetor 2022 <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-se-ne-beograd-eshte-ngritur-alarm-per-zgjedhjet-ne-mitrovice-te-veriut/>

²¹⁵ Titull i pambështetur në fakte për “skenarin e Vuçiqit për veriun, Kallxo (Krypometer), 28 dhjetor 2022 <https://kallxo.com/krypometer/titull-i-pambeshtetur-ne-fakte-per-skenarin-e-vuciqit-per-veriun/>

²¹⁶ Aksioni Stuhia (Operacija Oluja në gjuhën kroate) ka qenë një ofensive e ushtrisë kroate me qëllim të rimarrjes së zonave të cilat ishin pushtuar nga forcat serbe në Republikën e Kroacisë. Ky aksion qoi në humbje të konsiderueshme të jetëve të civilëve dhe nxiti eksodin masiv të serbëve nga veri.

²¹⁷ Rrena për bllokimin e Mitrovicës së Veriut nga Njësia Speciale, Kallxo (Krypometer), 8 dhjetor 2022 <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-bllokimin-e-mitrovices-se-veriut-nga-njesia-speciale/>

²¹⁸ Zyratë policor bllokuan Mitrovicën e Veriut, nuk ka incidente por ka tensione” (Kosovski policajci blokiralí Severnu Mitrovicu, nema incidenata ali napeto), kosovo-online.com, 8 dhjetor 2022, <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/kosovski-policajci-blokiralí-severnu-mitrovicu-nema-incidenata-ali-napeto-9-12-2022>

²¹⁹ “Forca të reja të Policisë së Kosovës kanë hyrë në Mitrovicë të Veriut, kanë zbarkuar në pika të ndryshme nëpër qytet(VIDEO) (Nove snage kosovske policije ušle u Severnu Mitrovicu, rasporedene na više punktova u gradu (VIDEO))” Blic.rs, 8 dhjetor 2022, <https://www.blic.rs/vesti/politika/nove-snage-kosovske-policije-usle-u-severnu-mitrovicu-rasporedene-na-vise-punktova-u-xb9hhj3>

²²⁰ “Forca të reja të Policisë së Kosovës kanë hyrë në Mitrovicë të Veriut, kanë zbarkuar në pika të ndryshme nëpër qyte(VIDEO) (Nove snage kosovske policije ušle u Severnu Mitrovicu, rasporedene na više punktova u gradu (VIDEO))” naslovi.net, 8 dhjetor 2022, <https://naslovi.net/2022-12-09/blic/nove-snage-kosovske-policije-usle-u-severnu-mitrovicu-rasporedjene-na-vise-punktova-u-gradu-video/32183734>

²²¹ “ROSU KA BLOKUAR MITROVICEN E VERIUT! Mbi 200 pjesëtarë të forcave të armatosura speciale të Kurtit kanë zbarkuar nëpër qytet - DY SHOK BOMBA JAN; HEDHUR(ROSU BLOKIRALA SEVERNU MITROVICU! Više od 200 Kurtijevih naoružanih specijalaca raspoređeno po obodu grada- BAČENE I DVE ŠOK BOMBE)”, pink.rs, 8 dhjetor 2022, <https://pink.rs/politika/456598/rosu-blokirala-severnu-mitrovicu-vise-od-200-kurtijevih-naoruzanih-specijalaca-rasporedjeno-po-obodu-grada-bacene-i-dve-sok-bombe>

republika.rs,²²² kurir.rs.²²³

Ishte interesante edhe fakti që portali KosovoOnline²²⁴ i hoqi pjesët që ishin të rrejshme nga lajmi i publikuar shumë pak kohë pas publikimit, mirëpo mediat e tjera që e kishin ripublikuar lajmin fillestar ashtu siç ishte, nuk i kishin përmirësuar artikujt e tyre. Në total, 23 media kishin pretenduar në mënyrë të rrejshme që njësitë speciale²²⁵ ishin vendosur përreth rrugës dhe e kishin bllokuar qasjen për të shkuar në veri dhe për tu kthyer nga veriu. Atë mbrëmje një ekip i Policisë së Kosovës ishte sulmuar me armë zjarri në afërsi të Zveçanit dhe një polic ishte plagosur. Pas incidenteve me armë, Policia vendosi njësi të specializuara në këtë zonë.

Pas dy ditësh, Goran Rakiq, udhëheqësi i Listës Serbe, partisë kryesore serbe në Kosovë, publikoi një deklaratë në Facebook me pretendimin që kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, do të dërgonte forcat e armatosura në veri për të përndjekur serbët e Kosovës për të ndërmarrë aksionin “Stuhia”.²²⁶ Verifikuesi i fakteve që realizohet nga BIRN, Krypometër, e klasifikoi këtë si një lajm të rrejshëm, ngase askush nuk e kishte konfirmuar ekzistencën e një plani të tillë.

Megjithatë, paniku në mes të njerzëve u shpërnda ngase u postuan foto të zbarkimit të njësiteve speciale të Policisë në këtë zonë. Mediat në gjuhën serbe, raportuan që pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK, të veshur me uniforma të Policisë së Kosovës, ishin stacionuar tashmë nëpër veri. Portalet në gjuhën shqipe në Kosovë publikuan foto të zyrtarëve të armatosur policorë në veri dhe i portretizuan ata si çlirimtarë. Policia e Kosovës u detyrua t’ua ndalojë personelit të Policisë realizimin e fotove të vendit në këtë zonë për shkak të keqintrepretimeve që po u bëheshin atyre nga të dyja palët.²²⁷

Në ndërkohë, mediat në gjuhën shqipe raportuan pasaktësisht për operacione dhe arrestime të njerzëve në veri. Për shembull, më 8 dhjetor 2022, pati raportime se një person ishte arrestuar për sulm ndaj pjesëtarëve të Policisë, mirëpo, në fakt personi ishte arrestuar

²²² “VIDEO E PARE E INVADIMIT NE VERI TE KOSOVES ESHTË SHFAUR: Forcat speciale ROSU marshuan ne Mitrovicë dhe e bllokuan atë - ata u pozicionuan nëpër qytet (VIDEO) (POJAVIO SE PRVI SNIMAK UPADA NA SEVER KOSOVA: Specijalci ROSU umarširali u Mitrovicu i blokiral je - postavili se i po obodu grada (VIDEO))”, republika.rs, 8 dhjetor 2022, <https://www.republika.rs/vesti/politika/400339/prvi-snimak-upada-rosu-u-severnu-mitrovicu>

²²³ “TERRORI KUNDER SERVE: Policia e Kurtit bastis Mitrovicën e Veriut, u hodhën dy shok bomba n (TEROR NAD SRBIMA: Kurtijeva policija upala u Severnu Mitrovicu, bačene 2 šok bombe)”, kurir.rs, 8 dhjetor 2022, <https://www.kurir.rs/vesti/politika/4066640/pocela-drama-na-kosmetu-stotine-kurtijevih-specijalaca-uslo-u-severnu-mitrovicu>

²²⁴ “Zyrtarët policor bllokuan Mitrovicën e Veriut, nuk ka incidente por ka tensione” (Kosovski policajci blokiral Severnu Mitrovicu, nema incidenata ali napeto)”, kosovo-online.com, 8 dhjetor 2022, <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/kosovski-policajci-blokiral-severnu-mitrovicu-nema-incidenata-ali-napeto-9-12-2022>

²²⁵ “Rrena për bllokimin e Mitrovicës së Veriut nga Njësia Speciale”, Kallxo (Krypometer), 8 dhjetor 2022 <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-blokimin-e-mitrovices-se-veriut-nga-njesia-speciale/>

²²⁶ “Paralajmërimi i rremë i Goran Rakiqit për operacionin ‘Oluja’”, Kallxo (Krypometer), 16 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/paralajmerimi-i-rreme-i-goran-rakiqit-per-operacionin-oluja/>

²²⁷ “Koloneli Gazmend Hoxha: Policët janë udhëzuar që të mos publikojnë fotografi nga veriu”, Kallxo, 21 dhjetor 2022 <https://kallxo.com/lajm/koloneli-gazmend-hoxha-policet-jane-udhезuar-qe-te-mos-publikojne-fotografi-nga-veriu/>

për një sulm që kishte ndodhur në vitin 2022.²²⁸

Në këtë kohë, Dejan Pantiq, ish pjesëtar i Policisë së Kosovës, u arrestua nën dyshimin se ishte i përfshirë në sulmin ndaj zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KQZ, në Mitrovicë të Veriut. Arrestimi i tij rezultoi me dezinformata, të cilat u diskutuan më herët në këtë raport, brenda kapitullit mbi ndikimin e narrativave kundër NATO-s.

Dhjetëra media, duke përfshirë tabloidët serb dhe mediat pro-qeveritare atje, pretenduan që “Okupimi i veriut të Kosovës dhe Metohisë ka filluar: Kurti ka dërguar mbi 300 forca speciale në veri; Beogradi ka përgjigjen”.²²⁹ Përgjigja ndaj një narrative të tillë ishte kërkesa e Vuçiqit për të dërguar personelin serb të sigurisë në Kosovë.²³⁰

Në një moment, Policia e Kosovës sa ishte në një postbllok dyshohet se ishte detyruar të qëllonte për shkak se automjeti i tyre ishte qëlluar nga dikush së pari, mediat pro-qeveritare serbe e cilësuan incidentin si «terror i Kurtit»²³¹. Mediat i portretizuan menjëherë personat e plagosur si heronj të plagosur, e që u vizituan nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Mbrojtjes së Serbisë.²³²

Edhe më shumë raportime të rrejshme pasuan nëpër media. Artikulli i rrejshëm se Kurti kishte vizituar barrikatat në veri u publikua në portalin online të RTK-së, transmetuesit publik, si dhe në media të tjera.²³³ “Kurti nuk tërhiqet, njësitë e tjera i drejtohen veriut” ishte edhe një burim tjetër i dezinformimit. Një narrative tjetër që synonte të shktaktojë panikë ishte edhe raportimi i rrejshëm që qytetarët shqiptarë po sulmoheshin kur po kalonin nëpër Serbi.²³⁴ Gjatë tensioneve në veri, një media në gjuhën shqipe kishte përhapur lajmin që një bashkëatdhetar ishte sulmuar në Serbi. Lajmi i publikuar më 13 dhjetor 2022, ishte

²²⁸ “Rrena për arrestimin e personit që sulmoi policinë mbrëmjen e 8 dhjetorit 2022”, Kallxo (Krypometer), 9 dhjetor 2022 <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-arrestimin-e-personit-qe-sulmoi-policine-mbremjen-e-8-dhjetorit-2022/>

²²⁹ Okupimi i veriut të Kosovës dhe Metohisë ka filluar: Kurti ka dërguar mbi 300 forca speciale në veri; Beogradi ka përgjigjen (POČELA OKUPACIJA SEVERA KOSOVA I METOHIJE: Kurti poslao više od 300 specijalaca na sever; Beograd ima odgovor), Novosti, 8 dhjetor 2023, <https://www.novosti.rs/vesti/politika/1180558/pocela-okupacija-severa-kosova-metohije-kurti-poslao-izmed-ju-200-300-specijalaca-sever>.

²³⁰ “Në ditën e gjashtë të barrikadave në veri, serbët nuk tërhiqen nga kërkesat e tyre (Šesti dan barikada na severu, Srbi ne odustaju od svojih zahteva)”, kosovo-online.com, 15 dhjetor 2022, <https://www.kosovo-online.com/vesti/drustvo/sesti-dan-barikada-na-severu-srbi-ne-odustaju-od-svojih-zahteva-15-12-2022>.

²³¹ “Serbët nuk mund ta durojnë terrorin e Kurtit më (Srbi ne mogu vise da trpe Kurtijev Terror”, ATV BL, 7 nëntor 2022 <https://www.atvbl.rs/vijesti/srbija/srbi-ne-mogu-vise-da-trpe-kurtijev-terror-nece-albanska-cizma-da-kroci-na-sjever-7-11-2022>

²³² Kjo kontekstualizohet sikur serbët e pafajshëm po arrestohen <https://www.telegraf.rs/vesti/politika/3620245-vucevic-obisao-ran-jenog-miljana-dhe> <https://www.google.com/url?q=https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/rosu-specijalci-rafalima-pot-puno-unistili-automobil-u-kome-je-bio-miljan-delevic-23&sa=D&source=docs&ust=1684088324631518&usg=AOvVaw1jc2OWFoN-BxYYoWDVvirqK>

²³³ “Rrena se Albin Kurti ishte në veri”, Kallxo (Krypometer), 11 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-albin-kurti-ishte-ne-veri/>

²³⁴ “Rrena se Kurti ka deklaruar: “Do ta shohin serbët””, Kallxo (Krypometer), 17 dhjetor 2022 <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-kurti-ka-deklaruar-do-ta-shohin-serbet/>

i rrejshëm sepse ky rast kishte ndodhur para dy vitesh dhe nuk kishte të bëjë asgjë me ngjarjet e momentit në veri.²³⁵ Edhe politikanët kishin rënë viktimë e këtij lajmi të rrejshëm.

Vlora Çitaku, ish ambasadorja e Kosovës në ShBA, e kishte pranuar që ka rënë pre e dezinformimit kur kishte postuar në Twitter që një autobus që po transportonte udhëtarë shqiptarë ishte sulmuar në Serbi.²³⁶

Një lajm tjetër i rremë i shpërndarë në Facebook pretendoi rrejshëm se Shqipëria po dërgonte 500 policë në Kosovë. Ky lajm u ndërtua mbi një narrativë të mëparshme të rreme se Shqipëria po ndihmonte Kosovën duke dërguar trupa të sigurisë në kohën kur tensionet ndëretnike ishin të larta në veri të Kosovës. Policia e Kosovës e demantoi këtë lajm, i cili kishte marrë 78 reagime në Facebook. Më 26 dhjetor 2022, dezinformata se Kosova e ka rritur buxhetin për ushtrinë nga 60 milionë sa ishte në 300 milionë euro ishte publikuar në Facebook. Faqja pretendonte se Albin Kurti e katërfishoi buxhetin vetëm në dy vite qeverisje. Buxheti aktual i dedikuar për ushtrinë është 123 milionë euro.

Më 29 nëntor 2022, faqja Fakte.buzz²³⁷ kishte publikuar lajmin e rrejshëm se “ishte ngritur alarmi” në Beograd sepse kandidati i partisë së Kurtit ishte gati duke i fituar zgjedhjet në veri. Nuk kishte fakte për të mbështetur gjetjet e publikuara. Në Beograd nuk është ngritur asnjë alarm lidhur me shpalljen e kandidatit të Vetëvendosjes për kryetar të Mitrovicës së Veriut. Gjithashtu, asnjë sondazh nuk kishte treguar se kandidati do të fitonte zgjedhjet nëse ato do të mbaheshin më 18 dhjetor 2022.²³⁸

Një artikull tjetër i botuar më 16 janar 2023 me titullin: “Kurti shkon sërish drejt veriut. Ai merr vendim për...” ndërsa artikulli fliste për vendimin e qeverisë së Kosovës për shpalljen e disa pronave publike në Leposaviq si zona me interes të veçantë, mirëpo imazhet e përdorura përfshinin makina ushtarake, duke krijuar perceptimin se Kurti hyri në veri të Kosovës duke përdorur forcat ushtarake. Ky lajm ishte shpërndarë në gjashtë platforma.

Në Kosovë, ka pasur situata të tjera kur ngjarjet e zakonshme e normale janë shndërruar në tensione ndëretnike. Shembull i kësaj është një operacion i Doganës së Kosovës në një fabrikë pijesh alkoolike në fshatin Hoçë e Madhe, e që u raportua si një sulm ndaj serbëve vendas të Kosovës. Mediat në gjuhën serbe kanë raportuar se operacioni është kryer për shkak të logos së kompanisë e cila ishte në gjuhën serbe.²³⁹ Dogana ka konfirmuar që ky aksion ishte kryer për shkak që kompania në fjalë po prodhonte alkohol pa pasur licencë.

²³⁵ “Rrena se mërgimtari pesoi incidenti në Serbi”, Kallxo (Krypometer), 12 mars 2023, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-mergimtari-pesoi-incident-ne-serbi/>


²³⁶ “Citaku kerkoj falje per lajmin e rrejshem”, GazetaBlic, 12 mars 2017, <https://gazetablic.com/citaku-kerkoj-falje-per-lajmin-e-rrejshem/>

²³⁷ “Titulli i rremë së në Beograd është “ngritur alarm” për zgjedhjet në Mitrovicë të veriut”, Kallxo (Krypometer), 17 dhjetor 2022 <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-se-ne-beograd-eshte-ngritur-alarm-per-zgjedhjet-ne-mitrovice-te-veriut>

²³⁸ Po aty.

²³⁹ “Rrena për arsyen e sekuestrimit të verërave nga Dogana” Kallxo (Krypometer), 8 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-arsyen-e-sekuestrimit-te-vererave-nga-dogana/>

Figura 21: Ndikimi i narrativave rreth konflikteve ndërkombëtare



Tensionet ndëretnike kanë arritur të ndikojnë në sport. Shembull i kësaj është Zana Avdiu, një analiste shqiptare e cila e kishte kritikuar gjestin e Granit Gjakës si të papërshtatshëm, gjatë një loje të futbollit në mes të Zvicrës dhe Serbisë gjatë Kampionatit Botëror të Futbollit në vitin 2022. Janë gjetur 1,809 postime të publikuara me rreth 90,000 ndërveprime rreth kësaj teme. Në rreth 12% të këtyre postimeve u shfaqën tensione ndëretnike. Disa pretenduan që Avdiu “i kënaq zemrat e serbëve”,²⁴⁰ që ajo po “i mbronte serbët”,²⁴¹ dhe që ajo “paguhet për ta bërë këtë dhe nuk ka gjak shqiptari”.²⁴² Artikulli më viral e që ishte postuar mbi 150 herë dhe kishte marrë mbi 6,000 ndërveprime, tha që “Serbët e ftuan Avdiun që të kërkojë azil në Serbi”²⁴³. Asnjë nga këto pretendime nuk ishin të bazuara në fakte.

2.2 Narrativat e bazuara në etni dhe dezinformatat rreth profileve publike

Përveç raportimit dhe shpeshherë ekzagjerimit të incidenteve në veri, dezinformatat e bazuara në çështje ndëretnike janë përdorur për të sulmuar kundërshtarët politikë dhe për të etiketuar politikanët si tradhtarë apo si bashkëpunëtorë.

Megjithatë, përveç narrativave konkurruese mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, ekzistonte edhe një narrativë tjetër brenda komunitetit shqiptar të Kosovës se Albin Kurti

²⁴⁰ “Zana ia kënaq zemren serbeve”, Botapress, Facebook post, 6 dhjetor, 2022, <https://www.facebook.com/614052055328965/posts/5880234742043977>

²⁴¹ “E turpshme! Po mbron serbët! Quajti rrugaç Granit Xhakën, babai i futbollistit reagon ashpër ndaj analistes shqiptare”, Info Shqip, post në Facebook, 5 dhjetor 2022 <https://www.facebook.com/351528495625050/posts/1312587529519137>

²⁴² “Nuk paske gjak shqiptari ti, kush t’ka pagu me dal aty”. Reagon ashpër Taulant Xhaka ndaj Zana Avdiut”, Kosova Jon, postim në Facebook, 6 dhjetor 2022,

²⁴³ “Serbët i bëjnë thirrje Zana Avdiut: Ejani kërkoni azil në Serbi – pas deklaratës së babait të Granit Xhakës”, Kosova ime, postim në Facebook, 6 dhjetor 2022 <https://www.facebook.com/100044244768698/posts/703209814497171> dhe <https://www.facebook.com/112451600665267/posts/649893073587781>

dhe Vetëvendosje ishin ‘tradhtarë’ për përkrahjen e politikës thelbësore kundër së cilës ata luftuan më së shumti, kundër Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Titujt përfshinin: “Kurti ka rënë në grackën e Serbisë”^{244,245} (10 postime dhe 576 ndëveprime),²⁴⁶ “Kurti po e legjitimizon ndarjen e veriut”, si dhe duke theksuar që “Qeveria e Kurtit po i dëmton marrëdhëniet me aleatët ndërkombëtar”.²⁴⁷

Mediat në gjuhën shqipe e portretizuan Kurtin si një njeri që ndryshoi qëndrimin e tij në lidhje me Asociacionin (kundër të cilit ai kishte protestuar fuqishëm më parë si lider i opozitës). Mediat serbe, në anën tjetër, e portretizuan Kurtin si një njeri që dëshiron luftë me Serbinë.²⁴⁸

Në nëntor të vitit 2022, Aleksandër Vulin, udhëheqësi i Agjencisë së Inteligjencës së Sigurisë në Serbi, publikoi një deklaratë duke thënë se Albin Kurti, gjatë kohës sa ishte në burg, gjatë luftës së vitit 1999 në Kosovë, kishte zbuluar emra të anëtarëve të UÇK-së. Ai e quajti kryeministrin Kurti një “gënjeshtar dhe njeri të dobët, i cili derisa ishte në burg në Serbi kishte treguar gjithçka që dinte për bashkëpunëtorët e tij dhe UÇK-në”. Ky mesazh ishte ripublikuar nga 20 media kosovare dhe ka marrë mbi 9,500 ndëveprime. Ky lajm më vonë u shndërrua në një narrativë se si Kurti kishte dëshmuar në Serbi kundër UÇK-së. Kurti nuk ka qenë dëshmitar në asnjë procedurë kundër UÇK-së në Hagë apo në Serbi.

Një tjetër narrativë në Beograd e kishte shpallur Presidentin e Serbisë përgjegjës për lirimin e të burgosurve të luftës nga Kosova, përfshirë Albin Kurtin, sepse ai kishte qenë pjesë e këtij procesi vendimmarrës pas vitit 2000.²⁴⁹

Një tjetër narrativë kishte synuar që ta tregonte kryeministrin Kurti si një bashkëpunëtor të Serbisë. Dy media kosovare kanë publikuar një fotografi të kryeministrit Kurti me ministrin

²⁴⁴ Ka rreth 40 postime që thonë se “Kurti ra në kurthin e Serbisë” në tremujorin e fundit të 2022, duke përfshirë: “Nurellari, PDK: Kurti ka rënë në grackën e Vuçiqit”, Zëri, 7/11/23 <https://zeri.info/aktuale/469164/nurellari-pdk-kurti-ka-rene-ne-gracken-e-vuciqit/?fbclid=IwAR2ZCtNVcg0Lo42Xer9AZPxPwNRJE5e2-F-LkKtfoSHbwqvgbotlviOF1V0>

²⁴⁵ “Abdixhiku: Albin Kurti ka rënë në grackën e Serbisë, s’po mund të ushtrojë sovranitet në veri”, *demokracia.com*, 19 dhjetor 2022, <https://demokracia.com/abdixhiku-albin-kurti-ka-rene-ne-gracken-e-serbise-spo-mund-te-ushtroje-sovranitet-ne-veri/?fbclid=IwAR1XLlxPBoN3puNEHPT5jfM-jR3UkZlHPrH74AA3AWeK3-Qbw00oAmINStc>

²⁴⁶ Të dhënat nga Crowdtange, të qasshme në: <https://apps.crowdtangle.com/search?platform=facebook&postTypes=&producerTypes=3&q=%22Kurti%20ka%20r%C3%ABn%C3%AB%20n%C3%AB%20grack%C3%ABn%20e%20Serbis%C3%AB%22&sortBy=score&sortOrder=desc&timeframe=1year>

²⁴⁷ “Edhe një “jo” e Kurtit ndaj kërkesave të SHBA-së”, *Radio Evropa e lirë*, 21 tetor 2022, <https://www.evropaelire.org/a/raportet-kurti-shba-be-/32109343.html>

²⁴⁸ “Kurti po kërkon luftë me Serbinë” (Kurti bas trazi rat sa Srbijom), *tabloidi serb Informer*, 28 tetor 2022 <https://informer.rs/vesti/politika/730522/aljbin-kurti-tablice-kim>, “Kurti dëshiron luftë” (Kurti Zeli rat” *Happy TV*, 24 mars 2022, https://www.facebook.com/tvhappy/posts/5217130681671842/?locale=hr_HR&paipv=0&eav=AfZ9OAVjp4vA68qKU3RNmbaO_zFQqOTwKVkanqeB9YQSkZtlfJcmt-KGS4Gpsn9XM8Y&_rdr

²⁴⁹ Posterat që u shfaqën në mars 2023 tregonin udhëheqësit e Dverit, NDSS dhe Pokret – Bosko Obradović, Milos Jovanović dhe Milica Gjurđević Stamenkovski – të veshur me plisa tradicionale shqiptare e që qëndronin pas Kurtit dhe u akuzuan si këshilltarë të Kurtit, duke i vënë ata në kontekstin si tradhtarë. Ata e akuzuar Vuçiqin si personi që qëndron pas këtyre posterave. “Deklarata e DefMin-it për postera fyes provokon reagimin e opozitës N1 Beograd, 14 mars 2023, <https://n1info.rs/english/news/defmin-statement-on-offensive-posters-provokes-opposition-reaction/>

Nenad Rashiq, duke thënë “FALEMINDERIT O VLLA ALBIN QE MA LEJOVE PATRIARKUN ARTEMIJE ME VIZITU KOSOVEN! I YTI NENADI!”.²⁵⁰ Ky ishte një mesazh i rrejshëm, ngase Rashiqi nuk e ka thënë këtë asnjëherë, mirëpo, ky postim ka marrë 313 ndërveprime në rrjete sociale. Një publikim tjetër e ka portretizuar Kurtin si përkrahës të Kishës Ortodokse Serbe.

Një artikull në mars rreth Patriarkut Serb Porfirije, që titullohet “Trimërohet Porfirije, pasi Kurti po e fuqizon Kishën Ortodokse Serbe”.²⁵¹ Ky lajm është publikuar pas një deklaratë të kreut të Kishës Ortodokse Serbe se “askush nuk mund të përzihet në punët e kishës dhe se Kosova është zemra e Serbisë”. Porfirije në deklaratën e tij nuk e ka përmendur Kurtin fare, por mediat pa fakte e kanë konstatuar se kjo deklaratë ka ardhur si rezultat i negociatave të Kurtit në Bruksel.

Një tjetër mjet për përhapjen e dezinformatave ishte etiketimi i rrejshëm i politikanëve dhe influencuesve si miq ose bashkëpunëtorë të njerëzve në Serbi. Një imazh i i edituar në fotoshop i kryeministrit Kurti duke u përqafuar me presidentin Aleksandar Vuçiq është shpërndarë në të paktën 23 profile në rrjetet sociale me mbishkrimin “O vëllezër, ju thamë se kjo foto do të dalë dikur”. Kjo fotografi është identifikuar si e rrejshme nga verifikuesit e fakteve.²⁵² E njëjta teknikë është përdorur edhe për të sulmuar anëtarët e opozitës. Ish kryeministri Behgjet Pacolli ishte sulmuar në muajin maj përmes një kampanje të rrejshme që po përdorte një fotografi të edituar të një takimi të supozuar me Presidentin Aleksandar Vuçiq²⁵³ në një jaht në Budvë të Malit të Zi. Në të vërtetë, Pacolli ishte fotografuar në një jaht, por me Millan Radoiçiqin, dhe kjo fotografi ishte publikuar nga KRIK.

Lajmet e sajura për marrëdhënie të mira me politikanët serbë u përdorën edhe për të sulmuar analistët politikë. Dardan Gashi, analist politik, është sulmuar përmes një fushatë që ka deformuar deklaratën e tij në TV Dukagjini. Gashi kishte thënë se ministri Rashiq ishte shok i tij; megjithatë, një faqe në Facebook e shtrembëroi deklaratën e tij për të thënë “Rashiq është miku im”. Shtrembërimi i mbiemrit nga Rashiq në Rashiq e bëri Gashin si mik të Listës Sprska, kur në fakt ai kishte thënë se ishte mik i liderit të opozitës së kësaj partie. Postimi, i cili mori mbi 800 ndërveprime në Facebook,²⁵⁴ ishte identifikuar nga Krypometri si i rrejshëm.²⁵⁵

Dy dezinformata tjera janë se Albin Kurti po planifikon që të japë dorëheqje për shkak të marrëdhënieve me Serbinë dhe dezinformimi se Aleksandar Vuçiq do jap dorëheqje për shkak të dialogut me Kosovën. Janë botuar rreth 66 artikuj me mbi 3,500 ndërveprime me titullin “Albin Kurti po e përgatit dorëheqjen e tij”. Kjo përmbajtje ishte bazuar në deklaratet e tre analistëve

²⁵⁰ “Rena për një deklaram të ministrit Nenad Rashiq”, Kallxo (Krypometer), 13 janar 2023, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-nje-deklarim-te-ministrit-nenad-rashiq/>

²⁵¹ “Rena se Porfirije trimërohet pas propozimit të BE-së për marrëveshjes Kosovë- Serbi”, Kallxo (Krypometer), 16 mars 2023, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-porfirije-trimerohet-pas-propozimit-te-be-se-per-marreveshjes-kosove-serbi/>

²⁵² “Fotografia e modifikuar e Albin Kurtit me Aleksandar Vuçiq”, Kallxo (Krypometer), 3 janar 2023, <https://kallxo.com/krypometer/fotografia-e-modifikuar-e-albin-kurtit-me-aleksandar-vuciq/>

²⁵³ “Rena se në takimin e Pacollit me krerët e Listës Serbe ishte edhe Vuciqi”, Kallxo (Krypometer), 8 maj 2023, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-ne-takimin-e-pacollit-me-kreret-e-listes-serbe-ishte-edhe-vuciqi/>

²⁵⁴ https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid0366aukSUfFNJDwjfev8YXWEwUj7sE1AAfG8zjd7vvSX71PV24o6ivzrZfMsdWoZX-3l&id=100084762834687&mibextid=Nif5oz

²⁵⁵ “Rena rreth një deklarimi të Dardan Gashit”, Kallxo (Krypometer), 12 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-rreth-nje-deklarimi-te-dardan-gashit/>

vendorë: Ridvan Berisha,²⁵⁶ Milaim Zeka,²⁵⁷ si dhe Baton Haxhiu,²⁵⁸ që kishte thënë se Kurti e ka dorëzuar dorëheqjen në udhëheqësinë e partisë së tij. Ky informacion nuk ishte konfirmuar asnjëherë, ndërsa ishte mohuar nga qeveria e Kosovës. Një rast i ngjashëm kishte qenë edhe me Aleksandar Vuçiqin, se kinse ai kishte dhënë dorëheqje për shkak të proceseve me Kosovën. Së paku gjashtë artikuj ishin publikuar me këtë përmbajtje.²⁵⁹

Një rast tjetër dezinformimi ka ndodhur pas një raundi bisedimesh në Bruksel në nëntor të vitit 2022. Rreth 37 media të Kosovës e kanë publikuar lajmin: Kurti nga Berlioni: Nuk do të ketë komuna serbe në Kosovë.²⁶⁰

Kjo kishte marrë 6,533 ndëreveprime në rrjete sociale.²⁶¹ I njëjti lajm ishte publikuar me titullin “Albin Kurti ‘mund’ Vuçiqin nga Berlioni: Nuk do të ketë komuna serbe në Kosovë,”²⁶² e që ka marrë 423 reagime në dy faqe të tjera.²⁶³

Këta tituj nuk e përçojnë atë që ka thënë Albin Kurti, kryeministri i Kosovës, me të vërtetë. Kurti kishte thënë se në Kosovë nuk ka komuna tërësisht serbe apo tërësisht shqiptare, por ka komuna me shumicë serbe apo shumicë shqiptare. Kështu, shpjegimi i Kurtit se nuk do të ketë komuna vetëm serbe apo shqiptare ishte keqinterpretuar.²⁶⁴

Figura 21: Shembuj të narrativave më përçarëse në Kosovë



²⁵⁶ “Ridvan Berisha: Kurti e ka përgatitur letrën e dorëheqjes, kam informacione për këtë”, *GazetaBlic*, 28 janar 2023, <https://gazetablic.com/ridvan-berisha-kurti-e-ka-pergatitur-letren-e-doreheqjes-kam-informacione-per-kete>

²⁵⁷ “Milaim Zeka: Kurrë s’kemi qenë më afër dorëheqjes së Albin Kurtit”, *Lajmi.net*, 5 maj 2023, <https://lajmi.net/milaim-zeka-kurre-ske-mi-qene-me-afere-doreheqjes-se-albin-kurtit/>

²⁵⁸ “Baton Haxhiu: Kurti ka qenë i gatshëm të jep dorëheqje vetëm të mos formohet Asociacioni”, *Nacionale*, shkurt 2023, <https://nacionale.com/politike/baton-haxhiu-kurti-ka-qene-i-gatshem-te-jep-doreheqje-vetem-te-mos-formohet-asociacioni>

²⁵⁹ “Titulli i rremë se Aleksandar Vuçiq ka dhënë dorëheqje”, *Kallxo (Krypometer)*, 29 janar 2023, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-se-aleksandar-vuciq-ka-dhene-doreheqje/>

²⁶⁰ “Kurti nga Berlioni: Nuk do të ketë komuna serbe në Kosovë” *Veriu.Info*, Facebook post, 3 nëntor 2022, <https://www.facebook.com/327128460749009/posts/5616427075152428>

²⁶¹ Të dhëna të nxjerra nga *CrowdTangle*, një mjet publik për të dhëna që mbahet nga Facebook.

²⁶² Hani i Elezit si Paris, Facebook post, November 23, 2022, <https://www.facebook.com/386384411468880/posts/5525298864244050>

²⁶³ Po aty.

²⁶⁴ Në të njëjtën deklaratë, Kurti kishte shtuar që: “Pra edhe në Serbi ekzistojnë bashkësi të tilla. A është Serbia e gatshme të ketë bashkësi të komunave me shumicë hungareze, rumune boshnjake apo myslimane në Sanxhak, e Shqiptare në Luginë të Preshevës? Nuk mund ta kërkojë të tjetri atë që ti nuk je në gjendje ta bësh në shtëpinë tënde.»

Kjo narrativë që Kosova dhe Perëndimi janë duke kërkuar që të dëbojnë qytetarët serbë nga veriu i vendit, është raportuar rregullisht nga mediat në gjuhën serbe.²⁶⁵

Nuk është vetëm Kurti i vetmi që portretizohet si “tradhëtar” i kauzës që kishte shtyrë kundër Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Një narrativë e ngjashme përdoret edhe kundër figurave publike të Kosovës (politikanë, analistë televiziv, influencers). Kjo narrativë i quan këto figura dhe biznesmenët shqiptarë të Kosovës që bëjnë tregti me Serbinë si bashkëpunëtorë dhe profiterë të bashkëpunimit me Serbinë.²⁶⁶

Kështu, sa herë që ka tensione në veri, zhvillohet një fushatë e re e që inkurajon qytetarët që të bojkotojnë dyqanet që shesin produkte serbe si dhe që të bojkotojnë kompanitë që importojnë mallra të prodhuara në Serbi.²⁶⁷

Vetëvendosje, partia që aktualisht udhëheq qeverinë e Kosovës ka ndihmuar në kultivimin e kësaj narrative. Ajo ka organizuar një fushatë për të rrëzuar kamionët që transportin mallra nga Serbia menjëherë pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 dhe më vonë. E për më shumë se një dekadë, armiqësia ekonomike me Serbinë ka qenë pjesë e fushatës së Vetëvendosjes. Megjithatë, në vitin e dytë të Vetëvendosjes si parti në pushtet, Kosova ka shënuar jo ulje por rritje të importeve nga Serbia.²⁶⁸

Ka edhe një narrativë që zhvillohet në vazhdimësi kundër marrëveshjes së arritur me Serbinë dhe integritet të serbëve të Kosovës në institucionet që kanë dalur si rezultat i këtyre marrëveshjeve.

I gjithë debati pas Marrëveshjes së Ohrit ishte drejtuar kundër Kurtit, me ç’rast ai ishte akuzuar se i ka “shitur shpirtin djallit” me nënshkrimin e marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, ngase kur kishte qenë në opozitë kishte qenë fuqishëm kundër kësaj marrëveshjeje. Megjithatë, institucionet e Kosovës prodhojnë narrativat e tyre për të dëshmuar se nuk ia kanë “shitur shpirtin djallit”, duke qëndruar pas kapitalit social dhe politik për të cilin kanë investuar që të jenë në gjendje që të dëshmojnë se ata janë negociatorë më autentikë në mesin e shqiptarëve të Kosovës se sa qeveritë e mëparshme.

Shembujt tregojnë se mediat në Kosovë shpeshherë kanë publikuar lajme me një narrativë

²⁶⁵ “Kurti dëshiron të varrosë serbët në Kosovë dhe Metohi (Kurti Zlo Hoće da Satre Srbe na Kosovu i Metohiji)” Republika, 16 dhjetor 2022 <https://www.republika.rs/vesti/tema-dana/393365/kurti-zlo-hoce-da-satre-srbe-na-kosovu-i-metohiji>

²⁶⁶ Ia vlen të theksohet që tregtia ndodh kryesisht në një drejtim. Kosova importon mallra nga Serbia, ndërsa gati se asnjë mall kosovar nuk eksportohet ndonjëherë në Serbi.

²⁶⁷ Këto fushata shkojnë deri në masën që njerëzit inkurajohen edhe të mos pinë Coca Cola pasi Coca Cola që shitet në Kosovë prodhohet në një fabrikë të Coca Colas në Serbi. Supermarketet inkurajohen të marrin Coca Cola-n në shishe të prodhuara në Bullgari etj.

²⁶⁸ Sipas të të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, importet nga Serbia kanë qenë EUR 174, 029 mil në vitin 2020, EUR 306, 354 mil në vitin 2021 dhe EUR 348, 096 mil në vitin 2022. Të dhënat e qasshme në: https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata__External%20trade__Monthly%20indicators/07_imp_country.px/table/tableViewLayout1/ and <https://askapi.rks-gov.net/Custom/a9ea2573-d8f0-4045-ad23-c982665146fa.pdf>

të ngjashme bardh e zi, me dy nën-narrativa dominuese se si veprimet e autoriteteve të Kosovës, përfshirë ato ndaj serbëve të Kosovës, janë tërësisht të drejta dhe fer; e në anën tjetër, sikur ka vetëm tendenca negative në lokacionet me shumicë serbe dhe në Serbi në përgjithësi. Ndonëse edhe mediat shqiptare të Kosovës publikojnë artikuj kritikë ndaj Kurtit,²⁶⁹ tabloidet serbe janë edhe më të prirura për të zhvilluar propagandë. Këtë çështje e kemi analizuar në vijim. Narrativat dezinformuese janë përpjekur që ta paraqesin kryeministrin Albin Kurti si një person antiamerikan. Dezinformatat për marrëdhëniet e Kurtit me SHBA-në janë publikuar vazhdimisht gjatë viteve të fundit, përfshirë edhe nëntorin e vitit 2021, kur pretendohet se Kurti i ishte refuzuar viza amerikane.²⁷⁰ Kjo dezinformatë ishte shpërndarë në Serbi nga Telegraf²⁷¹, Blic²⁷², b92²⁷³, si dhe ishte ripublikuar 22 herë në mediat shqipfolëse.

Një narrativë tjetër në diskursin publik ka qenë edhe mungesa e marrëdhënieve të mira të Kurtit me SHBA-në e që kishte ndikim negativ në qëndrimin e SHBA-së ndaj Kosovës. Ky rrëfim i ka rrënjët në rënien e qeverisë së parë të Kurtit që kishte ndodhur gjatë periudhës së pandemisë, e cila i atribuohet kërkesave që Richard Grenell, përfaqësuesi i atëhershëm për Ballkanin Perëndimor nga administrata e Trump, i kishte bërë LDK-së, partnerit të koalicionit të VV-së atëbotë. Ai kishte kërkuar nga LDK-ja që ta rrëzojë qeverinë e Kurtit me pretekstin që ai nuk po dorëzohej për nënshkrimin e një marrëveshjeje që Trump donte që të nënshkruhej në mes të Kosovës dhe Serbisë.²⁷⁴

Gjatë gjithsecilës krizë, kjo temë ringjallet në diskutimet nëpër studiot televizive si dhe në postimet në media sociale. Gjatë periudhës 15 tetor 2022 deri me 30 prill 2023, në Facebook janë bërë 189 postime që kanë marrë 8,000 ndërveprime në të cilat kryeministri Kurti është

²⁶⁹ Në Kosovë nuk ka të gazeta të përditshme apo tabloide të shtypura e që është rezultat i kostove të larta. Çuditërisht, kjo ka kontribuar për ta bërë më të vështirë përhapjen e dezinformatave pasi masa të tëra njerëzish nuk mund të lahen truri përmes tabloideve. Në sferën online, ka më shumë larshmëri, diversitet dhe nuk ka një monopol ku vetëm disa gazeta që janë mjaftueshëm të fuqishme ekonomikisht për të mbështetur shtypjen e gazetës të mund të kontrollojnë narrativat. Megjithatë, edhe nëse mund të argumentohet se tani është më e lehtë pasi që gjithçka që duhet është një faqe interneti ose faqe në media sociale, tani ka më shumë konkurrencë. Një tjetër element kyç që e bën median të jetë më pak nën kontrollin e njerëzve në pushtet është fakti se në vitin 2020, qeveria e kishte ndaluar shpërndarjen e reklamave për mediat, një praktikë që në të kaluarën kishte siguruar që kritikët e qeverisë do të sulmoheshin nga tabloidët dhe portalet online e që po merrnin reklama qeveritare. <https://prishtinainsight.com/kosovo-telecom-pays-out-politicians-cash-in-mag/>. I vetmi medium që financohet nga buxheti publik është Radio Televizioni i Kosovës (RTK).

²⁷⁰ "Kryeministri Kurti i refuzohet viza për ShBA", KosovaPost, 3 nëntor 2021 <https://kosovapost.net/kryeministrit-kurti-i-refuzohet-viza-per-shba/>

²⁷¹ "Albin Kurti nuk i është dhënë viza për ta vizituar ShBA-në (Albinu Kurti nje odobrena viza za posetu SAD)", Telegraf.rs, 3 nëntor 2021, <https://www.telegraf.rs/vesti/politika/3413649-albinu-kurti-nije-odobrena-viza-za-posetu-sad>

²⁷² "Kurti nuk i është dhënë viza për ta vizituar ShBA-në (Kurti nje odobrena viza za posetu SAD)", Blic.rs, 3 nëntor 2021, <https://www.blic.rs/vesti/politika/nista-od-puta-za-ameriku-kurti-nije-odobrena-viza-za-posetu-sad/vy693ys>

²⁷³ "Amerikanët e refuzojnë Kurtin (Amerikanci odbili Kurtija)", b92.net, 3 nëntor 2021, https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2021&mm=11&dd=03&nav_category=640&nav_id=2050758

²⁷⁴ Kjo fushatë është elaboruar pjesërisht në raportin "Hartëzimi i lajmeve të rrejshme dhe Dezinformimit në Ballkanin Perëndimor dhe Identifikimi i Mënyrave për të Luftuar ato Efektivisht, Departamenti i Politikave për Marrëdhënie me Jashtë, Parlamenti Evropian, shkurt 2021, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU\(2020\)653621_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU(2020)653621_EN.pdf). Përveç kësaj, edhe Arben Gashi, shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, ka folur publikisht se si Grenelli i kishte bërë presion LDK-së, duke ia numëruar ditët që i kishte dhënë LDK-së në dispozicion për tu siguruar që qeveria e Kurtit të rrëzohej me mocion mosbesimi kundër qeverisë. Qeveria u rrëzua, por Vetëvendosje fitoi shumicën në zgjedhjet e ardhshme.

përmendur në kombinim me fjalën “anti-amerikan.”²⁷⁵. Megjithëse pretendimet e ngritura në këto postime nuk mund të etiketohen si të rrejshme, ato nuk kanë dëshmi të mjaftueshme për këto pretendime. Kjo narrativë kundër Kurtit gjindet edhe nëpër rrjetet sociale të deputetëve të Parlamentit të Kosovës. Postimi i deputetit të PDK-së Ardian Kastrati,²⁷⁶ ka qenë një shembull i kësaj, postim ky që ishte shpërndarë në 18 adresa të ndryshme.²⁷⁷ Një postim tjetër ishte bërë nga ish-deputeti Milaim Zeka, i cili kishte thënë në një intervistë me Euronews Albania që “Kurti është anti-Amerikan”.²⁷⁸ Kjo deklaratë e tij ishte shpërndarë në pesë faqe të ndryshme. Kolumnisti Ilir Mirena kishte bërë një postim të ngjashëm²⁷⁹ e mesazhi i tij ishte shpërndarë në 18 faqe.

Marrëdhëniet e Kurtit me ShBA-në kanë qenë tema kyçe e emisionit televiziv “Debat Plus” të 30 janarit 2023.²⁸⁰ Portali “Periskopi”²⁸¹ e kishte përdorur një video për të dëshmuar qëndrimet anti-amerikane të Kurtit gjatë kohës sa ky i fundit kishte qenë në opozitë dhe që nuk u ishte përmbajtur kërkesave të ShBA-ve. Në të vërtetë, kjo video kishte pasur të bëjë me refuzimin për mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë dhe refuzimin e gazit që do të vinte nga një investitor amerikan. Megjithatë, kjo video ishte shikuar gati 200,000 herë dhe ishte shpërndarë edhe në rreth dhjetë faqe të tjera në Facebook.

Shqetësimi për marrëdhëniet mes qeverisë së Kosovës dhe SHBA-së ishte ngritur përsëri në kohë të krizave, duke përfshirë edhe vendimin e fundit të targave. SHBA-të i kishin kërkuar qeverisë që të shtyjë zbatimin e vendimit. Në nëntor të vitit 2022, dy ministrat e Qeverisë së Kosovës, Albulena Haxhiu dhe Xhelal Sveçla, kishin planifikuar të vizitojnë SHBA-në, mirëpo Ambasada Amerikane kishte deklaruar se nuk ishte koha e duhur për udhëtim për shkak të krizës së brendshme të vazhdueshme, kështu që vizita nuk kishte ndodhur. Disa burime mediale e kishin portretizuar këtë zhvillim si dëshmi të një tendosjeje të marrëdhënieve ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe SHBA-së.

Artikujt pretendonin që Amerika u kishte ndaluar vizitat ministrave të qeverisë së Kurtit²⁸² apo që situata ishte duke eskaluar – Hovenieri i kishte thënë Haxhiut: Mos u nis për

²⁷⁵ Të dhënat e siguruar nga CrowdTangle, një mjet i hapur për analizimin e të dhënave që mirëmbahet nga Facebook

²⁷⁶ “Kur Kryeministri punon kundër SHBA-së gjithmonë ka me qenë vet” - Ardian Kastrati, postim në Facebook, 10 shkurt 2023, <https://www.facebook.com/100063565067362/posts/668641835264646>

²⁷⁷ “Deputeti i PDK-së: Besoj se s’do të kemi kurrë kryeministër më anti-amerikan se Kurti”, Almakos.com, postim në Facebook, 10 shkurt 2023, <https://www.facebook.com/100064756061165/posts/562663489235515>

²⁷⁸ “Milaim Zeka: Kurti, nje anti-kosovar dhe anti-amerikan”, Gazeta Tema, postim në Facebook, 31 janar 2023, <https://www.facebook.com/151865931528249/posts/5985787844802666>

²⁷⁹ “... (..Une vazhdoje te besojte qe Kurti eshte vetem nje keqlexues akademikeve te majte antiamerikane dhe anti perendimor ne te cilet eshte kurthuar, sakatuar ideologjikisht, dhe nuk po ia del ta nxjerr kryet..)” Ilir Mirena, postim në Facebook post, 28 janar 2023, <https://www.facebook.com/ilir.mirena/posts/10159710087305326>

²⁸⁰ “Debat Plus me Ermal Pandurin - WILLIAM WALKER / KURTI VS AMERIKA”, RTV Dukagjini, Youtube video, Minute 14:45, January 30, 2023, <https://www.youtube.com/watch?v=Doiv2FLJBzY>

²⁸¹ “A është kryeministri Kurti anti-amerikan?”, Periskopi, postim në Facebook, 27 maj 2022, <https://www.facebook.com/watch/?v=983941638978184>

²⁸² “Amerika ua ndalon vizitën në ShBA ministrave Sveçla dhe Haxhiu”, Paparaci.com, 9 nëntor, 2022, <https://paparaci.com/235623/amerika-ua-ndalon-viziten-ne-shba-ministrave-svecla-dhe-haxhiu/>

ShBA”.²⁸³ Këta artikuj ishin shpërndarë në 24 faqe të Facebookut.

Një tjetër narrativë që qarkullon është portretizimi i partive opozitare si të gatshme për të zbatuar Asociacionin vetëm me qëllim që të rimarrin pushtetin. Analiza e portaleve të ndryshme online dhe faqeve në Facebook zbulon se disa platforma shpërndajnë mesazhe që sulmojnë opozitën dhe e rrisnin polarizimin shoqëror. Nga data 15 tetor 2022 deri më 15 mars 2023, monitoruesit e këtyre platformave kanë identifikuar 40 raste të artikujve apo postimeve të lajmeve që u cilësuan si dezinformata ose keqinformim. Disa nga këto pretendime ishin verifikuar si të rreme nga verifikuesit e fakteve.

Faqja “Diaspora me Albinin” ka publikuar pesë postime nga nëntori 2022 deri në mars 2023 duke përhapur dezinformata se partitë opozitare duan të themelojnë Asociacionin. Këto postime u rishpërndanë gati 200 herë, dhe disa përmbanin video me 68 mijë shikime. Këto postime thonin që PDK dëshiron bosnjëzimin e Kosovës, dhe që opozita e përkrah Asociacionin për shkak të interesave biznesore.²⁸⁴ Ato tregojnë deklarata të akterëve të ndryshëm nga opozita²⁸⁵ të cilën insistojnë që Asociacioni duhet të themelohet.

Përveç dezinformatave ose llojeve të tjera të manipulimit, si ‘clickbait’, satira përdoret gjithashtu për të forcuar besime të caktuara. Shembuj të tillë gjenden në faqen e internetit satirike, “Specbuk”. Një postim thotë “LDK, AAK dhe PDK i kanë premtuar lobit serb se do ta zbatojnë ‘Zajednicën’ në këmbim të ndihmës për t’u kthyer në pushtet”²⁸⁶, duke përdorur fjalën serbe për asociacion. Në këtë postim nuk ka fakte që e mbështesin këtë deklaratë ndërsa në foto shihen liderët e opozitës si të manipuluar dhe kontrolluar nga presidenti serb Vuçiq. Ky informacion ka rezultuar të jetë i pavërtetë nga verifikuesit e fakteve.²⁸⁷

²⁸³ “Situatë eskaluere – Hovenier, Haxhiut: Mos u nis për SHBA”, *In sajderi*, 9 nëntor 2022, <https://insajderi.org/situatw-eskaluere-hovenier-haxhiut-mos-u-nis-per-shba/>

²⁸⁴ “Vlora Çitaku: Te henen me 27 shkurt Albin Kurti pranon asociacionin.”, *Diaspora me Albinin*, postim në Facebook, 23 shkurt 2023, <https://www.facebook.com/DAlbinin/posts/pfbid0Qz2HPx7x3Ju55uqEf3oP8TicU31ENxGP3yftdumAJgCq1TrwX6SUQv5LDWboNYKYI>

²⁸⁵ “Patriotat: Zajednica do bëhet edhe Pik”, *Diaspora me Albinin*, postim në Facebook, 28 shkurt, 2023, <https://www.facebook.com/watch/?v=1329351680972820>

²⁸⁶ “LDK, AAK dhe PDK ia kanë premtuar lobit serb që do ta zbatojnë Zajednicën në shkëmbim të ndihmës për rikthim në pushtet.”, *Specbuk*, postim në Facebook, 13 shkurt 2023,

²⁸⁷ “Rrena për premtimin që kanë marrë LDK, PDK & AAK”, *Kallxo (Krypometer)*, 24 shkurt 2023, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-premtimin-qe-kane-marre-ldk-pdk-aak/>

III. Narrativat dezinformuese rreth shëndetit dhe ekonomisë

Të dhënat nga monitorimi i portaleve dhe faqeve të ndryshme në Facebook në periudhën prej 15 tetor 2022 deri më 15 mars 2023 tregojnë për lloje të ndryshme të dezinformatave që ndërlidhen me ekonominë dhe shëndetin.

Figura 22: - Dezinformimi dhe shëndeti




Figura 23: Dezinformimi rreth ekonomisë



Dezinformimi përdoret për të bindur qytetarët që të blejnë produkte të caktuara duke i paraqitur ato si shërim për sëmundje të ndryshme, përfshirë kancerin, sëmundjet e mushkërive, diabetin, etj. Dezinformatat rreth rritjes së çmimeve dhe mungesave të medikamenteve të ndryshme në treg shpërndahen më së shpeshti. Ky studim zbuloi se dezinformatat që ngjallën panik për rritjen e çmimeve shkaktuan rritjen edhe të mëtejshme të çmimeve. Publikimet që paralajmëronin qytetarët për rritje të madhe të çmimeve apo për mungesën e produkteve të caktuara kanë ndikuar që qytetarët e Kosovës të blejnë produkte me çmime të larta nën keqkuptimin se produkti do të mbarojë.

3.1 Shitja e produkteve përmes mashtrimeve që përdorin artikuj të rremë

Dezinformatat e paraqitura si këshilla mjekësore për përfitimet e produkteve të ndryshme shëndetësore janë identifikuar në 173 faqe të ndryshme në Facebook. Ekipi ynë ka identifikuar 519 postime të publikuara në këto faqe, duke përfshirë përmbajtjen e sponsorizuar që synon audiencat që nuk i ndjekin këto faqe. Në mesin e tyre, ishte një artikull që ekzagjeron dëmin e shkaktuar nga konsumimi i lakrës e që e ka pasur numrin më të madh të postimeve, përkatësisht gjithsej 133 postime në 35 faqe në Facebook. Në këtë artikull titulli "Ekzagjerim për dëmet e shkaktuara nga konsumimi i lakrës" është hiperbolik dhe në përmbajtje nuk përmendet ndonjë dëm apo sëmundje e shkaktuar nga konsumimi i lakrës.

Postimet e sponsoruara në Facebook patën një nivel më të lartë interaktiviteti, me mbi 11,000 pëlqime, komente dhe shpërndarje në total. Artikulli me interaktivitetin më të lartë ishte ai që promovonte një ilaç që supozohet se shëron kancerin e prostatës, me 5,300 pëlqime.

Lloje të ndryshme të lajmeve të rreme janë përdorur në 17 artikuj të identifikuar, duke përfshirë përmbajtje të sajuar,²⁸⁸ lidhje të rrejshme (mungesë të konsistencës në mes të titullit dhe tekstit),²⁸⁹ clickbait, (ekzagjerim apo përdorim i hiperbolës),²⁹⁰ dhe informacione pjesërisht të rrejshme.²⁹¹

Për shembull, artikulli me titullin “Farmaceutiket e rrezikshëm në Kosovë 2021. Si i vrasin farmacitë meshkujt me potencë të dobët duke fshehur të vërtetën”²⁹² është plotësisht i sajuar. Në artikull pretendohet se një produkt i caktuar është diskutuar në një debat televiziv në RTK, por këtë e ka mohuar Bashkim Vishaj, producent i RTK-së. Shembuj të tjerë përfshijnë artikuj ku njerëz të ndryshëm janë paraqitur në mënyrë të rreme, për shembull, “një endokrinologe e njohur ka dhënë një intervistë të sinqertë për një televizion të Kosovës”.²⁹³ Në këtë artikull, një aktore gjermane prezantohet rrejshëm si mjek. Në një rast tjetër, në një artikull pretendohet rrejshëm që një mjek kroat po ‘jep’ barna që po e ‘trondisin botën’,²⁹⁴ mirëpo në brendësi të tekstit nuk ka asgjë fjalë që e citon ndonjë mjek kroat.

Dezinformimi, pasi të identifikohet, jo vetëm që promovon narrativa të rreme, por gjithashtu përhap panik bazuar në fakte të pavërtetuara. Një shembull i kësaj është artikulli me titull “Ushqimi vdekjeprurës që e hamë të gjithë, çdo ditë!”²⁹⁵ Pavarësisht titullit shumë të fuqishëm, artikulli nuk përmend ndonjë ushqim specifik. Artikuj të tjerë dezinformues që shkaktojnë frikë zakonisht kanë të bëjnë me sëmundje kronike si kanceri, diabeti dhe hipertensioni. Niveli i lartë i interesit dhe shqetësimit publik për këto sëmundje lejon që narrativat e rreme të përhapen lehtësisht. Shembuj të artikujve të tillë përfshijnë pretendime të rreme se vajguri²⁹⁶ apo farat e rrushit²⁹⁷ e shërojnë kancerin e që janë të bazuara në teori konspirative dhe në përfundime të padëshmuara fare.

²⁸⁸ “Rena se vaji natyral zgjat gjatësinë trupore”, Kallxo (Krypometer), 2 shkurt 2023

<https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-vaji-natyral-zgjat-gjatesine-trupore/>

²⁸⁹ “Titulli i rremë për ilaçin e mjekëve kroatë”, Kallxo (Krypometer), 23 shkurt 2023, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-per-ilacin-e-mjekeve-kroate/>

²⁹⁰ “Ekzagjerimi rreth dëmeve që vijnë nga konsumimi i lakrës”, Kallxo (Krypometer), 25 janar 2023

<https://kallxo.com/krypometer/ekzagjerimi-rreth-demeve-qe-vijne-nga-konsumimi-i-lakres/>

²⁹¹ “Rena për shkatërrim të qelizave të kancerit nga një substancë bimore”, Kallxo (Krypometer), 25 shkurt 2023

<https://kallxo.com/krypometer/rrena-per-shkaterrim-te-qelizave-te-kancerit-nga-nje-substance-bimore/>

²⁹² “Farmaceutiket e rrezikshëm në Kosovë 2021. Si i vrasin farmacitë meshkujt me potencë të dobët duke fshehur të vërtetën”, Lajme

SR, 3 maj 2023 [https://xkemajoje.shop/?acc=%7B%7Bcampaign.name%7D%7D&adset=%7B%7Bbadset.id%7D%7D&ad=%7B%7bad.id%7D%7D&placement=%7B%7Bplacement%7D%7D&ev=Lead&pxl=1244387882781474&adname=%7B%7Bad.name%7D%7D&fbclid=IwAR3M_4TghqHdP9-RrBHHiC2_cHdMulpgnm5LfFoWuY6LTMJI7SY3eUIDuWA](https://xkemajoje.shop/?acc=%7B%7Bcampaign.name%7D%7D&adset=%7B%7Bbadset.id%7D%7D&ad=%7B%7Bad.id%7D%7D&placement=%7B%7Bplacement%7D%7D&ev=Lead&pxl=1244387882781474&adname=%7B%7Bad.name%7D%7D&fbclid=IwAR3M_4TghqHdP9-RrBHHiC2_cHdMulpgnm5LfFoWuY6LTMJI7SY3eUIDuWA)

²⁹³ https://qwt.d.nakerod.com/?ad_id=%7B%7Bad.id%7D%7D&adset_id=%7B%7Badset.id%7D%7D&fbp=923110779047392&placement=%7B%7Bplacement%7D%7D&fbclid=IwAR0AUjdIhUunk7Vrp48lfkfgd-hEaqyOKcuMCF6IQfUX1C304eftjrYPGk

²⁹⁴ “Titulli i rremë për ilaçin e mjekëve kroatë”, Kallxo (Krypometer), 23 shkurt 2023, <https://kallxo.com/krypometer/titulli-i-rreme-per-ilacin-e-mjekeve-kroate/>


²⁹⁵ “Lajmi i rremë për ushqimet vdekjeprurëse”, Kallxo (Krypometer), 27 shkurt 2023, <https://kallxo.com/krypometer/lajmi-i-rreme-per-ushqimet-vdekjeprures/>

²⁹⁶ “Pretendimi i rremë se vajguri e shëron kancerin dhe leukemin”, Kallxo (Krypometer), 26 tetor 2022,

<https://kallxo.com/krypometer/pretdimi-i-rreme-se-vajguri-e-sheron-kancerin-dhe-leukemin>

²⁹⁷ “Rena se fara e rrushit e shëron kancerin për disa ditë”, Kallxo (Krypometer), 16 korrik 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-fara-e-rrushit-e-sheron-kancerin-per-disa-dite/>

Figura 25: Dezinformata e publikuar midis 22/10/22 - 23/04/23



Ngjashëm ndodh edhe me dezinformimin rreth diabetit e që shpeshherë ndërlihen me qëllimin për të promovuar lirimet për shitjen e produkteve specifike.²⁹⁸ Një artikull i tillë pretendon që një lloj specifik i çajit e shëron diabetin.²⁹⁹ Artikulli shkon deri në atë masë sa që i referohet një endokrinologu që nuk ekziston në Kosovë, pra është fiktiv, si dhe një instituti që po ashtu nuk ekziston fare, ‘Instituti të Kosovës për Endokrinologji.’ Në një artikull tjetër³⁰⁰ ku promovohet i njëjti produkt, tani i referohen një endokrinologu të sajuar gjerman.

3.2 Dezinformatat rreth COVID - 19

Titujt që përmbajnë gjetje që provokojnë frikë rreth COVID-19 kanë qenë artikujt më të zakonshëm dezinformues. Në fillim të vitit 2023, portali Botapress publikoi një artikull me titull “Virusi po bene kerdë ne kosove kaq raste me COVID.”³⁰¹

E artikulli kishte përmendur vetëm 12 raste të infektimit, duke kundërshtuar kështu titullin e vetë alarmues. Kjo nuk është vetëm klikim, por është edhe mashtruese, pasi ekzagjeron gjendjen aktuale në Kosovë. Artikujt të³⁰² ngjashëm ishin publikuar në të njëjtin portal³⁰³ për tri ditë me radhë.

Postimet në shumë faqe të Facebook^{ut304} rreth vdekjeve si pasojë e infektimit me virusin COVID-19 kanë shpërndarë edhe më shumë dezinformata,³⁰⁵ duke e nxitur edhe më shumë frikën nga COVID-19. Këta artikuj janë publikuar edhe në së paku katër faqe të tjera në internet. Ka pasur edhe raste kur i njëjti dezinformim për COVID-19 u ripublikua në fund të vitit 2022 ose në fillim të 2023, ose duke e rishpërndarë dezinformimin ose duke manipuluar afatin kohor duke ripublikuar informacione të vjetra.

Në muajin dhjetor 2020, ishte raportuar që shqiptarët që jetojnë në Zvicër nuk mund të udhëtonin në Kosovë për shkak që Zvicra e kishte zgjeruar listën e “vendeve me rrezik”.

²⁹⁸ “Promovimi i një ilaçi përmes fakteve të rreme”, Kallxo (Krypometer), 4 nëntor 2022 <https://kallxo.com/krypometer/promovimi-i-nje-ilaci-permes-fakteve-te-rreme/>

²⁹⁹ “Rena për shërimin e diabetit përmes një çaji”, Kallxo (Krypometer), 9 nëntor 2022 <https://kallxo.com/krypometer/re-na-per-sherimin-e-diabetit-permes-nje-caji/>

³⁰⁰ po aty.

³⁰¹ “Virusi po bene kerdë ne kosove kaq raste me COVID”, Botapress.info, 15 janar 2023, <https://botapress.info/virusi-po-bene-kerde-ne-kosove-kaq-raste-me-covid/>

³⁰² «Çka po ndodh kështu në Kosovë: Shtohen infektimet me Covid 19», Botapress.info, 17 janar 2023, <https://botapress.info/cka-po-ndodh-keshtu-ne-kosove-shtohen-infektimet-me-covid-19/>

³⁰³ «Çka po ndodh kështu: Rritet numri i rasteve me COVID-19 në Kosovë», Botapress.info, 16 janar 2023, <https://botapress.info/cka-po-ndodh-keshtu-rritet-numri-i-rasteve-me-covid-19-ne-kosove-2/>

³⁰⁴ “Rena se tre persona kanë vdekur nga Covid-19 në 24 orët e fundit”, Kallxo (Krypometer), 16 nëntor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/re-na-se-tre-persona-kane-vdekur-nga-covid-19-ne-24-oret-e-fundit/>

³⁰⁵ (Rena për vdekjen e 29 vjeçarit nga COVID-19”, Kallxo (Krypometer), 26 dhjetor 2022, <https://kallxo.com/krypometer/re-na-per-vdekjen-e-29-vjecarit-nga-covid-19/>

Publikimi i këtij artikulli pas dy vitesh ka qenë hutues,³⁰⁶ pasi që Zvicra e ka larguar Kosovën nga lista e vendeve në rrezik dhe nuk ka tashmë listë të “vendeve me rrezik” nga COVID-19.

Ky informacion mashtrues (misleading) u shpërnda 102 herë në Facebook nga 16 faqe të ndryshme nga 2022 deri në prill 2023.

Që nga fillimi i pandemisë, dezinformatat³⁰⁷ rreth COVID-19 në Kosovë kanë variuar, duke filluar që nga origjina e virusit, deri te vaksina dhe efektet e saj. Intensiteti i dezinformimit bëri që disa njerëz të besojnë se virusi nuk ekziston. Informacionet ishin të mbushura me teori të shumta konspirative, duke përfshirë teoritë rreth Bill Gates që shpiku virusin dhe po u vendoste njerëzve mikroçipa përmes vaksinave. Shumica e këtyre teorive konspirative u bënë virale nëpër media sociale.³⁰⁸ Gjatë periudhës së pandemisë, mënyra se si njerëzit kërkojnë informacione³⁰⁹ ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme.

Përqindja e njerëzve që kalojnë pesë orë ose më shumë gjatë një dite duke kërkuar informacion në internet ishte trefishuar. Për shkak të faktit se dezinformatat për COVID-in u përhapën kryesisht në internet dhe nëpër rrjete sociale, ka një ndërlidhje në mes të trefishimit të zakoneve të kërkimit të informacionit në internet me të dhënat që tregojnë që deri në qershor 2020, gati 30% e qytetarëve të Kosovës nuk kanë besuar që COVID-19 ekzistonte, kjo sipas një ankete me qytetarë të realizuar Pyperl.³¹⁰

Për më shumë, narrativat dezinformuese kundër vaksinave ndikuan që qytetarët të hezitojnë rreth vaksinimit. Deri në gusht 2021, rreth 60% e qytetarëve të Kosovës³¹¹ ishin ose të pavendosur (37.9%) ose nuk ishin të gatshëm që të vaksinohen (22.7%), kjo kryesisht si rezultat i frikës rreth efekteve anësore të vaksinës.

Për pasojë, mbi 133,000 mijë vaksina të “AstraZeneca”³¹² u bënë të papërdorshme ngase u doli afati në fund të muajit gusht 2021. Nga muaji mars 2020 e deri në janar 2023, së paku 55 artikuj dezinformues dhe postime rreth koronavirusit ishin demantuar.

³⁰⁶ “Lajmi i rremë për COVID-19 për kohën kur është publikuar”, Kallxo (Krypometer), 29 janar 2023, <https://kallxo.com/krypometer/lajmi-i-rreme-per-covid-19-per-kohen-kur-eshte-publikuar/>

³⁰⁷ “Dezinformatat për COVID-19, trajektorja dhe globalizimi i tyre”, Observuesi i Gazetarisë Evropiane, Dren Gërguri, 11 tetor 2020, <https://al.ejo-online.eu/profesionalizmi-ne-media/dezinformatat-per-covid-19-trajektorja-dhe-globalizimi-i-tyre>

³⁰⁸ “5 dezinformatat më të mëdha rreth COVID-19 në gjuhën shqipe”, Dren Gërguri, 23 maj 2020, <https://drengerguri.com/top-5-disin-formations-during-covid-19-in-albanian-language>

³⁰⁹ “Infodemia dhe Kriza për të dalluar Dezinformatat nga Informacionet e Sakta: Rast Studimor rreth Përdorimit të Facebookut në Kosovë gjatë COVID-19”, Vilnius University Press, Gëzim Qerimi dhe Dren Gërguri, 29 dhjetor 2022, <https://www.journals.vu.lt/IM/article/view/29379/29839>


³¹⁰ “Sondazh nga Pyper: 29.03 për qind e qytetarëve nuk besojnë se COVID-19 ekziston në Kosovë”, Telegrafi, Pyper, 3 korrik 2020, <https://telegrafi.com/sondazh-nga-pyper-29-03-per-qind-e-qytetareve-nuk-besojne-se-covid-19-ekziston-ne-kosove/>

³¹¹ “Pse qytetarët e Kosovës hezitojnë të vaksinohen?”, Telegrafi, Pyper, 11 gusht 2021, <https://telegrafi.com/pse-qytetaret-e-kosoves-hezitojne-te-vaksinohen/>

³¹² “Mbi 133 mijë vaksina hidhen në bërlllok”, Kallxo, 1 shtator 2021, <https://kallxo.com/shendeti/mbi-133-mije-vaksina-hidhen-ne-berlllok/>

Në fillim të vitit 2023, ishte ngritur alarmi për viruse të reja duke u përdorur tituj senzacional. Shembull i kësaj ishte artikulli i quajtur “Ngrihet alarm i kuq – Konfirmohet rasti i parë, 9-vjeçarja infektohet me virusin A-H5”³¹³(një lajm clickbait që nënkuptonte që virusi ishte shpërndarë edhe në Kosovë) ishte publikuar në 38 faqe të ndryshme në Facebook.

Figura 25: Ndikimi i narrativave lidhur me COVID- 19



³¹³ “Ngrihet alarm i kuq – Konfirmohet rasti i parë, 9-vjeçarja infektohet me virusin A-H5”, Insajderi, 12 janar 2023| <https://insajderi.org/ngrihet-alarm-i-kuq-konfirmohet-rasti-i-pare-9-vjecarja-infektohet-me-virusin-a-h5/>

3.3 Dezinformimi rreth çmimeve të energjisë

Gjatë viteve të fundit, Kosova është përballur me një valë të rritjes së çmimeve. Norma e inflacionit në vitin 2021 ishte 7.6%, ndërsa në vitin 2022 rritja e çmimeve arriti në 11.6%.³¹⁴ Megjithëse janë bërë përpjekje për të fajësuar luftën në Ukrainë për rritjen e çmimeve, dezinformimi gjithashtu duket se ka luajtur një rol të rëndësishëm.

Kosova pësoi një krizë të konsiderueshme energjetike në fund të vitit 2021. Fillimisht u menaxhua me reduktime të energjisë elektrike në fund të vitit 2021, dhe më pas me çmime të larta të energjisë elektrike në fillim të vitit 2022. Debatet për energjinë kanë ndodhur që nga dhjetori 2021. Një narrativë e diskutuar është se “Evropa po i kthehet qymyrit”³¹⁵ dhe që 26 termocentrale me qymyr janë rifunksionalizuar përsëri. Pavarësisht nga këta artikuj që tregojnë një rikthim në përdorimin e qymyrit, të dhënat e fundit paraqesin një pamje më të nuancuar. Kështu, është raportuar se një pjesë e konsiderueshme e termocentraleve me qymyr në fakt ishin vendosur në gjendje gatishmërie, por nuk ishin duke prodhuar energji elektrike. Në fakt, kryesisht për shkak të një dimri të butë në sezonën 2022/2023, prodhimi i energjisë elektrike në Evropë ishte më i ulët për 18.9 teravat se sa dimri i mëparshëm. Përkundër këtij informacioni, media kosovare ka përdorur ‘rikthimin e qymyrit’ për të shtrembëruar narrativën në Kosovë, duke nxitur idenë se Kosova padrejtësisht po pengohet për të ndërtuar termocentrale të reja me qymyr dhe njëkohësisht duke avokuar për kthimin e përdorimit të qymyrit.³¹⁶

Përveç energjisë dhe arsyeve që ndërlidhen me rritjen e çmimeve, mediat raportuan shumë edhe për çmimin e peletit të drurit.³¹⁷ Që nga 15 tetori 2022 e deri me 1 prill 2023, çmimi i peletit u raportua në 284 raste. Raportimet rreth çmimit të peletit arritën kulmin në verën e vitit 2022, kur çmimi u rritë nga 180 euro sa ishte në 740 euro.³¹⁸ Kjo rritje e çmimit të peletit kishte ndodhur për shkak të raportimeve për mungesë të tij, ngase kjo rritje kishte qenë më e madhe se sa në vendet e tjera të rajonit.³¹⁹ Bashkë me raportimet rreth rritjes së çmimit të peletit, mediat kanë raportuar rrethshëm rreth parashikimeve meteorologjike për një dimër të vështirë, duke shkaktuar panikë të mëtutjeshme e cila kishte për qëllim shitjen sa më të shpejtë të peletit.³²⁰

³¹⁴ *Indeksi i Harmonizuar i çmimeve të konsumit, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Dhjetor 2022, <https://ask.rks-gov.net/media/7248/indeksi-i-harmonizuar-i-%C3%A7mimeve-t%C3%AB-konsumit-ih%C3%A7k-dhjetor-2022.pdf>*

³¹⁵ “Evropa po i kthehet qymyrit dhe energjisë bërthamore për shkak të krizës energjetike”, *Gazeta Blic, 24 shkurt 2023, <https://gazetablic.com/evropa-po-i-kthehet-qymyrit-dhe-energji-se-berthamore-per-shkak-te-krizes-energjetike/>*

³¹⁶ *Analiza Evropiane e Elektricitetit, Ember, 21 janar 2023 <https://ember-climate.org/insights/research/european-electricity-review-2023/>*

³¹⁷ *Rritet çmimi i peletit në Kosovë, 1 ton kushton deri në 400 euro”, Kallxo, 15 korrik 2022, <https://kallxo.com/lajm/rritet-cmimi-i-peletit-ne-kosove-1-ton-kushton-deri-ne-400-euro/>*

³¹⁸ “Rizvanolli: Në vitin e kaluar një ton pelet 180 euro, ndërsa këtë vit 740 euro”, *RTV Dukagjini, Facebook post, 20 tetor 2022, <https://www.facebook.com/372642049429223/posts/6439761946050506>*

³¹⁹ “Dimër i vështirë: Peleti më i shtrenjtë në Ballkan është në Kosovë”, *Radio Star, 20 korrik 2022, <https://radiostargjilan.com/web/dimer-i-veshtire-peleti-me-i-shtrenjte-ne-ballkan-eshte-ne-kosove/>*

³²⁰ “Një shpërthim arktik zgjon banorët, meteorologët nxjerrin parashikimet e tyre çfarë do të ndodh me furnizimin e energjisë”, *Sot.com.al, 10 dhjetor 2022, <https://sot.com.al/bota/i-ftohti-acar-godet-europen-dhe-do-te-testoje-furnizimet-me-energji-fare-pa-i554999>*

Gjatë këtyre dy viteve të fundit, Kosova ka shënuar një rritje rekord të çmimit të naftës. Shpeshherë këto rritje janë mbi mesataren e rritjes së çmimeve në treg, gjë që bëri që qeveria e Kosovës të vendoste çmimin maksimal ose tavanin e çmimeve për produkte të naftës in 2022.³²¹ Paralajmërimet e pronarëve të bizneseve për rritje të çmimeve ishin publikuan nëpër media pa asnjë verifikim të pavarur nga gazetarët apo institucionet përkatëse të fushës. Për më shumë, paralajmërimet ndonjëherë nxirreshin jashtë kontekstit. Për shembull, pronari i një prej kompanive më të mëdha të derivateve në Kosovë u citua nga shumë portale lajmesh duke thënë, “brenda disa ditësh, çmimi për një litër naftë mund të shkoj deri në 3.5 euro”.³²² Ky titull medial është publikuar 186 herë në Facebook dhe ka marrë 4,696 reagime, megjithatë teksti nuk ka dhënë asnjë të dhënë zyrtare nga ndonjë institucion i besueshëm për të mbështetur këtë parashikim të rremë.

Përkundër alarmit që ishte ngritur, ishte konfirmuar se në Kosovë kishte rezerva të mjaftueshme të naftës, të cilat ishin importuar paraprakisht. Importet kryesore të naftës së Kosovës vijnë nga Emiratet e Bashkuara Arabe, Shqipëria, Austria dhe Bullgaria. Ngjashëm, një artikull i rrejshëm që thoshte që një mërgimtar e barti makinën në rimorkio të autobusit të shkak të shtrenjtimit të derivateve³²³ e që ishte shpërndarë 29 herë në rrjete, duke nxitur 509 reagime.

Raportimi i rrejshëm dhe dezinformatat që nxitën panikë në mesin e konsumatorëve ishin vërejtur edhe në raportimet për çmimet e produkteve të bukës, duke e ngritur alarmin që do të rriteshin deri në 10 euro.³²⁴

Mediat në Kosovë po ashtu kanë paralajmëruar për rritje të çmimit të vajit dhe mungesave të vajit për gatim³²⁵ si rrjedhojë e luftës në Ukrainë.³²⁶ Raportimet për mungesën e vajit për gatim u publikuan gjithashtu, duke shkaktuar panik te qytetarët. Keqinformimet për mungesën e vajit të gatimit në treg i kanë lejuar tregtarët që të rrisin çmimet e tyre, duke bërë që çmimi i një litri vaj bimor të rritet në 2.5 euro. Vaji më i shtrenjtë i importuar në Kosovë kushtoi 1.45 cent, por u shit deri në 3.49

Të dhënat tregojnë që vaji më i shtrenjtë i importuar në Kosovë kishte kushtuar 1.45 cent, por ishte shitur deri në 3.49 euro për litër.³²⁷

321 “Udhëzimit Administrativ (QRK) - Nr. 03/2022 për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës dhe karburanteve të ripërtërishme dhe masat e tjera mbrojtëse (GRK) nor. 03/2022”, Official Gazette of the Republic of Kosova, August 27, 2022, Accessible at: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=62315>

322 “Jusaj: Brenda pak ditësh, çmimi për një litër naftë mund të shkojë në 3.5 euro”, Klan Kosova, 8 mars, 2022, <https://klankosova.tv/jusaj-brenda-pak-ditesh-cmimi-per-nje-liter-nafte-mund-te-shkoje-ne-3-5-euro/>

323 “Rrena se mërgimtari barti makinën në rimorkio të autobusit të shkak të shtrenjtimit të derivateve”, Kallxo (Krypometer), 8 gusht, 2022, <https://kallxo.com/krypometer/rrena-se-mergimtari-barti-makinen-ne-rimorkio-te-autobusit-te-shkak-te-shtrenjtimit-te-derivateve/>

324 Edhe kjo na mungonte, çmimi i bukës pritet të bëhet 10 euro. Kosova Sot, 27/03/22 <https://www.kosova-sot.info/lajme/609688/edhe-kjo-na-mungonte-cmimi-i-bukes-pritet-te-behet-10-euro/>

325 Kurti paralajmëron masa pas rritjes së çmimeve, inspektorët janë duke i dokumentuar shkeljet e bëra, KALLXO.com, 10/03/22 <https://kallxo.com/lajm/kurti-paralajmëron-masa-pas-rritjes-se-cmimeve-inspektorët-janë-duke-i-dokumentuar-shkeljet/>

326 “Dezinformatat që shkaktuan panik dhe ngritje të çmimeve”, Kallxo, 29 qershor 2022, <https://kallxo.com/komuna/fact-check/dezinformatat-qe-shkaktuan-panik-dhe-ngritje-te-cmimeve/>

327 “Vaji më i shtrenjtë i importuar në Kosovë kushtoi 1.45 cent, por u shit deri në 3.49”, Kallxo, 11 mars 2022, <https://kallxo.com/lajm/vaji-me-i-shtrenjte-i-importuar-ne-kosove-kushtoi-1-45-cent-por-u-shit-deri-ne-3-49/>

IV. Kapaciteti i Kosovës për t'u përballur me dezinformimin

Shoqëria kosovare përballlet me sfida serioze në krijimin e mekanizmave efektivë për të zbutur përhapjen e dezinformatave.

Parandalimi i dezinformatave nuk trajtohet në mënyrë adekuate nga institucionet e sigurisë, sistemi i drejtësisë, organet rregullatore që kontrollojnë frekuencat kombëtare të radios dhe televizionit, dhe sistemi arsimor. Studime të ndryshme kërkimore, përfshirë edhe këtë, nxjerrin në pah pamjaftueshmërinë e kapaciteteve institucionale për të adresuar dezinformimin, pasi ai perceptohet kryesisht si një problem që ka të bëjë vetëm me median. Rrjedhimisht, institucionet publike i shmangen përgjegjësisë së tyre për ta trajtuar këtë çështje.³²⁸ Ndryshe nga raportet tjera që kanë evidentuar mungesën e koordinimit institucional,³²⁹ ky studim i BIRN-it ka ndërmarrë një hulumtim më të thellë për të zbuluar sfida serioze për të luftuar dezinformimin.

Për të matur ndjeshmërinë e publikut ndaj dezinformimit, BIRN ka bërë një anketë të opinionit publik me 1,056 të anketuar. Gjithashtu, për të vlerësuar gatishmërinë e zyrtarëve institucionalë për të adresuar dezinformimin, BIRN kreu një eksperiment social me 50 pjesëmarrës, duke përfshirë mësues, mjekë, prokurorë, gjyqtarë dhe punonjës socialë. Për të matur gatishmërinë e medias, shoqërisë civile dhe institucioneve, BIRN organizoi gjithashtu pesë fokus grupe tematike gjatë prillit 2023. Këto fokus grupe përfshinë mbi 40 pjesëmarrës nga sektorë të ndryshëm, si nga media, organizata të shoqërisë civile (OJQ), zyrtarë të sektorit të sigurisë, zyrtarë të Marrëdhënieve me Publikun në bizneset private.

Kuadri ligjor dhe mungesa e zbatimit të tij bën pak për të mbrojtur shoqërinë nga dezinformimi.

Kosova ka një kornizë ligjore të vendosur për të adresuar çështjen e dezinformimit; megjithatë, kjo bazë ligjore është joefektive në praktikë. Kosovës gjithashtu i mungon aktualisht edukimi efektiv për media. Për më tepër, formulimi dhe zbatimi i një strategjie të sigurisë kibernetike është ende në fazën e hartimit. Në vitin 2023, Kosova miratoi një ligj për sigurinë kibernetike, i cili hapi rrugë për krijimin e mekanizmave thelbësorë, siç është Agjencia për

³²⁸ Përfundime nga fokus grupet të mbajtura në prill të vitit 2022 për qëllime të studimit, shih përfundimet në Shtojcën 1

³²⁹ "Indeksi i cenueshmërisë ndaj dezinformimit në Kosovë", Demokraci Plus, nëntor 2022, https://dplus.org/wp-content/uploads/2022/11/30-12-2022_Vulnerability-Index-of-Disinformation-in-Kosovo.pdf

Siguri Kibernetike. Megjithatë, aftësitë e Agjencisë janë aktualisht në fazat e hershme të zhvillimit të saj.

Sfida të tjera serioze janë identifikuar në ligjin për shpifjen, i cili trajton çështjet e dezinformimit. Sipas studimit të monitorimit të gjykatave të BIRN, institucionet ligjore kanë trajtuar më pak se 10% të totalit të padive për shpifje³³⁰. Për më tepër, vetë ligji nuk ka pësuar asnjë ndryshim që nga hyrja e tij në fuqi në vitin 2011, dhe për këtë arsye nuk merr parasysh metodat moderne të manipulimit të përmbajtjes (siç janë deep fakes).

Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e të drejtës së autorit është i ulët. Pavarësisht se Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës ka identifikuar 53 raste të shkeljeve të së drejtës së autorit gjatë viteve 2021 dhe 2022, gjykatat kanë arritur të zgjidhin vetëm një rast të vetëm të së drejtës së autorit. Moszbatimi i vazhdueshëm i ligjit për të drejtën e autorit ka rezultuar në një gjendje kaosi në lidhje me ripublikimin e materialeve, duke minuar përfundimisht përpjekjet e bëra nga Këshilli i Shtypit për të identifikuar dhe trajtuar shkeljet e të drejtave të autorit. Pavarësisht se Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës ka identifikuar 53 raste të shkeljeve të së drejtës së autorit gjatë viteve 2021 dhe 2022, gjykatat kanë arritur të zgjidhin vetëm një rast të vetëm të së drejtës së autorit.³³¹ Moszbatimi i vazhdueshëm i ligjit për të drejtën e autorit ka rezultuar në një gjendje kaosi në lidhje me ripublikimin e materialeve, duke minuar përfundimisht përpjekjet e bëra nga Këshilli i Mediave për të identifikuar dhe trajtuar shkeljet e të drejtave të autorit.³³²

Zbatimi i ligjit të privatësisë po ashtu ka sfidat e veta. Institucionet qeveritare deri më tani nuk kanë mundur të vendosin standarde për zbatimin e këtij ligji, ndërkohë që mediat janë përballur me vështirësi në respektimin e standardeve të kërkuara që i ka përcaktuar ligji në raste të ndryshme gjatë gjithë vitit. Gjatë diskutimeve në fokus grupe ku janë përfshirë anëtarët e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe mediave, një çështje e veçantë që u shfaq është mungesa e vetëdijes së gazetarëve lidhur me rregullat dhe rregulloret që promovohen me Ligjin e Privatësisë.³³³ Një tjetër çështje ligjore e identifikuar është mungesa e rregullave dhe rregulloreve të brendshme në lidhje me standardet dhe udhëzimet bazë për menaxhimin e pranisë online të institucioneve publike dhe nëpunësve publikë. Vetëm një numër i kufizuar institucioneve kanë vendosur rregullore në lidhje me menaxhimin e rrjeteve sociale të përdorura nga stafi i tyre, dhe shumë pak institucione kanë rregulla të protokollit të sigurisë posaçërisht për pajisjet elektronike.

³³⁰ "Less than 10% of defamation lawsuits are answered by the court (Më pak se 10% e padive për shpifje me përgjigje nga gjykata)", Kallxo, April 24, 2022, <https://kallxo.com/gjate/analyze/me-pak-se-10-e-padive-per-shpifje-me-pergjigje-nga-gjykata/>

³³¹ Dosjet e heshtura të të drejtave të autorit, Kallxo, 27 maj 2022, <https://kallxo.com/gjate/dosjet-e-heshtura-te-te-drejtave-te-autorit/>

³³² Diskutimi është mbajtur në prill 2023 si pjesë e fokus grupeve me anëtarët e Këshillit të Mediave. Shih Shtojcën 1 në fund të këtij raporti për të gjetura me të detaizuara për fokus grupet.

³³³ Diskutime në grupe të fokusuar me anëtarë të Këshillit të Mediave

4.1 Popullsia në Kosovë përgjithësisht mbetet e pambrojtur nga dezinformimi

Duke iu referuar të dhënave të PISA³³⁴ që masin edukimin për media të fëmijëve në mbarë botën, Kosova ka një nga nivelet më të ulëta të të menduarit kritik. Përveç kësaj, raporte të ndryshme³³⁵ kanë gjetur se Kosova është veçanërisht e ndjeshme ndaj dezinformatave. Dëshmitë e mbledhura përmes këtij hulumtimi tregojnë se dezinformatat prekin qytetarët e Kosovës.

Ky studim i BIRN, i cili përfshiu 1,056 të anketuar, zbuloi se më shumë se 30% e të anketuarve besonin të paktën një nga dymbëdhjetë tregimet e dezinformatave që u ishin paraqitur të anketuarve.³³⁶ Sipas të njëjtit hulumtim, Facebook mbetet burimi kryesor i informacionit për kosovarët.

Përafërsisht 40% e të anketuarve e identifikuan Facebook-un si burimin e tyre kryesor të lajmeve. Hulumtimi testoi gjithashtu aftësitë e qytetarëve për të dalluar burimet reale nga ato të rreme. Hulumtimi i opinionit publik ka pyetur të anketuarit nëse i besojnë lajmeve nga Agjencia Kosovare për Informim dhe London Today, dy media që nuk ekzistojnë fare në Kosovë. Sondazhi tregoi se 12% e qytetarëve i besonin Agjencisë Kosovare për Informim inekzistent dhe 5.6% besonin në London Today që nuk ekziston. Kjo do të thotë se një pjesë e qytetarëve të Kosovës nuk i kushtojnë rëndësi burimit të informacionit që konsumojnë.

Eksperimenti social i kryer nga BIRN për të vlerësuar vullnetin dhe gatishmërinë e shoqërisë kosovare për t'u përballur me dezinformimin ofron njohuri të vlefshme për sjelljen dhe qëndrimet e zyrtarëve publikë ndaj informacionit të rremë. Eksperimenti tregon se mungesa e edukimit për median dhe mungesa e procedurave të verifikimit kontribuon në cenueshmërinë e zyrtarëve publikë ndaj informacionit të rremë.

Eksperimenti përfshiu 50 pjesëmarrës nga pesë profesione të ndryshme publike: gjyqtarë, prokurorë, mjekë, mësues dhe punonjës socialë. Çdo profesion kishte dhjetë individë të cilëve u jepeshin informacione të rreme në lidhje me fushën e tyre të punës. Ekipi hulumtues i BIRN u takua me këta profesionistë, u identifikua si staf i BIRN-it dhe u dha gjyqtarëve, prokurorëve, mjekëve, mësuesve dhe punonjësve socialë një artikull të krijuar si një tekst i printuar nga një faqe interneti mediatike për t'u lexuar.

Lajmi ishte një tekst me emrin e autorit, një foto, reklamë që e bënte të dukej si një artikull

³³⁴ OECD, 2018. *Kosovë, Performanca e Nxënësve, Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA)*, <https://gpseducation.oecd.org/CountryProfile?primaryCountry=XKO&treshold=5&topic=PI>

³³⁵ "Indeksi i cenusshmërisë ndaj dezinformimit në Kosovë", *Demokraci Plus*, Nëntor 2022, https://dplus.org/wp-content/uploads/2022/11/30-12-2022_Vulnerability-Index-of-Disinformation-in-Kosovo.pdf

³³⁶ *Rezultatet nga hulumtimi OMNIBUS i bërë gjatë marsit të vitit 2023*

i vërtetë nga një portal i vërtetë lajmesh, por teksti përmbante informacione të rreme lidhur me profesionin e secilit respondent. Pas leximit të parë, këtyre profesionistëve iu dha një pyetësor që pyeste nëse lajmi ishte i vërtetë dhe nëse do ta shpërndanin këtë artikull. Pesë minuta më vonë, pjesëmarrësit plotësuan një pyetësor të dytë ku u pyetën nëse e verifikuan informacionin ose nëse do të merrnin masa për të verifikuar informacionin që sapo lexuan. Ata janë pyetur gjithashtu nëse e mbanin mend emrin e autorit të shkrimit apo se cila media e ka publikuar artikullin që kanë lexuar.

Sondazhi tregoi se 44% e pjesëmarrësve i vlerësuan lajmet që qartësisht ishin të pavërteta si të vërteta, ndërsa 50% e tyre nuk arritën të identifikonin informacionin evident si të rremë në anketë. Për më tepër, 72% e pjesëmarrësve nuk mund të jepnin një përkufizim se çka është informacioni i pavërtetë.

Më poshtë janë informatat e pavërteta të dhëna për secilin grup.

Figura 26: Të dhënat nga eksperimenti social me mësues:

Mësimdhënësve u ishte dhënë një informacion i rremë për ndryshimin e një libri të historisë.
 Deklarata që u ishte dhënë mësimdhënësve përmbante tekstin në vijim:
 Të gjitha librat e historisë për klasat 5 deri në klasën e nëntë janë hequr nga kurikula për shkak që janë vlerësuar se janë në kundërshtim me standardet e Fakultetit të Edukimit.

Rezultatet e eksperimentit social me mësimdhënës:



Figura 27: Të dhënat nga eksperimenti social me gjykatës:

Gjykatësve u është dhënë informacion i rrejshëm rreth Tribunalit të Hagës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Deklarata që u është dhënë gjykatësve përfshinte këtë tekst: Gjykata Evropiane vendos në favor të kompensimit për Fatmir Limajn.

Të dhënat nga eksperimenti social me gjykatës

90%

e gjykatësve nuk e kanë kontrolluar emrin e autorëve kur e kanë lexuar tekstin.

50%

e gjykatësve nuk e kanë identifikuar saktë informacionin rreth përgjegjësive të gjykatës të përmendur në artikull.

50%

të gjykatësve nuk kanë kontrolluar burime të tjera të informacionit për të verifikuar lajmin.

20%

e gjykatësve nuk kanë arritur të ofrojnë një deficion të dezinformatave.

Figura 28: Të dhënat nga eksperimenti social me mjekë:

Mjekëve u është dhënë informacion i rrejtshëm rreth ndalimit të përdorimit të antibiotikëve dhe zëvendësimit të tyre me vitamina. Deklarata që e kanë lexuar mjekët përfshinte tekstin në vijim: Ministria e Shëndetësisë ndalon përdorimin e antibiotikëve.

Rezultatet e eksperimentit me mjekë:



Figura 29: Të dhëna nga eksperimenti social me prokurorët

Prokurorëve u është dhënë niformacion i rrejshëm rreth një operacioni të Agjencisë për Amerikanë për Kontrollimin e Drogës - DEA si dhe të EUROPOL-it.

Rezultatet nga eksperimenti social me prokurorë:

60%

e prokurorëve besojnë që lajmi është i vërtetë

50%

e prokurorëve nuk ishin në gjendje të identifikojnë burimin e informacionit, pasi që e kishin lexuar tekstin dhe informacion.

30%

e prokurorëve nuk do të kërkonin burime të tjera të informacionit për të verifikuar lajmin.

60%

e prokurorëve nuk kanë arritur të ofrojnë një deficion të dezinformatave.

Figura 30: Të dhëna nga eksperimenti social me punonjësit socialë

Punëtorëve social u është dhënë një lajm i rrejshëm rreth ndryshimeve ligjore sipas Konventës së Stambollit.

Teksi që e kanë lexuar punëtorët social ishte si në vijim:

Lajmi i fundit: Katër ligje që dalin nga Konventa e Stambollit shfuqizohen në Kosovë.

Rezultatet nga eksperimenti social me punëtorë social:

50%

e punëtorëve social kanë besuar që lajmi është i vërtetë

20%

e punëtorëve social do të ndanin këtë informacion me të tjerët.

50%

e punëtorëve social do ta ndanin këtë lajm me familjarët e tyre

30%

e punëtorëve social nuk do të kërkonin burime të tjera të informacionit për të verifikuar lajmin

100%

e punëtorëve social nuk kanë arritur të ofrojnë një deficion të dezinformatave.

Gjetjet e eksperimentit social nxjerrin në pah brishtësinë dhe mungesën e njohurive bazë në lidhje me konsumin e sigurt të informacionit nga zyrtarët publikë. Zyrtarët publikë luajnë një rol vendimtar në marrjen e vendimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve. Fakti që një numër i konsiderueshëm zyrtarësh i besuan informacionit të rremë është alarmant.

Të dhënat e përgjithshme janë shqetësuese, veçanërisht fakti që një numër i madh zyrtarësh do ta shpërndanin informacionin me palët e tjera apo edhe do ta shpërndanin pa verifikuar informacionin. Ky studim nënvizon nevojën për promovimin e edukimit për media dhe aftësive të të menduarit kritik për të parandaluar përhapjen e dezinformatave.

4.2 Kapacitetet e kufizuara të institucioneve në adresimin e dezinformimit

Strategjia e sigurisë kibernetike e Kosovës nuk është ratifikuar nga institucionet e saj. Vendit i mungon gjithashtu një strategji dhe kornizë e mirëpërcaktuar për promovimin e al-babetizmit (shkrim-leximit) për media.

Të dhënat nga hulumtimi nxjerrin në pah paaftësinë e zyrtarëve publikë për të identifikuar dhe trajtuar dezinformatat. Mospërfillja e dezinformatave në dokumentet kyçe strategjike ka rezultuar në një sërë sfidash të rënda lidhur me menaxhimin e këtij problemi brenda institucioneve të vendit. Kufizimet mund të kategorizohen në tre fusha kryesore:

- Mungesa e koordinimit dhe udhëzimeve për identifikimin e dezinformatave
- Mungesa e hetimeve penale dhe analizës së ndikimit të dezinformatave
- Mungesa e reagimit institucional ndaj dezinformatave

Mbi 200 zyrtarë për marrëdhënie me publikun, të cilët kanë për detyrë të angazhohen me publikun, punojnë në institucionet publike të Kosovës. Të dhënat e hulumtimit tregojnë se këta zyrtarë janë më shumë të përqendruar në promovimin e punës së institucioneve sesa në adresimin dhe analizimin e dezinformatave. Institucionet publike të Kosovës vazhdimisht kanë dështuar të identifikojnë financuesit e burimeve që përhapin dezinformata dhe rrjetet e hakerëve që kryejnë sulme ndaj organeve mediatike. Problemet në institucione, siç konfirmohet nga hulumtimi, mund të kategorizohen si më poshtë:

- Mungesa e qëndrimeve konsistente për çështjet specifike: Institucioneve të Kosovës u mungojnë qëndrimet e qarta dhe të unifikuara për zhvillimet ndërkombëtare dhe rajonale. Zyrtarët publikë përdorin terminologji dhe qasje të ndryshme kur trajtojnë të njëjtat çështje. Për shembull, lufta në Ukrainë përshkruhet si “Pushtimi i Ukrainës”, “Konflikti në Ukrainë” ose “Lufta midis Ukrainës dhe Ruisë”. Kjo mungesë qartësie dhe uniformiteti në diskursin institucional për marrëdhëniet rajonale dhe ndërkombëtare krijon konfuzion tek gazetarët dhe popullata e përgjithshme. Kjo ndikon në dezinformimin. Për shembull, “Pushtimi i Ukrainës nga Rusia” përcjell një narrativë shumë të ndryshme nga “Lufta midis Ruisë dhe Ukrainës”.
- Mungesa e informatave bazë për rrjedhën e dezinformatave Një pjesë e konsiderueshme e zyrtarëve publikë, siç tregohet nga pjesëmarrja e tyre në fokus grupe, demonstuan mungesë njohurish për fushatat dezinformuese të orkestruara nga ndikimet e jashtme. Për më tepër, ata pranuan mungesën e njohurive të specializuara në lidhje me format dhe mekanizmat e ndryshëm përmes të cilëve përhapet dezinformata.

- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet agjencive: Diskutimet në fokus grup treguan se nuk ekziston një mekanizëm përkatës për bashkëpunim dhe komunikim ndërinstytucional për t'iu përgjigjur dezinformatave. Kjo e bën të vështirë për agjencitë që të punojnë së bashku për të identifikuar, flamurë dhe adresuar dezinformimin, veçanërisht ndikimin e huaj.
- Mungesa e një dokumenti udhëzues ose rregullave: Nuk ka një dokument udhëzues apo rregulla që klasifikojnë informacionin si propaganda apo dezinformim, duke e bërë kështu sfiduese për agjencitë që të përgjigjen në mënyrë efektive. Mungesa e udhëzimeve gjithashtu e bën të vështirë për anëtarët e institucioneve të raportojnë dezinformimin e dyshuar.
- Monitorimi i pamjaftueshëm i medias: Grupi vuri në dukje se nuk ka asnjë softuer apo mekanizëm për të monitoruar mediat dhe shumë nga to nuk mund të monitorohen për shkak të kufizimeve kohore. Shumica e zyrtarëve publikë nuk kanë qasje në mjetet e inteligjencës artificiale ose raportet analitike që mund të mbledhin informacion brenda grupeve të veçanta dhe në vend të kësaj mbështeten në monitorimin manual. Të dhënat e nxjerra nga fokus grupet nënvizojnë një dyfishim të përpjekjeve midis zyrtarëve që mund të përfitojnë nga teknologjia e inteligjencës artificiale, e cila mund të automatizojë proceset e monitorimit të mediave.
- Burimet e kufizuara dhe shpërndarja e gabuar: Nuk ka departamente të specializuara brenda institucioneve të Kosovës që merren me dezinformin³³⁷. Përderisa ekzistojnë disa burime për edukim dhe hetim, ato nuk përdoren në mënyrë efektive. Grupi diskutoi nevojën për ndërtim të kapaciteteve brenda institucioneve për të kuptuar më mirë ekosistemin e dezinformimit dhe për të shpërndarë burimet në mënyrë të duhur.
- Nuk ka komunikim strategjik proaktiv: Qasja aktuale për menaxhimin e informacionit është e vjetëruar, ku zyrat e informimit u përgjigjen vetëm kërkesave në vend që të adresojnë në mënyrë proaktive dezinformimin. Grupi sugjeroi që këto zyra duhet të bëhen më proaktive për t'iu kundërvënë dezinformatave bazuar në raste ose tregime specifike. Kosovës i mungon strategjia mbarëkombëtare për të luftuar narrativat e rreme.
- Mungesa e direktivave nga autoritetet më të larta: Ekziston nevoja për udhëzime nga autoritetet më të larta (Qeveria, BE, akterë të tjerë ndërkombëtarë) për të ndihmuar në identifikimin dhe shenjëzimin e dezinformatave. Kjo do t'i ndihmonte institucioneve që të zhvillojnë një përgjigje më të fuqishme ndaj dezinformatave.

³³⁷ Agjencia Kosovare e Inteligjencës, AKI, ka zyrtarë që merren me këtë, por puna e tyre nuk ndihmon domosdoshmërisht në luftimin e dezinformimit publikisht pasi që AKI nuk është transparente se çfarë bën me dezinformatat.

- Mungesa e kapaciteteve analitike për të analizuar rrjedhën e dezinformatave ka rezultuar në mungesë të raporteve analitike brenda institucioneve shtetërore. Kjo mangësi shtrihet në institucione të rëndësishme si Prokuroria e Shtetit, gjykatat dhe ministritë e ndryshme, ku mungon hartimi i dokumenteve që paraqesin informacione faktike dhe pikat thelbësore për dezinformimin. Rrjedhimisht, këto institucione janë të cenueshme për t'u shënjestruar nga fushatat e dezinformimit.
- Një shqetësim i madh qëndron në mungesën e hetimeve penale brenda institucioneve siç është prokuroria e shtetit, veçanërisht lidhur me dyshimet për financimin e dezinformatave dhe ndikimin e huaj. Mungesa e hetimeve penale për sulmet kibernetike mbi mediat paraqesin gjithashtu një problem serioz³³⁸.

4.3 Mediat dhe institucionet arsimore përballen me kufizime serioze në mbrojtjen e shoqërisë nga dezinformatat

Hulumtimi i kryer përmes fokus grupeve, një ankete të opinionit publik dhe eksperimenti social hedhin dritë mbi probleme serioze që lidhen me kapacitetet e mediave dhe institucioneve arsimore për të trajtuar dezinformimin.

- Institucionet e Kosovës ende nuk kanë miratuar një strategji për avancimin e edukimit për median. Mijëra mësuesve dhe stafit të shkollave u mungojnë trajnimet dhe kapacitetet adekuate për të trajtuar dezinformimin. Për më tepër, brenda Ministrisë së Arsimit nuk ka studime apo analiza që identifikojnë burimet e informacionit që përbëjnë rrezik për mirëqenien e fëmijëve brenda vendit.
- Institucionet e Kosovës nuk kanë financuar apo prodhuar asnjë program edukativ televiziv apo përmbajtje online, duke përfshirë ato të vizatiara (në gjuhën shqipe dhe serbe), që do të ishin të disponueshme në Youtube dhe do të ofronin mesazhe edukative, duke përfshirë mënyrën e leximit të duhur të lajmeve. Rrjedhimisht, fëmijët e Kosovës detyrohen t'i ekspozohen materialeve të rrezikshme dhe të dyshimta të shpërndara përmes rrjeteve sociale që vijnë nga rajone të ndryshme në mbarë botën dhe udhëhiqen vetëm nga algoritme.

- Mekanizmat ekzistues rregullativë audiovizualë në Kosovë përballen me kufizime në luftimin e dezinformimit. Komisionit të Pavarur për Media i mungojnë kapacitetet e mjaftueshme për të monitoruar në mënyrë adekuate transmetuesit e licencuar dhe për të shqiptuar dënimet e duhura për shkeljet etike. Për shembull, gjatë pushtimit të Ukrainës, ky Komision nuk arriti të parandalonte shpërndarjen e propagandës ruse përmes kanaleve të licencuara.
- Mediave në vend u mungon trajnimi i duhur profesional për të dalluar dhe identifikuar rastet e dezinformative të huaja. Një numër shumë i vogël gazetarësh janë të trajnuar për monitorimin dhe gjurmimin e ndikimeve të huaja. Rrjedhimisht, redaksitë brenda vendit janë shndërruar herë pas here pa dashje në shpërndarës të padashur të propagandës.
- Një pjesë e konsiderueshme e mediave online funksionojnë pa redaktorë apo standarde editoriale. Si rezultat, gazetarët e rinj ose të papërvojë shpesh publikojnë materiale pa kryer analiza të plota në lidhje me besueshmërinë e burimeve të tyre.
- Ambienti mediatik vazhdon të promovojë e gazetarisë me një burim të vetëm dhe “gazetarisë së lehtë” ku deklaratat dhe përmbajtjet nga platformat e mediave sociale publikohen pa kontekstualizimin ose burimin e duhur.

ANEKSI I: PËRMBLEDHJE E FOKUS GRUPEVE

BIRN ka organizuar fokus grupe për të eksploruar cenueshmërinë e shoqërisë kosovare ndaj dezinformimit, veçanërisht në lidhje me sigurinë dhe marrëdhëniet ndëretnike, në mënyrë që të identifikohen burimet kryesore të dezinformimit dhe të përcaktohen mënyrat se si institucionet, bizneset dhe shoqëria civile mund ta kundërshtojnë këtë fenomen. Fokus grupet u mbajtën në formate të kombinuara fizike ose hibride dhe mbledhën pesë deri në dhjetë pjesëmarrës me prapavija të ndryshme, duke përfshirë redaktorët dhe anëtarët e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, menaxherët e profileve të bizneseve në media sociale, zyrtarë nga institucionet e sigurisë, gazetarë që kanë shpërndarë dezinformata, dhe organizatat e shoqërisë civile që merren me dezinformimin.

Pyetjet udhëzuese për fokus grupet mbuluan një sërë çështjesh, duke përfshirë cenueshmërinë e shoqërisë kosovare ndaj ndikimeve të huaja dhe dezinformimin mbi sigurinë dhe marrëdhëniet ndëretnike; përdorimin e mediave sociale; dallimet ndërmjet grupeve etnike dhe shoqërore në përdorimin e rrjeteve sociale dhe burimeve të informacionit; dhe kapacitetet e institucioneve dhe mediave për verifikimin e fakteve si dhe për të luftuar dezinformimin. Disa nga pyetjet udhëzuese:

1. Cilat janë dallimet ndërmjet grupeve etnike dhe shoqërore në përdorimin e rrjeteve sociale dhe burimeve të informacionit?
2. Cilat janë kapacitetet e institucioneve/mediave për të verifikuar informacionin dhe luftuar dezinformimin?
3. Cilat janë kapacitetet e bizneseve dhe shoqërisë civile për të luftuar dezinformimin?
4. Cilat janë burimet e financimit për dezinformimin?
5. Cilat janë platformat më të rrezikshme për shpërndarjen e dezinformatave?
6. Cilat janë burimet kryesore që përhapin dezinformata?

Fokus grupet eksploruan kapacitetet e bizneseve dhe shoqërisë civile për të luftuar dezinformimin, burimet e financimit të dezinformimit, platformat më të rrezikshme për shpërndarjen e dezinformatave dhe burimet kryesore të shpërndarjes së dezinformatave. Diskutimet u bazuan në të dhënat paraprake të marra nga hulumtimi.

Fokus grupet synuan të ofrojnë një kuptim të larmishëm të dezinformimit në shoqërinë kosovare dhe të identifikojnë strategjitë për t'iu kundërvënë këtij fenomeni. Më poshtë është një përmbledhje e diskutimeve të mbajtura brenda fushëveprimit të fokus grupeve:

Fokus Grupi 1: Redaktorët dhe anëtarët e Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës

| | |
|--|---|
| Respektimi Etik: | Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e respektimit të Kodit të Etikës të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës si masë thelbësore dhe parandaluese ndaj publikimit të dezinformatave. |
| Ngritja e kapaciteteve: | U nënvizua nevoja për forcimin e kapaciteteve të KMSHK-së, duke pasur parasysh rolin e saj si një organ vetërregullues për mediat e shkruara dhe online. |
| Trajnim për verifikimin e lajmeve: | Fokus grupi identifikoi një domosdoshmëri të qartë për trajnime specifike për verifikimin e lajmeve të rreme, duke marrë parasysh përparimet e fundit në teknologji. |
| Roli i platformave në rrjetet sociale: | Pjesëmarrësit vunë në dukje rolin e rrjeteve sociale si platformat kryesore për shpërndarjen e dezinformatave dhe rëndësinë e trajtimit të kësaj çështjeje. |
| Edukimi për mediat publike: | U rekomandua që jo vetëm gazetarët dhe subjektet mediatike, por edhe publiku duhet të edukohen dhe të ndërgjegjësohen për llojin e përmbajtjes mediatike që duhet të konsumojnë. |

Fokus Grupi 2 - Menaxherët e profileve të bizneseve në media sociale

| | |
|--|---|
| Sfidat e kompanive mediatike: | Kompanitë e medias përballen me sfida specifike në luftimin e dezinformimit, duke përfshirë përdorimin e larmishëm të mediave sociale nga grupet e ndryshme etnike dhe shoqërore, aftësinë e institucioneve për të kundërshtuar lajmet e rreme, financimin e dezinformatave dhe mbrojtjen e individëve në storiet e lajmeve. |
| Respektimi i standardeve etike të gazetarisë: | Fokus grupi theksoi rëndësinë e ruajtjes së standardeve etike të gazetarisë dhe zbatimin e rregulloreve ekzistuese për të zbutur efektet e dezinformimit dhe për t'i mbajtur përgjegjës për shkeljet. |
| Bizneset dhe dezinformimi: | U diskutua çështja e përhapjes së paqëllimshme të dezinformatave nga bizneset përmes reklamave mashtruese ose përfitimeve të mbivlerësuara të produkteve. Si zgjidhje u propozua një bashkëpunim ndërmjet kompanive mediatike, qeverive dhe organizatave të shoqërisë civile për të krijuar një sistem vlerësimi transparent dhe të besueshëm për organet e medias. |
| Titujt sensacionalë dhe taktikat e klikimeve: | U theksua problemi i titujve sensacionalë dhe taktikave mashtruese të klikimeve, të përdorura zakonisht nga mediat për të nxitur vizita në sajte. Grupi theksoi nevojën për raportim etik që shmang taktika të tilla dhe fokusohet në përmbajtje të sakta dhe informative. |
| Strategjia gjithëpërfshirëse për të luftuar dezinformimin: | Grupi nënvizoi nevojën për një strategji qeveritare gjithëpërfshirëse për të trajtuar dezinformimin, duke përfshirë masa të forta ligjore dhe rregullatore, iniciativa për edukimin e medias, praktikat e raportimit të përgjegjshëm dhe bashkëpunimin midis të gjithë aktorëve përkatës. |

Fokus Grupi 3 - Institucionet e Sigurisë

Mungesa e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet agjencive:

Në diskutimin e fokus grupit u theksua se nuk ka një mekanizëm ekzistues për bashkëpunim dhe komunikim ndërinstitucional për t'iu përgjigjur dezinformatave. Kjo e bën të vështirë për agjencitë që të punojnë së bashku për identifikimin, lajmërimin dhe adresimin e dezinformatave, veçanërisht kur bëhet fjalë për ndikimin e huaj.

Mungesa e një dokumenti ose rregullash udhëzuese:

Nuk ka asnjë dokument udhëzues ose rregulla që e klasifikojnë informacionin si propagandë ose dezinformim, duke e bërë sfiduese për agjencitë që të përgjigjen në mënyrë efektive. Mungesa e udhëzimeve gjithashtu e bën të vështirë për anëtarët e institucioneve të raportojnë dezinformimin e dyshuar.

Monitorimi joadekuat i medias:

Grupi vuri në dukje se nuk ka asnjë softuer apo mekanizëm për t'i monitoruar mediat dhe shumë media nuk mund të monitorohen për shkak të kufizimeve kohore. Kjo lejon që dezinformata të përhapet pa verifikim.

Burimet e kufizuara dhe shpërndarja e gabuar:

Ndërsa disa burime janë të disponueshme për edukim dhe hulumtim, ato nuk po përdoren në mënyrë efektive. Grupi diskutoi nevojën për ngritjen e kapaciteteve brenda institucioneve për të kuptuar më mirë ekosistemin e dezinformimit dhe për të shpërndarë burimet në përputhje me rrethanat.

Mungesa e komunikimit strategjik dhe proaktiv:

Qasja aktuale për menaxhimin e informacionit është e vjetëruar, me zyrat e informacionit që u përgjigjen vetëm kërkesave në vend që të adresojnë në mënyrë proaktive dezinformimin. Grupi propozoi që këto zyra duhet të bëhen më proaktive për t'iu kundërvënë dezinformatave bazuar në raste ose tregime specifike. Mungon gjithashtu një strategji mbarëkombëtare për të luftuar narrativat.

Mungesa e direktivave nga autoritetet më të larta:

Ekziston nevoja për udhëzime nga autoritetet më të larta (Qeveria, BE, akterë të tjerë ndërkombëtarë) për të ndihmuar në identifikimin dhe shenjzimin e dezinformatave. Kjo do të ndihmonte institucionet në zhvillimin e një reagimi më të fortë ndaj dezinformatave.

Si përfundim, diskutimi në fokus grup zbuloi boshllëqe të rëndësishme në qasjen aktuale për adresimin e dezinformimit. Për të adresuar këto sfida, ka nevojë për një bashkëpunim më të mirë ndërinstitucional, dokument ose rregulla udhëzuese, monitorim më të mirë të medias, shpërndarje të duhur të burimeve, komunikim strategjik në mënyrë proaktive, udhëzime nga autoritetet më të larta dhe ngritje të kapaciteteve brenda institucioneve.

Fokus Grupi 4 - Gazetarët

Tre sfidat kryesore të medias për raportimin e saktë:

Në diskutimin e fokus grupit u theksua se konkurrenca për të publikuar shpejt lajmet, ndikimi politik dhe presioni për të ruajtur marrëdhëniet me institucionet shpesh çojnë në përhapjen e informacionit të pasaktë ose mashtrues.

Mungesa e departamenteve të specializuara për të kontrolluar faktet:

Grupi vuri në dukje se ka nevojë për departamente të specializuara brenda organeve të mediave për t'u marrë me dezinformimin. Disa media, p.sh. Kallxo.com, ka qasje në mjetet e 'teknologjisë së madhe' për të shenjëzuar dezinformimin në platformat e mediave sociale, si Facebook.

Informacion i kufizuar për burimet e financimit të dezinformatave:

Nuk ka indikacione të qarta për burimet e financimit të dezinformatave në Kosovë. Megjithatë, grupi përmendi rastin e një radiostacioni në Shqipëri, i cili përhap propagandë kineze.

Qasja e politikanëve ndaj mediave:

Grupi theksoi se akterët politikë po përdorin narrativën e 'medias së rreme' për të zvogëluar besimin te gazetarët dhe organizatat me përvojë të madhemediatike.

Epoka digjitale ka krijuar një ekosistem kaotik për shpërndarjen e informacionit:

Grupi vuri në dukje se ka abuzim të konsiderueshëm të lirisë së fjalës në Kosovë, me shumë faqe dhe portale të mediave sociale që e keqpërdorin këtë të drejtë. Organizatat me përvojë të madhemediatike mund të kenë vështirësi të dëgjohen mes zhurmës së krijuar nga burime më pak të besueshme.

Gazetarët të udhëhiqen nga interesi publik:

Fokus grupi theksoi nevojën për vetërregullim dhe respektim të standardeve etike. Gazetarët duhet të kenë prioritet interesin publik dhe të shmangin ndikimin e parave apo interesave të tjera.

Nevoja për të zhvilluar shprehinë e kërkimit dhe shkëmbimit të informacionit:

Publiku duhet të edukohet për rëndësinë e kërkimit të informacionit nga burime zyrtare në vend që të mbështetet në mediat sociale. Në një shoqëri demokratike, deklaratat nga zyrtarët dhe institucionet duhet të merren përmes kanaleve të duhura dhe jo përmes platformave jozyrtare.

Si përfundim, diskutimi në fokus grup identifikoi sfida të rëndësishme në qasjen ekzistuese për trajtimin e dezinformimit. Për të adresuar këto sfida, ekziston nevoja për të përmirësuar shkrim-leximin mediatik dhe aftësitë e shoqërisë në të menduarit kritik, gjë që do të ndikojë në mënyrën se si qytetarët përdorin dhe kuptojnë përmbajtjen mediatike. Një hap tjetër është krijimi i një departamenti të specializuar për kontrollin e fakteve në media dhe përmirësimi i respektimit të standardeve etike.

Fokus Grupi 5 - Organizatat e shoqërisë civile që merren me dezinformimin

Përhapja e dezinformimit:

Portalet online në Kosovë, duke përfshirë ato në gjuhën serbe, janë subjekt i dezinformimit të madh. Këto raste shpesh shkojnë rreth kategorive dhe temave si Gjykata Speciale, dialogu Kosovë-Serbi, dhuna në internet, mizogjia, COVID-19 dhe ndikimi i huaj në politikën e brendshme. Qasja e shumë portaleve e drejtuar nga u identifikua gjithashtu si një faktor kontribues në këtë problem. Gratë politikane janë shpesh në shënjestër, veçanërisht gjatë ngjarjeve të rëndësishme si zgjedhjet.

Dezinformimi kundrejt informacionit të paverifikuar:

Duhet të bëhet një dallim midis informacionit të paverifikuar, i cili mund të shpërndahet nga media autentike të drejtuar nga qasja e click-bait (titujt mashtrues dhe/ose të ekzagjeruar të mediave ose shpërndarjet e mediave sociale) për përfitime financiare, dhe dezinformimit i cili në thelb është më mashtrues dhe dëmtes. Kjo e fundit rritet gjatë incidenteve në veri, duke nxitur dhunën dhe duke mbjellë përçarje në mes të komuniteteve, që rrjedhin kryesisht nga mediat në gjuhën serbe.

Dezinformimi që synon pakicat:

Një trend shqetësues i dezinformimit nxit dhunën dhe gjuhën e urrejtjes ndaj komuniteteve pakicë, si LGBTIQ+ dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Shqetësime të ngjashme u ngritën në lidhje me dezinformatat që për qëllim kishin refugjatët që vinin nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut, përkatësisht Siria dhe Maroku. Media, veçanërisht media online, shpesh luan një rol të rëndësishëm në përforcimin e këtij lloji të përmbajtjes dhe retorikës.

Roli i medias dhe integritetit të gazetarisë:

Media mund të luajë një rol vendimtar në përforcimin ose reduktimin e dezinformatave. Përderisa Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës po punon për të përmirësuar cilësinë e gazetarisë, ka nevojë që mediat të kontrollojnë informacionin e tyre, të shmangin gjuhën përçarëse dhe të përmirësojnë politikën e tyre editoriale. Gazetarët e rinj dhe qytetarët mbi moshën 60 vjeçare konsideroheshin veçanërisht të ndjeshëm ndaj dezinformimit.

Transparenca institucionale dhe qasja në informacion:

Mungesa e transparencës institucionale dhe qasja e kufizuar në informacion është një çështje e rëndësishme që prek gazetarët, veçanërisht ata në fillim të karrierës së tyre. Kjo çështje vetëm sa përkeqëson ekosistemin e dezinformimit dhe minon besueshmërinë e institucioneve dhe mediave.

Rekomandime për të luftuar dezinformimin:

Rekomandimet kryesore përfshijnë nevojën që organet mediatike të verifikojnë faktet përpara publikimit, ndërtimin e qëndrueshmërisë qytetare ndaj dezinformimit dhe forcimin e kapaciteteve të organeve rregullatore të medias. Institucionet shtetërore duhet gjithashtu të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të zhvillojnë strategji për të kundërshtuar fushatat informative kundër Kosovës.

ANEKSI II: METODOLOGJIA E DETAJUAR E KËTIJ STUDIMI

Monitorimi i përmbajtjes ka ndodhur nga 15 tetor 2022 deri më 15 mars 2023.

Ky raport përcakton dezinformimin si dhe të gjitha format e informacionit të rremë, të pasaktë ose mashtrues, i paraqitur dhe i promovuar për të shkaktuar qëllimisht dëm publik ose për përfitime. Ky përkufizim është i ngjashëm me atë të përdorur nga Raporti i Komisionit Evropian për Dezinformimin.³³⁹

Metodologjia e hulumtimit u përqendrua në tre shtylla për të analizuar ndikimin që manipulimi i informacionit dhe dezinformimi kishte në publikun e gjerë.

Për qëllime të këtij studimi janë monitoruar të paktën 100 burime informacioni. Ata u ndanë në grupet e mëposhtme:

- Përmbajtja e shpërndarë online nga 40 platforma televizive dhe mediatike online të cilat janë aktive si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë vendor, duke përfshirë mediat e huaja të pranishme në Kosovë;
- Përmbajtja e shpërndarë online nga 63 llogari të mediave sociale të 35 politikanëve dhe zyrtarëve publikë të nivelit të lartë dhe 28 'influencuerëve' nëpër platforma të ndryshme (Facebook, Instagram dhe X, ky i fundit i njohur më parë si Twitter përpara korrikut 2023);
- Përmbajtja e diskutuar në 10 programe të debateve politike të stacioneve televizive qendrore të cilat janë shpërndarë përmes YouTube.³⁴⁰

Ky raport e bazoi terminologjinë e tij në konceptet kryesore të dezinformimit të përdorura në raportin e BE-së 2018, "Raporti përfundimtar i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për Lajmet e Rreme dhe Dezinformimin në internet" dhe raportin e Evropës së Këshillit për çrregullimin e informacionit (shih tabelën më poshtë).³⁴¹ Çrregullimi i informacionit nënkup-

³³⁹ Komisioni Evropian, Raporti përfundimtar i Grupit të Nivelit të Lartë të Ekspertëve për Lajme të Rrejshme dhe Dezinformim online, 12 mars 2018.

<https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/final-report-high-level-expert-group-fake-news-and-online-disinformation>

³⁴⁰ 10 debate televizive që janë analizuar janë përzgjedhur në bazë të llojllojshmërive gjeografike dhe etnike: Context, ATV, Dasma TV (DTV), Debat Plus, TV Dukagjini, Kendi i Debatit, Teve1, Politiko, Kanal10, Pressing, T7, RTK Prime, RTK, Rubikon, Klan Kosova, TV DANKOS dhe TV MOST

³⁴¹ Claire Wardle & Hossein Derakhshan, Çrregullimet e informacionit: Drejt një kornize shumë disiplinare për hulumtim dhe bërje të politikave (2017). <https://edoc.coe.int/en/media/7495-information-disorder-toward-an-interdisciplinary-framework-for-research-and-policy-making.html>

TABELA: Terminologjia mbi konceptet kyçe të çrregullimit të informacionit³⁴⁰

| | |
|---|--|
| <p>1. Dezinformimi: Përmbajtje e rremë ose mashtruese që krijohet, paraqitet dhe shpërndahet me qëllim të mashtrimit ose përfitimit ekonomik ose politik dhe që mund të shkaktojë dëm publik.</p> <p>2. Keqinformimi: përmbajtje e rreme, por personi që ndan informacionin nuk e kupton se është i rremë, mashtrues ose i dëmshëm.</p> <p>3. Çinformimi: informacion i vërtetë që shpërndahet me qëllim për të shkaktuar dëm.</p> <p>4. Mungesa e kontekstit: Përmbajtje që nënkupton një pretendim të rremë pa e deklaruar drejtpërdrejt.</p> <p>a. Lidhje e rreme: kur titujt, pamjet vizuale të titrave nuk e mbështesin përmbajtjen.</p> <p>b. Mashtruese: përdorimi mashtrues i informacionit për të inkuadruar një çështje ose një individ.</p> <p>c. Clickbait: titujt mashtrues dhe/ose të ekzagjeruar të mediave ose shpërndarjet e mediave sociale.</p> <p>5. Përmbajtje e fabrikuar: përmbajtje e re që është 100% false, e krijuar për të mashtruar dhe dëmtuar.</p> <p>6. Reklamë e fshehur: material promovues i paraqitur si lajm.</p> <p>7. Çrregullimi i rishpërndarjes së informacionit: rishpërndarja e dezinformative, dezinformative dhe/ose keqinformacioneve të publikuara nga media të tjera.</p> <p>8. Satirë ose parodi: nuk ka qëllim për të shkaktuar dëm, por ka potencial për të mashtruar</p> | <p>9. Pseudoshkencë: paraqitja e pretendimeve joshkencore ose pseudoshkencore si fakte shkencore.</p> <p>10. Përmbajtja mashtruese: kur burimet e vërteta imitohen nga burime të rreme, të sajura.</p> <p>11. Teori konspirative: një pretendim i ekzistencës së një plani të fshehur keqdashës, pa paraqitur prova për të në mënyrë eksplícite ose jo.</p> <p>12. E ndryshuar: përmbajtje imazhi, audio ose video që është redaktuar ose sintetizuar përtej rregullimeve për qartësi ose cilësi, në mënyrë që mund të mashtrrojë njerëzit (deep-fake).</p> <p>13. Pjesërisht e rreme: përmbajtje që ka disa pasaktësi faktike.</p> <p>14. Narrativa është “një grup historish, ngjarjesh dhe idesh pa fund, të cilat bazohen në vlera dhe besime për të rezonuar me audiencën e synuar. Narrativa synon të sigurojë një kuptim të një çështjeje duke reduktuar kompleksitetin e saj dhe duke ofruar një rrugë drejt një gjendjeje përfundimtare të dëshirueshme.”</p> <p>a. Narrativa e dezinformimit është një seri historish të pavërteta ose pjesërisht të vërteta që formojnë një tërësi kronologjike që synon të mashtrrojë ose manipulojë qëllimisht publikun. Prandaj, dezinformimi nuk duhet vlerësuar si pjesë e veçantë dhe unike, por si pjesë e një tërësie më të madhe, brenda një periudhe të caktuar kohore, duke përdorur disa tema për të mbështetur narrativën.</p> |
|---|--|

ton të gjitha fenomenet që ndodhin në universin e informacionit të ndarë në tre kategori: keqinformim, dezinformim dhe keqinformim i dëmshëm (shpjegohet më tej në tabelën më poshtë). Raporti shërbeu si pikënisje për një sërë raportesh rreth dezinformimit nga vende të ndryshme të Ballkanit Perëndimor që u komisionuan nga divizioni i BE-së, Stratcom.³⁴²

Përpunimi i të dhënave, monitorimi i përmbajtjes, kodimi dhe eksperimentet sociale

Për të identifikuar trendet e dezinformatave të publikuara në televizion, online dhe media sociale, studiuesit përdorën një platformë të BIRN-it për kontrollin e fakteve, e cila u zhvillua për të trajtuar dezinformimin e publikuar nga mediat kosovare. Kjo platformë shërben si një zgjidhje e automatizuar për të ndihmuar verifikuesit e fakteve. Platforma ka një mekanizëm që njihet si Flamuri i Kuq dhe mund të përdoret duke kërkuar burimin, datën e publikimit, URL-në ose temën. Përveç platformave të tjera në internet si CrowdTangle, BIRN përdori të dhënat e kësaj platforme të brendshme për të identifikuar dezinformatat.

Përveç këtyre, BIRN Kosova përdori Krypometer, kontrolluesin e verifikuar të fakteve nga Rrjeti Ndërkombëtar i Verifikimit të Fakteve, i cili përmban një arkiv prej 500 dezinformatash dhe keqinformatash të publikuara në dy vitet e fundit. Krypometer ndihmoi në identifikimin e trendeve që erdhën përpara afatit kohor të këtij raporti.

Rrjeti BIRN në të gjithë Ballkanin Perëndimor ka monitoruar shkeljet e të drejtave digjitale. Nga 1 shtatori 2021 deri më 31 gusht 2022, BIRN dokumentoi 782 shkelje të të drejtave digjitale në bazën e të dhënave.³⁴³ Zbërthimi i këtyre rasteve është: Bosnja dhe Hercegovina (77 raste), Kroacia (70), Hungaria (146), Kosova (89), Maqedonia e Veriut (83), Mali i Zi (65), Rumania (128) dhe Serbia (124). regjistruar nga Fondacioni SHARE, një organizatë jofitimprurëse që promovon të drejtat digjitale dhe partner i BIRN-it. Konkretisht, në Kosovë, shkeljet më të shpeshta të raportuara të të drejtave digjitale të regjistruara nga BIRN u klasifikuan si manipulim dhe propagandë (54 incidente).

³⁴² Komisioni Evropian, Raporti përfundimtar i Grupit të Nivelit të Lartë të Ekspertëve për Lajme të Rrejshme dhe Dezinformim online, 12 mars 2018. <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/final-report-high-level-expert-group-fake-news-and-online-disinformation>

³⁴³ "Shtrembërimi i së vërtetës: Gjuha e urrejtjes dhe Dezinformimi Nxisin Shkeljet e të Drejtave Digjitale në Ballkan", Raporti Vjetor për Monitorimin e të Drejtave Digjitale 2022, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese, <https://balkaninsight.com/wp-content/uploads/2023/03/DISTORTING-THE-TRUTH.-HATE-SPEECH-AND-DISINFORMATION-FUEL-DIGITAL-RIGHTS-ABUSES-IN-THE-BALKANS.pdf>

³⁴⁴ "Grupi i ekspertëve të nivelit të lartë për lajmet e rreme dhe dezinformatat online." Raporti përfundimtar i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për Lajmet e Rreme dhe Dezinformatat Online. Komisioni Evropian, mars 2018. <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/library/final-report-high-level-expert-group-fake-news-and-online-disinformation>

Analizat sasiore dhe cilësore

Pas procesit të grumbullimit të të dhënave dhe kodimit të përmbajtjes, të gjithë formularët e monitorimit u analizuan në mënyrë cilësore për të vendosur tregimet kryesore të manipulimit të informacionit për secilën temë. Gjithashtu, bazuar në të dhënat parësore, humtuesit e projektit llogaritën numrin e artikujve të botuar për të njëjtën temë; ripublikimet e tyre në media të tjera ose shpërndarjet në platforma të tjera të mediave sociale; shikime video; dhe shtrirjen e postimeve të mediave sociale nëpër platforma.

VALIDIMI I TË DHËNAVE

Të dhënat e gjetura gjatë monitorimit i janë nënshtruar një vlerësimi të dyfishtë, nëpërmjet organizimit të pesë grupeve të fokusit (të detajuara në Aneksin I) dhe një rishikimi të pavarur.

Për këtë qëllim, drafti i studimit u nda për komente me tre recensionistë të pavarur. Shumica e komentet të marra u inkorporuan në draftin përfundimtar.

³⁴⁵ "Shtrembërimi i së vërtetës: Gjuha e urrejtjes dhe dezinformimi ushqejnë abuzimet me të drejtat dixhitale në Ballkan", Raporti vjetor i të drejtave dixhitale 2022, Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ, <https://balkaninsight.com/wp-content/uploads/2023/03/DIS-TORTING-THE-TRUTH.-HATE-SPEECH-AND-DISINFORMATION-FUEL-DIGITAL-RIGHTS-ABUSES-IN-THE-BALKANS.pdf>

